

Korrik 2014
Numri: 76
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



TË ZGJEDHËSH AHIRETIN
NË VEND TË DYNJASË
OSMAN NURI TOPBASH



AKTUALIZIMI
I NAMAZIT
DR. KERIM BULLADË




SI DUHET TA LEXOJME KURANIN?
ALIJA IZZETBEGOVIÇ



MUSTAFA ERISH
HISHAM IBN AS IBN VAIL



SËMUNDJET E ZEMRËS
MUHAMED EL-GAZALI



MURAT AKGYN
DISIPLINA TRUP-SHPIRT
NË RAMAZAN

MIRË SE ERIDHE!





KOPSHTI Aromë Trëndafili

**U HAP KOPSHTI
“Aromë Trëndafili”!**

**Regjistrimet vazhdojnë...
Ju mund të paraqiteni
çdo ditë tek godina pranë xhamisë Perash.**

**Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe i kontrolluar,
staf i kualifikuar, çmime të arsyeshme,
transporti është i garantuar.**

Na kontaktoni në numrin 0676078223.

Ju mirëpresim!

(Me mbështetjen e Shoqatës “Istanbul”)



Ta zbresim Kuranin nga raftet dhe ta nxjerrim nga këllëfi i tij...

Ta vështrojmë Kuranin.

Të bëjmë që Kurani të na shohë.

Të familjarizohemi me Kuranin.

Të nxjerrim mallin me të.

T'i fitojmë zemrën Kuranit.

Ta lexojmë Kuranin.

Të mësojmë hartën e rrugës që na paraqet Kurani.

Dhe...

Ta mishërojmë Kuranin në jetën tonë.

Të plotësojmë leximin e Kuranit, duke zbritur në thellësitë e "Librit të jetës"...

Të përpiqemi me sa mundësi të kemi që brenda këtij Ramazani dhe në shoqërinë e Kuranit, t'i ngajmë njeriut, për të cilin thuhet, se **"moral i tij ishte Kurani"** dhe që Zoti e ka cilësuar, si "Usue-i Hasene/Shembulli më i bukur", pra Pejgamberit tonë (a.s.)...

Të pyesim, të pyesim, e përsëri të pyesim se çfarë kishte prej Kuranit në jetën e të Dërguarit të Allahut. Ta lexojmë Kuranin me shpjegimin më të qartë e më të kthjellët që është pasqyruar në jetën e bekuar të Pejgamberit (a.s.) dhe ta bartim atë shkronjë për shkronjë në jetën tonë...

Të gjallërojmë të gjitha qelizat tona me Kuran dhe me mesazhin e shenjtë, në të cilin na ftoi i Dërguari i Allahut (a.s.)...

Nëse e shohim Ramazanin si "muajin e faljes", pra i themi "Mirë se erdhe!" duke dëshiruar që në fund të tij të arrijmë faljen e Allahut; nëse brenda nesh kemi një dëshirë të tillë, atëherë duhet të bëjmë nijet/qëllim përjetimin e një Ramazani, i cili do të na çojë tek "falja e Allahut".

Këtë muaj duhet ta konsiderojmë si një stinë pastrimi absolut. Çdo moment të tij, çdo sekondë, çdo ditë e çdo natë, duhet ta kalojmë me përpjekjen për t'u pastruar. Falja vjen me punë. Rasulallahu (a.s.), na e ka bërë të ditur se: *"Nëse (Ramazani) përjetohet me besim dhe duke e pritur shpërblimin e tij vetëm prej Allahut, falja do të vijë"*.

Nëse i themi Ramazanit "Mirë se erdhe!", si "muaji i umetit", atëherë duhet të rishikojmë se "cilit umet i përëkasim" dhe të shohim se çfarë na ka dhënë Ramazani si "umet i Muhamedit (a.s.)".

Cilësimi i bërë nga Pejgamberi ynë (a.s.), për këtë muaj, si "muaji i umetit", mbase për kohën tonë bart kuptime edhe më të thella. Vallë, sot, cila shoqëri myslimane e ndjen veten brenda "përkatësisë së umetit" të Muhamedit (a.s.)? Vallë, cili është kuptimi i "umetit" në Irak, në Siri, në Afganistan, në Pakistan, etj.?

Nëse koncepti "umet" shpreh bashkësinë e myslimanëve që janë kapur pas dorës së Pejgaëmberit (a.s.), kush dhe me çfarë entuziazmi apo dashurie e ka kapur për-dore të Dërguarin e Allahut (a.s.)?

A mund t'i themi Ramazanit "Mirë se erdhe!" me një gëzim që shkapëtet nga zemra jonë si një umet 1.5 miliardësh?

Umeti bëhet umet, nëse e kupton Ramazanin si "muajin e umetit"... Lidhin plagët, ndalojnë urrejtjet dhe ndarjet, largojnë shejtanin dhe lidhin zemrat me njëri-tjetrin...

Korrik 2014

VITI: VIII
NUMRI: 76

BOTUESI
Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR
Albert Halili

KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

PËRKTHYES
Albert Halili
Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 607 8484

E-MAIL
revistaetika@progresibotime.com

WEBSITE
www.revistaetika.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrove të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja

Fatura e mbështetjes së të padrejt dhe padrejtësisë
Ali Riza Temel

14



7

Tiparet e besimtarëve që përmenden në Kuran
Fatmir Hadri



Të zgjedhësh ahiretin
në vend të dynjasë
Osman Nuri Topbash

34




12



30

Si duhet ta lexojmë Kuranin?
Alija Izzetbegović


- 5 Mirë se erdhe!
Ahmet Tashgetiren
- 10 Fshehtësia e Itikafit
Rabia Christine Brodbeck
- 12 Hisham ibn As ibn Vail
Mustafa Erish
- 17 Sëmundjet e zemrës
Muhamed El-Gazali
- 18 Përkufizimi i zemrës besimtare
Xhafer Durmush
- 20 Mesazhi i fjalës së bukur
Prof. dr. Jashar Kandemir
- 22 Tevhidi
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz
- 24 Kurani, lajmi tronditës
Abdullah Draz
- 28 Përmasa sociale e besimit
Prof. dr. Mehmet Gërmez



54

Një Ajet - Një Hadith 32

- 10 sëmundjet që shëron agjërimi 40
Jonida Tashi
- Ramazani nga gjuha e Profetit (a.s.) 42
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- Qytetërimi Islam 46
Prof. dr. Zija Kazëxhë
- Hasan Basriu 48
Sadik Dana
- Kurani dhe Ramazani 52
Salih Zeki Meriç
- Lulja e prillit 53
Alban Kali
- Rinia ideale
Husejn Kerim Exhe 54



Disiplina trup-shpirt në Ramazan
Murat Akgyn

38

Aktualizimi i namazit
Dr. Kerim Bullade



44



Ahmet Tashgetiren

Ramazani, muaji i agjërit.
Ramazani, muaji i Kuranit.
Ramazani, muaji i faljes.
Ramazani, muaji të cilin Pejgamberi (a.s.), e ka cilësuar si “muaji i umetit tim”.

Nëpër parulla i urojmë gjithmonë “Mirë se rdhe!” Ramazanit.

Vallë, me cilat cilësi duhet të vijë Ramazani në botën tonë?

Kur themi **“Mirë se erdhe!”**, a duhet t’i ngarkojmë një lloj vetëdijeje marrëdhënies sonë me Ramazanin? Takimin tonë, a duhet ta paraprijë njëfarë përgatitjeje apo kjo thënie duhet të jetë thjesht diçka që del nga gjuha jonë e që nuk gjen pasqyrim në shpirtin tonë?

Është e mundur të themi se cilën cilësi të synojmë, me cilën cilësi do ta përjetojmë Ramazanin dhe me cilën cilësi do ta brumosim jetën tonë, me atë cilësi do të vijë edhe Ramazani. Përndryshe, Ramazani, përsëri do të vijë, përsëri do të “mirësevijë”, por si shiu që bie mbi një gur, ai nuk do të sjellë begati në botën tonë.

Kjo është çështje qëllimi.

Është çështje e gjetjes dhe formimit të thelbit të punës.

Është çështje e përcaktimit të një qëllimi prej zemrës sonë, në zemrën e Ramazanit.

Nëse i themi Ramazanit “Mirë se erdhe!”, si një muaj “agjërimi”, atëherë duhet të bëjmë një/qëllim agjërimin dhe ta mbajmë atë ashtu siç duhet.

Ashtu siç ka thënë edhe Pejgamberi ynë (a.s.), agjërimin nuk duhet ta fillojmë duke menduar vetëm për ngrënien dhe pirjen e që, për rrjedhojë, si fitim, në fund të na ngelet vetëm uria, por duhet ta fillojmë duke mbajtur agjërim me të gjitha sjelljet tona. Pra, një agjërim, ku të agjërojmë edhe dora, gjuha, syri, veshi, zemra dhe mendja...

Agjërimin nuk duhet ta mbajmë thjesht për shëndetin, duke aplikuar një dietë ushqimi, por për të formuar një disiplinë jetësore...

Nëse i themi Ramazanit “Mirë se erdhe!”, si “muaji i Kuranit” –që në fakt ashtu është. Ai, është muaji i nderuar me Kuranin, i cili është libri i jetës së një besimtari, atëherë duhet të takohemi me Kuranin, me një qëllim të tillë, sa që ta pimë të gjithë atë, ta ngarkojmë në zemrën

dhe trurin tonë e të largojmë prej zemrës, trurit, jetës e të gjithë damarëve të trupit tonë, çdo gjë që del jashtë kornizës së Kuranit.

Ta zbresim Kuranin nga raftet dhe ta nxjerrim nga këllëfi i tij...

Ta vështrojmë Kuranin.

Të bëjmë që Kurani të na shohë.

Të familjarizohemi me Kuranin.

Të nxjerrim mallin me të.

T'i fitojmë zemrën Kuranit.

Ta lexojmë Kuranin.

Të mësojmë hartën e rrugës që na paraqet Kurani.

Dhe...

Ta mishërojmë Kuranin në jetën tonë.

Të plotësojmë leximin e Kuranit, duke zbritur në thellësitë e "Librit të jetës"...

Të përpiqemi me sa mundësi të kemi që brenda kësaj Ramazani dhe në shoqërinë e Kuranit, t'i ngajmë njeriut, për të cilin thuhet, se **"moral i tij ishte Kurani"** dhe që Zoti e ka cilësuar, si "Usue-i Hase-ne/Shembulli më i bukur", pra Pejgamberit tonë (a.s.)...

Të pyesim, të pyesim, e përsëri të pyesim se çfarë kishte prej Kuranit në jetën e të Dërguarit të Allahut. Ta lexojmë Kuranin me shpjegimin më të qartë e më të kthjellët që është pasqyruar në jetën e bekuar të Pejgamberit (a.s.) dhe ta bartim atë shkronjë për shkronjë në jetën tonë...

Të gjallërojmë të gjitha qelizat tona me Kuran dhe me mesazhin e shenjtë, në të cilin na ftoi i Dërguari i Allahut (a.s.)...

Nëse e shohim Ramazanin si "muajin e faljes", pra i themi "Mirë se erdhe!" duke dëshiruar që në fund të tij të arrijmë faljen e Allahut; nëse brenda nesh kemi një dëshirë të tillë, atëherë duhet të bëjmë nijet/qëllim përjetimin e një Ramazani, i cili do të na çojë tek "falja e Allahut".

Këtë muaj duhet ta konsiderojmë si një stinë pastrimi absolut. Pra, çdo moment të tij, çdo sekondë, çdo ditë e çdo natë, duhet ta kalojmë me përpjekjen për t'u pastruar. Falja vjen me punë. Rasulallahu (a.s.), na e ka bërë të ditur se: *"Nëse (Ramazani) përjetohet me besim dhe duke e pritur shpërblimin e tij vetëm prej Allahut, falja do të vijë"*.

Kjo është falja e Zotit ndaj robit të vet.

Pra, kemi bërë gabime.

Atëherë, duhet të vetëdijesohemi për gabimin tonë.

Të shohim çdo gjë që mund të cilësohet si gabim tek Allahu dhe të shpëtojmë prej saj.

Të qëndrojmë tek dera hyjnore e të përqafojmë pendimin, të thërrasim; "O Zot, O Zot!"...

Të thërrasim e të thërrasim, derisa brenda nesh të bjerë qetësia dhe paqja...

Të arrijmë në Bajramin, në fund të Ramazanit, me gëzimin e zemrës që duhet t'i falet një besimtari.

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Muaji i Rexhebit është muaji i Allahut, Shabani është muaji im, ndërsa Ramazani është muaji i umetit tim"*.¹

Nëse i themi Ramazanit "Mirë se erdhe!", si "muaj i umetit", atëherë duhet të rishikojmë se "cilit umet i përkasim" dhe të shohim se çfarë na ka dhënë Ramazani si "umet i Muhamedit (a.s.)".

Cilësimi i bërë nga Pejgamberi ynë (a.s.), për këtë muaj, si "muaji i umetit", mbase për kohën tonë bart kuptime edhe më të thella. Vallë, sot, cila shoqëri

myslimane e ndjen veten brenda "përkatësisë së umetit" të Muhamedit (a.s.)? Vallë, cili është kuptimi i "umetit" në Irak, në Siri, në Afganistan apo në Pakistan?

Nëse koncepti "umet" shpreh bashkësinë e myslimanëve që janë kapur pas dorës së Pejgamberit (a.s.), kush dhe me çfarë entuziazmi apo dashurie e ka kapur përdore të Dërguarin e Allahut (a.s.)?

A mund t'i themi Ramazanit "Mirë se erdhe!" me një gëzim që shkëputet nga zemra jonë si një umet 1.5 miliardësh?

A mos vallë hidhërimi që vazhdon me vite në tokat islame edhe gjatë Ramazaneve e Bajrameve, është tregues se umeti po përjeton Ramazanet që meriton?

Umeti bëhet umet, nëse e kupton Ramazanin si "muajin e umetit"... Lidhin plagët, ndalojnë urrejtjet dhe ndarjet, largojnë shejtanin dhe lidhin zemrat me njëri-tjetrin...

Sa muaj Ramazani, sa muaj agjërimi, sa muaj Kurani, sa muaj faljeje dhe sa muaj umeti ka përjetuar çdokush prej nesh në jetën e vet?..

Të shohim veten tonë, të shohim umetin! Sa jemi bërë njerëz të ndërtuar nga Ramazani e sa jemi bërë umet i brumosur prej Ramazanit?

Edhe sa Ramazanë duhet të kalojmë që të ndodhë kjo?

1. Shih. Bejhaki, Fedailu'l-Eukat; Ibn Haxher el-Askalani, Tebjinu'l-'Axheb; Sujuti, Tefsiru'l-Kur'an.





Fatmir Hadri

Tiparet e besimtarëve që përmbenden në KURAN

Besimtarët përballë forcës së pakufishme të dijes së Allahut, që ka përfshirë çdo gjë që ekziston, ndiejnë frikë, nder dhe respekt të madh ndaj Tij. Andaj, siç tregohet dhe në ajetin kuranor, besimtarët e **"Madhërojnë Atë me madhërinë që i takon."** (Isra, 111) Ata e përmbendin dhe e përkujtojnë Allahun në çdo çast të jetës së tyre. Kurani është i mbushur me deklarime që shprehin sinjeritetin e besimtarëve përballë madhërisë së Allahut. Çfarë përgjigjeje (shpërblimi) i jep Allahu këtij sinjeriteti të besimtarëve? Në një ajet kuranor thuhet kështu: **"Më kujtoni Mua** (me namaz e lutje) **që Unë t'ju kujtoj** (me shpërblime)..." (Bekare, 152)

Allahu i ka cilësuar besimtarët në Kuran me disa tipare dhe virtyte të veçanta. Andaj dhe besimtarët kanë shumë anë që Allahu i pëlqen dhe i lavdëron. Por ne tani do të mundohemi t'i tregojmë ato tipare dhe virtyte që Allahu i përmend në Kuran, gjersa bën fjalë për besimtarët.

Allahu u ka premtuar atyre që besuan dhe bënë vepra të mira: **"Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i**

kënaqur dhe që frikën do t'ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë asgjë (në adhurim). **Sa për ata që, pas kësaj, mohojnë** (besimin), **pikërisht ata janë të mbrapshtët."** (Nur, 55)

"Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monotiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë..." (Rum, 30)

"Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe pastaj nuk dyshojnë, por luftojnë në rrugë Allahut me pasurinë dhe jetën e tyre. Këta janë besimtarë të sinqertë." (Huxhurat, 15)

"Ne i pajisëm ata me një virtyt të posaçëm, me përkujtim ndaj botës tjetër." (Sad, 46)

(Iblisi) Tha: **"Zoti im, për shkak që më përzure** (më largove), **unë do t'ua zbukuroj** (të këqijat) **atyre sa të jenë në tokë** (në këtë botë) **dhe të gjithë ata do t'i largoj nga rruga e drejtë! Përveç robërve të Tu, të cilët i ke bërë të sinqertë."** (Hixhr, 39-40)

"Ky është libri që nuk ka dyshim në të, (sepse është

prej Allahut) është udhëzues për ata që janë të devotshëm.” (Bekare, 2)

“Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndejshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët.” (Tevbe, 128)

“Ne do ta shkulim urrejtjen nga kraharori i tyre. Te këmbët e tyre do të rrjedhin lumenj dhe ata do të thonë: “Qoftë lavdëruar Allahu që na udhëzoi në këtë. Ne nuk do të ishim udhëzuar, sikur të mos na udhëzonte Allahu. Pa dyshim, të dërguarit e Zotit tonë kanë sjellë të vërtetën”. Dhe një zë do t'i thërrasë: “Ky është Xheneti që ju e keni merituar për atë që keni punuar!” (Araf, 43)

“...të cilët i dëgjojnë fjalët dhe pasojnë atë më të mirën prej tyre. Të tillët janë ata që Allahu i udhëzoi në rrugën e drejtë dhe të tillët janë ata të mençurit.” (Zumer, 18)

“Ne përpara tyre e vumë në sprovë popullin e faraonit dhe u pati ardhur i dërguar i ndershëm. (U pati thënë): ‘M'i dorëzoni robërit e Allahut, se unë jam i dërguar besnik te ju.’” (Duhane, 17-18)

“O Jahja, rroke fort Librin (Teuratin).” Dhe Ne, kur ende ishte fëmijë, i dhamë mençuri, butësi prej Nesh dhe dëlirësi. Ai ishte besimtar i përkushtuar dhe i sjellshëm ndaj prindërve të vet, nuk ishte i ashpër dhe i padëgjueshëm...” (Merjem, 12-14)

Ai (Isai) tha: “Unë jam rob i Allahut, mua më ka dhënë (ka caktuar të më japë) librin dhe më ka bërë Pejgamber. Më ka bërë dobiprurës kudo që të jem dhe më ka porositur me namaz (falje) e zeqat për sa të jem gjallë! Më ka bërë të mirësjellshëm ndaj nënës sime e nuk më ka bërë kryelartë, as të padëgjueshëm!” (Merjem, 30-32)

“Përmendu në Libër (tregimin për) Musain! Ai ishte i zgjedhur (prej Zotit) dhe ishte i dërguar, pejgamber.” (Merjem, 51)

“Trego në Libër për Ismailin! Vërtet, ai ishte i sinqertë në premtimet e veta, ishte i dërguar dhe profet. Ai e urdhëronte popullin e vet që të falte namazin e të jepte zeqatin dhe ishte i mirëpritur te Zoti i vet. Trego në Libër për Idrizin! Ai ishte njeri i së vërtetës dhe profet. Ne e ngritëm atë në vend të lartë...” (Merjem, 54-57)

“Ato janë Xhenetet që do t'ua trashëgojnë robërve Tanë që ishin të ruajtur.” (Merjem, 63)

“Edhe lutja e Ibrahimit për babain e vet nuk ishte tjetër, veç për shkak të një premtimi që ia pati premtuar atij e kur iu bë e qartë se ai ishte armik i Allahut, u largua prej tij. S'ka dyshim, Ibrahim i ishte shumë i ndjeshëm dhe i butë.” (Tevbe, 114)

Ai (Allahu) tha: “O Musa, Unë të gradova ty mbi njerëzit me shpalljen Time dhe me të folurit tim. Merr atë që të dhashë dhe bëhu mirënjohës.” (Araf, 144)

“Vërtet, Ibrahim i ishte shumë i butë, shumë i dhembshëm dhe i kthyeshëm.” (Hud, 75)

“Ti (Muahamed) duro, ashtu sikurse duruan të dërguarit e vendosur dhe mos kërko ngutjen e dënimit për ta, sepse ditën kur do ta përjetojnë atë (dënimin) që u është premtuar, atyre u duket sikur nuk kanë jetuar vetëm se në një moment të shkurtër të ditës. Kumesë e mjaftueshme! A mos shkatërrohet kush, pos popullit të shfrenuar.” (Ahkaf, 35)

“E, merre me dorën tënde një deng thupra dhe bjeri me të, e mos e thyej betimin!

Vërtet, Ne e gjetëm atë të durueshëm. Sa rob shumë i mirë ishte ai dhe i kthyer te Zoti. Përkujto robërit tanë Ibrahimin, Is-hakun, Jakubin, që ishin të fortë në zbatimin e detyrave dhe largpamës në fe. Ne i pajisëm ata me një virtyt të posaçëm, me përkujtim ndaj botës tjetër. S'ka dyshim se ata ishin te Ne prej të zgjedhurve më të mirë. Përkujto Ismailin, Eljesan, Dhelkiflin, që të gjithë prej të zgjedhurve. Ky është një përkujtim. E është e sigurt se ata që janë të ruajtur, kanë një ardhmëri të mirë.”

(Sad, 44-49)

“Përkujto kur engjëjt i thanë: ‘O Mejreme, Allahu të përgëzon me fjalën e vet (me lindjen e një fëmije si rezultat i fjalës së Zotit), emri i të cilit është Mesih, Isa, bir i Merjemes, i famshëm në dynja e ahiret dhe nga të afërmit (e Zotit).’” (Ali-Imran, 45)

“Ja, kështu Zoti yt të zgjedh ty, të mëson interpretimin e ëndrrave, plotëson dhuntinë e Tij ndaj teje dhe familjes së Jakubit, sikurse pat plotësuar atë më parë ndaj prindërve të tu, Ibrahimit dhe Is-hakut. Vërtet, Zoti yt është më i dijsmi, më i urti!” (Jusuf, 6)

“O ju që besuat! Kush largohet nga feja e vet (i bën dëm vetes), s'ka dyshim se Allahu do të sjellë një popull që Ai e do atë (popull) dhe ata e duan Atë (Zotin), (një popull) që është modest e i butë ndaj besimtarëve, por i ashpër dhe i fortë ndaj mohuesve, që lufton në rrugën e Allahut dhe që nuk i frikësohet kërcënimit të asnjë kërcënuesi. Kjo (cilësi e atij populli) është



dhuratë e Allahut, që i jep atij që do. Allahu është dhurues i madh, i dijshtëm." (Maide, 54)

"Ata që besuan Allahun dhe të dërguarin e Tij, ata janë të sigurtit dhe dëshmorët tek Zoti i tyre, ata kanë shpërblimin e vet dhe dritën e vet, ndërsa ata që e mohuan dhe përgënjeshtuan faktet Tona, ata janë banues të Xhehenemit." (Hadidë, 19)

"Pejgamberi është më i ndeshëm ndaj besimtarëve sesa ata ndaj vetes së tyre, ndërsa gratë e tij janë në vend të nënave të tyre. E ata (të afërmit) farefisi nga barku, sipas dispozitave të Allahut, kanë më tepër përparësi ndaj njëri-tjetrit sesa besimtarët e tjerë dhe se muhaxhirët (të mërguarit), përveç nëse dashamirëve tuaj doni t'u bëni ndonjë të mirë (u lini testament ose diç tjetër). Kjo është e regjistruar në librin e shquar (Levhi Mahfudh, Kuran)." (Ahzab, 6)

"njerëzit e së djathtës - sa të nderuar do të jenë fatlumët! 9. njerëzit e së majtës sa të poshtëruar do të jenë fatkeqët! dhe ata që kanë prirë (në besim) e që do të prijnë (edhe në Xhenet). Ata janë të afërtit (tek Allahu)." (Vakia, 8-11)

"E përsa u përket atyre të djathtëve, ç'është gjendja e të djathtëve?" (Vakia, 27)

"Prej besimtarëve kishte burra që vërtetuan besën e dhënë Allahut e disa prej tyre e realizuan premtimin duke dhënë jetën dhe ka prej tyre që janë duke pritur (ta zbatojnë) dhe ashtu nuk bënë kurrfarë ndryshimi. Që Allahu t'i shpërblejë të vërtetit për sinqeritetin e tyre e hipokritët t'i ndëshkojë, nëse do, ose t'ua falë atyre; Allahu është që fal shumë, është mëshirues." (Ahzab, 23-24)

"Atyre nga beduinët që ngelën pas, thuaju: 'Ju do të ftoheni te një popull luftarak e i fuqishëm, t'i luftoni ata ose të dorëzohen (të pranojnë fenë islame) e, nëse përgjigjeni (në thirrje), Allahu ju jep shpërblim të mirë, e nëse nuk dilni sikurse ngelët pa dalë më parë, Ai ju ndëshkon me një dënim të padurueshëm.'" (Fet'h, 16)

"Muhamedi është i dërguar i Allahut, e ata që janë me të (sahabët) janë të ashpër kundër jobesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet vete, ti i sheh kur përlen (në ruku), duke rënë me fytyrë në tokë (në sexhde) e kërkojnë pre Allahut që të ketë mëshirë dhe kënaqësinë e Tij ndaj tyre. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes. Përshkrimi i cilësive të tyre është në Tevrat dhe po ky përshkrim është edhe në Inxhil. Ata janë si një farë e mbjellë, ku mbin filizi i vet e ai trashet, forcohet dhe qëndron në trungun e vet, ajo e mahnit mbjellësin. (Allahu i shumoi). Për t'ua shtuar me ta mllëfin jobesimtarëve. Allahu atyre që besuan dhe bënë vepra të mira u premtoi falje të mëkateve dhe shpërblim të madh." (Fet-h, 29)

"Ata ishin si gomarë të trembur (të egër). Që ikin prej luanit (ose prej gjahtarit)." (Muddethir, 50-51)

"Ai me maturi prej tyre tha: 'A nuk ju thashë përse

nuk e përmendi Zotin?" (Kalem, 28)

"Se me të vërtetë ai (Kurani) është fjalë (e Zotit) që e lexon i dërguari i ndershëm." (Hakka, 40)

"Ti duro ndaj asaj që thonë ata, dhe përkujto robin Tonë Davudin, të fuqishmin (në fe e trup), vërtet ai gjithnjë i drejtohej Allahut." (Sad, 17)

Ata i thanë: "Mos u frikëso, ne po të marrim myzhde për një djalë të zgjuar!" (Hixhr, 53)

"E Ne nuk të dërguam ty për tjetër qëllim, por vetëm si përgëzues e si qortues." (Furkan, 56)

"Ibrahimi nuk ka qenë as jehudi, as i krishterë, por ai ishte larg besimeve të kota, ishte mysliman dhe nuk ishte prej idhujtarëve." (Al'Imran, 67)

Thuaj: "Allahu e tha të vërtetën, pra ndiqeni fenë e pastër të Ibrahimit, sepse ai nuk u takonte idhujtarëve." (Al'Imran, 95)

"Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në Allahun. E sikur ithtarët e librit të besonin drejt, do të ishte shumë më e mirë për ta. Disa prej tyre janë besimtarë, por shumica e tyre janë larg rrugës së Zotit." (Al'Imran, 110)

Popullit të vet Musai i tha: "Kërkoni ndihmë prej Allahut dhe kini durim. S'ka dyshim se toka është e Allahut, ia lë në trashëgim atij që nga robërit e tij, e ardhmja e lumtur është për të devotshmit. Ata (populli i Musait) thanë: 'Ne ishim të shtypur para se të na vije ti e, edhe pasi na erdhe'. Ai (Musai) tha: 'Është shpresë se Allahu do ta shkatërrojë armikun tuaj (faraonin) e ju do t'ju bëjë ta zëvendësoni në këtë vend e do t'ju shikojë se si veproni.'" (Araf, 128-129)

"E atij populli që ishte i nënshtruar i trashëguam lindje e perëndim të tokës, që Ne e bekuam (me të mira), ndërsa për durimin që patën, u plotësua fjala më e mirë (premtimi i vërtetë) e Zotit ndaj beni israilëve; rrënuam atë që bënte faraoni i tij, si dhe atë që kishin ndërtuar ata." (Araf, 137)

"O ju që keni besuar, mos u bëni si ata që e ofenduan Musain, e Allahu e pastroi atë nga ajo që i thanë. Ai tek Allahu ishte me famë." (Ahzab, 69)

"E s'ka dyshim se të mirët janë në kënaqësinë e përjetimeve (në Xhenet)." (Infitar, 13)

"E kur të vijë ajo ditë, askush nuk do të flasë, veç me lejen e Tij e prej tyre (të tubuarve) ka fatzinj dhe fatbardhë." (Hud, 105)

"Ndërsa, ata që besuan dhe bënë vepra të mira, të tillët janë krijesat më të dobishme." (Bejjine, 7)

"E duke u falur ai në faltore, engjëjt e thërrasin: 'Allahu të përgëzon ty me Jahjanë, që do të vërtetojë fjalën (Isain) e ardhur nga Allahu, e që do të jetë prijës i matur dhe pejgamber nga të dashurit Alluarit!" (Ali Imran, 39)



FSHEHTËSIA E ITIKAFIT

Rabla Christine Bordbeck

Dhjetë ditët e fundit, që janë kulmi i muajit të madhëruar të Ramazanit, përbëjnë edhe kohën e itikafit. Allahu i Madhëruar ua mundëson besimtarëve agjëruet ta kurorëzojnë agjërimin, të plotësojnë pastrimin e tyre shpirtëror, të plotësojnë përgjërimet për kërkimin e faljes e të mëshirës nga Allahu (xh.sh.) dhe të përfundojnë hatmen e Kuranit. Është koha kur besimtari arrin kulmin e lutjeve ndaj Zotit të botëve dhe Arafatin shpirtëror. Veçanërisht, transmetohet se Kurani Fisnik ka zbritur në dhjetë ditët e fundit të muajit të Ramazanit. Nata e Kadrit, në të cilën ka zbritur Kurani, është më e mirë se një mijë muaj. Për këtë arsye, thesari i itikafit, që kurorëzohet me namazin e natës dhe natën e Kadrit, është i pashoq nga aspekti i mundësisë për lartësimin shpirtëror.

Mbi të gjitha, në dhjetë ditët e fundit të itikafit, i cili është kulmi i muajit të Ramazanit, falet namaz nate. Namazet që i Dërguari i Allahut, (a.s.), i ka falur përgjatë natës, janë quajtur namaz nate. Namazi i natës përfaqëson "makamu'l-mahmud", që është pozita e Pejgamberit (a.s.). Esenca e namazit të natës është e njëjtë me esencën e fesë islame. Namazi i natës simbolizon ditën e tubimit në Kiamet. Esenca e namazit të natës, mbart bërthamën e halvetit. Namazi i natës dhe halveti, do të thotë të heqësh dorë nga të ngrënët e nga gjumi dhe të pish nga lumi i urtësisë së Nurit të Zotit (xh.sh.). Namazi i natës është gjendja e halvetit, në të cilën bëhen pëshpërimat e dashurisë reciproke në mënyrën më të sigurtë dhe në të cilën realizohet një takim shumë i fshehtë e privat. Zemra e robit ringjallet në vendin ku takohet me Atë që e ka më afër se veten e tij. Namazi i natës është kuvendim me Zotin e botëve në errësirën e natës. Namazi i natës është frymëmarrje për pjesën tjetër të jetës. Namazi i natës është vetëdijësimi i njeriut për përhershmërinë e shpirtit. Namazi i natës

është fitimi i fuqisë së përhershme të shpirtit të njeriut. Namazi i natës është perceptim i të fshehtave hyjnore të el-Hajju'l-Kajjunit. Namazi i natës gjithmonë e mban gjallë njeriun. Namazi i natës është vetëdijësim i ringjallur. Netët në të cilat nuk kemi falur namaz nate, janë humbja jonë më e madhe. Është humbur thesari i nënshtrimit ndaj Zotit (xh.sh.). Është humbur thesari i sexhdes, kijamit, Fatihës dhe Esmau'l-husnas. Është humbur morali më i lartë, morali i Muhamedit (a.s.). Është humbur thesari i teuhidit. Është humbur lidhja me ehlibejtin e Mustafait (a.s.) dhe sahabët e Tij. Me një thënie tjetër, nëse duam të përjetojmë dashurinë Muhamedane, duhet të falim namaz nate.

Qëllimi i muajit të Ramazanit është përjetimi i fesë. Domethënë, reflektimi i fesë në jetën e përditshme. Dhjetë ditët e fundit të Ramazanit janë përjetimi i esencës së Islamit. Esenca e fesë islame është përjetimi i fesë së teuhidit. Halveti synon që t'i përkasim Atij. Përse agjërojmë? Për ta përsosur namazin dhe për të përjetuar miraxhin. Përse hyjmë në halvet? Për t'u kthyer në miraxhin dhe shtëpinë e përhershme të zemrës e të shpirtit. Për të përjetuar eksperiencën e Ahiretit.

Itikafi nuk është vetëm simboli i mbarimit të Ramazanit, por edhe i dorëzimit të plotë të vetes te Allahu i Madhëruar. Hyrja në halvet nuk është vetëm zgjerim e thellim i dimensionit shpirtëror të identitetit të njeriut dhe përpjekje për pastrim shpirtëror. Po ashtu, nuk është vetëm edukim nefs, pastrim shpirtëror e fizik dhe as vetëm arritje e qetësisë shpirtërore për mendjen dhe zemrën. Urtësia e tërheqjes nga kjo botë është zhytja në oqeanin e mëshirës së Allahut të Madhëruar, domethënë, synimi dhe esenca e halvetit është bashkimi i njeriut me Zotin (xh.sh.), i cili është i Dashuri i vërtetë i tij.

Allahu i Lartësuar i ka thënë Musait, alejhi's-selam: **"Ata që dëshirojnë të më afrohen Mua, nuk mund të gjejnë ndonjë rrugë më të mirë se halvetin."** Rruga që shkon te Allahu Teala, është rruga e sakrificës. Rruga që shkon te Allahu Teala, është rruga e halvetit. Për këtë arsye, çdo gjë duhet ta sakrifikojmë për dashurinë e Allahut të Lartësuar. Nëse njeriu e sakrifikon veten për Zotin e botëve, si kundërvlerë për këtë fiton jetën e përhershme. Njeriu duhet t'ia nënshtrojë vullnetin e tij të pjesshëm, vullnetit absolut të Allahut (xh.sh.). Në këtë mënyrë, bashkohet synimi përfundimtar i jetës me synimin përfundimtar të halvetit dhe bëhen një pjesë e vullnetit të Atij.

E fshehta e muajit të Ramazanit është arritja e eksperiencës së heshtjes së gjuhës së zemrës. Ky është një agjërim i vërtetë, me anë të të cilit njeriu largohet nga çdo gjë përveç Allahut Teala dhe qëndron bashkë me Zotin e botëve, i Cili është i Dashuri i tij. Në agjërim jemi në halvet. Në halvet ka heshtje dhe qetësi. Hazreti Ibnu'l-Arabiu i përkufizon kështu tre aspektet zinxhir të heshtjes: "Varfëria është heshtje e vullnetit, injoranca është heshtje e mendjes. Ndërsa adhurimi është heshtje e ekzistencës." Hazreti Mevlana thotë: "Mbylle derën e fjalës dhe hap dritaren e zemrës! Hëna do të të puthë ty nga dritarja." Agjërimi na bën të heshtim. Agjërimi na fton të dëgjojmë dhe të bëjmë mukabele. Agjërimi na është dhuruar për t'i shtuar ndjesitë tona shpirtërore, për t'u bërë më të hapur ndaj ajeteve kuranore dhe për t'u bërë një pjesë e shpalljes. Vetëm një zemër e pastër mund të zhytet në nurin e ajeteve, duke hyrë në oqeanin e mëshirës hyjnore dhe mund të ndjejë shijen e kuptimeve të thella. Buzët e goja, veshët e sytë dhe të gjitha gjymtyrët e trupit, duhet të jenë të gatshme për të marrë jetë nga ajetet, për të kuptuar urtësinë e tyre dhe për të arritur udhëzimin hyjnor. Allahu i Madhëruar në Kuranin Fisnik thotë: **"Le të gëzohen ata që shmangen nga adhurimi i idhujve e kthehen nga Allahu! Pra, jepu lajme të gëzueshme robërve të Mi, të cilët, pasi i dëgjojnë fjalët (që u thuhen), ndjekin atë që është më e mira prej tyre. Këta janë ata që Allahu i ka udhëzuar në rrugë të drejtë; këta janë të mençurit."** (Zumer, 17-18.)

Vetmia është metoda më efikase për të arritur përsosmërinë shpirtërore. Në këtë mënyrë, njeriu arrin kulmin e halvetit dhe devotshmërisë. Para se të arrijmë urtësinë, duhet të hyjmë në halvet dhe para se të fitojmë jetën e përhershme, duhet të sakrifikojmë. Para se të arrijmë të njohim Zotin dhe dashurinë, duhet ta pastrojmë zemrën nga shirku. Vetëm pasi të pastrohet mirë pasqyra e zemrës, del në pah mëshira. Vetëm kur të përvetësojmë cilësinë më të vlefshme të modestisë, shfaqet mëshira. Vetëm kur të jemi të kënaqur nga Allahu Teala në çdo gjendje,

del në pah urtësia dhe njohja e Zotit. Nuk ka dashuri pa halvet. Feriduddin Attari thotë: "Ai që kërkon dashurinë dhe miqësinë e Allahut pa përjetuar zuhdin dhe halvetin (asketizmin), ka një dashuri fallso në kuazën e tij. Kush ndjek rrugën e halvetit (asketizmit) me sinqeritet, çdo gjë e bën është për hir të kënaqësisë hyjnore." Halveti është shpëtim nga nefsi dhe nxjerrje nga zemra e të gjitha dëshirave, pasioneve dhe synimeve të kësaj bote. Halvet do të thotë të mos lidhesh me këtë botë, të mos qëndrosh në burgun e trupit dhe të mos ndjesh vuajtje tjetër përveç vuajtjes që jep ndarja nga Zoti. Halvet do të thotë të mos kesh frikë dhe të mos brengosesh. Halvet do të thotë që të mos kesh asnjë shqetësim tjetër përveç shqetësimit për të arrirë te Ai, të mos i drejtohesh asgjëje përveç Atij, të mos lidhesh me askënd përveç Atij dhe të mos kesh nevojë për askënd përveç Atij. Halvet do të thotë të bëhesh njeri i vërtetë. Halvet do të thotë ta sakrifikosh çdo dashuri që nuk është për Allahun, të dëshirosh skamjen dhe të duash varfërinë, të njohësh nevojën e përhershme dhe lidhjen me Allahun Teala, t'i shesësh veten Zotit (xh.sh.), të të digjet zemra nga zjarri i mallit dhe përgjërimit, të digjesh nga mallëngimi, të të kaplojë malli i kërimit të Zotit dhe të stolisesh me shpresën më të lartë. Halvet do të thotë të mbledhësh frytet e perceptimit, të marrësh frymën e Rrahmanit dhe të mos ndjesh aspak interes për personalitetin fallso që është mbuluar me nefsin. Halvet do të thotë të zhytesh në detin e Muhamedit (a.s.). Halvet do të thotë të ndjesh frikë nga madhështia dhe bukuria e Allahut Teala, të derdhësh lot gëzimi në audiencën e Er-Rrahmani'rr-Rrahimit, të arrish lumturinë dhe të përjetosh kënaqësinë shpirtërore që kërkohet me insistim në namaz. Halvet do të thotë të festosh arritjen në sarajin e Rrahmanit, i cili thotë se "është më afër nesh se damarët e qafës".

Në fakt, halveti i vërtetë është të vetmuarit e njeriut me të Dashurin e tij në çdo kohë dhe në çdo vend. Besimtari i vërtetë gjithmonë është me ihram, gjithmonë është në halvet dhe gjithmonë është në sexhde. Në jetën tonë, gjithmonë duhet të përpiqemi t'ia kthejmë shpinën kësaj bote, të hamë pak, të flemë pak dhe të flasim pak. Asnjëherë nuk duhet ta prishim agjërimin e zemrës.

ÇFARË E PRISH AGJËRIMIN E ZEMRËS?

Dr. Haluk Nurbaki thotë: "Zemra e një njeriu që është larg të varfrit, larg jetimit dhe larg nevojtarit, nuk funksionon, nuk punon dhe është e prishur. Atij njeriu, që ka para në xhep, ka ushqim në shtëpi, dhe nuk ndjen ndonjë shqetësim nga brenda e nuk mendon të gjejë ndonjë të uritur apo të varfër për ta ushqyer, i është prishur agjërimi i zemrës. Nëse ai ha e pi pa ndërje keqardhje për ta, atëherë të mos pretendojë agjërimin."





HISHAM IBN ÂS IBN VÂIL

Sahabi që u rrit në flakë

Mustafa Erish

Hisham Ibn As Bin Vail (r.a.), është një sahab që ka pasur fatin të lavdërohet nga Muhamedi (a.s.), me fjalët: *"Që të dy fëmijët e As-it janë myslimanë."*

Ai është një burrë që është penguar të bëjë hixhret në Medine dhe që Zoti i është përgjigjur duasë: *"Allahu im! Shpëtoji myslimanët që nuk kanë mbështetës!"*

Është vëllai i të atit të çlirimtarit të Egjiptit, Amër ibn As!..

Një njeri fatlum që merr pjesë në hixhretin e dytë për në Abisini!..

Ai, porsi një trëndafil që rritet mes flakësh, kishte lindur në Mekë, në një familje armike ndaj Islamit dhe aty ishte rritur.

Të gjithë pjesëtarët e familjes njiheshin për armiqësinë ndaj Pejgamberit (a.s.). I ati ishte një nga mushrikët e përbetuar; As Ibn Vail. Kurse e ëma ishte Ummu Har-mele binti Hisham. E motra e Ebu Xhehlit.

Hisham Ibn As Bin Vail (r.a.), u rrit në një frymë ku bëheshin mbledhje në shtëpitë e mushrikëve kurejshit, aty ku thureshin kurthe ndaj myslimanëve dhe në ambient familjar ku ishte vatra e urrejtjes, neverisë dhe armiqësisë ndaj Islamit.

Allahu i Madhëruar është i Gjithëpushtetshëm. Nëse Ai dëshiron, edhe në mesin e flakëve bën që të çelë trëndafili. Hishami dhe vëllai i madh i tij, Amr Ibn As, u rritën në një atmosferë të tillë familjare, porsi dy trëndafila.

Ata iu dorëzuan Allahut dhe Resulit që në vitet e para të Islamit dhe u nderuan me Islamin. Kurrë nuk hoqën

dorë nga imani i tyre. Jetuan si vëllezër besimtarë.

Resulullahu (a.s.), lidhur me ta, tha: *"Që të dy fëmijët e As-it janë besimtarë."* Kështu u përgëzuan nga Pejgamberi i dashur (a.s.). (Musned, III, 304, 327, 353, 354.)

Hisham Ibn As (r.a.), për t'u shpëtuar torturave të pazezueshme të mushrikëve të Mekës, bashkë me disa myslimanë emigruan në Abisini. Pasi qëndruan aty për një copë kohë, dëgjoi se do të bënte hixhret Resulullahu (a.s.), për në Medine.

Ai u kthye në Mekë me qëllim që të bëjë hixhret bashkë me Zotërinë e dy botëve, Muhamed Mustafanë (a.s.). Mirëpo, i ati, As Ibn Vail, shfrytëzoi rastin e ardhjes së tij dhe duke iu bashkuar grupit të mushrikëve e kapën Hisham Ibn Asin (r.a.) dhe e futën në burg. U bënë pengesë për hixhretin e tij. (Ibn Sa'd, IV, 191 – 194; Istiab, IV, 1539 – 1540)

Kështu, Hishami (r.a.), nuk arriti të bënte hixhret bashkë me Resulullahun (a.s.). Nuk arriti të merrte pjesë në tri luftërat e para të mëdha të Islamit. Nuk ishte i pranishëm në luftërat e Bedrit, Uhudit dhe Hendekut.

Resulullahu (a.s.), u mërzit shumë për këtë situatë të Hishamit (r.a.). Në namazet e sabahut filloi të bënte dua enkas për sahabë, si Hisham Ibn As Bin Vail (r.a.), të cilët ishin nën kontrollin e mushrikëve mizorë.

Ai vazhdoi duke bërë dua për një kohë të caktuar. Pastaj, në Mekë dërgoi një grup sahabësh me në krye Velid bin Velid (r.a.). (Usdul-gabe, V, 375.)

Kjo dua që bëhej për të shpëtuar dhe për të arritur në shpëtim sahabët, tek Muslimi transmetohet në këtë mënyrë:

"Sipas asaj çfarë ka përcjellë Ebu Hurejra (r.a.), Resulullahu (s.a.s), për një muaj rresht, në namazet e sabahut, pas rukuve këndonte kunutin.

Pasi thoshte: *"Semiallahu limen hamideh. Rabbena ue lekel-hamd. Allahu pranon falënderimin e atyreve që e falenderojnë Atë. O Zoti ynë! Vetëm ty të përket falënderimi"*, qëndronte në këmbë dhe bënte duan në këtë mënyrë:

"Allahu im! Shpëtoje Velid bin Velid-in!

Allahu im! Shpëtoje Selemtnubnu-Hisham-in!

Allahu im! Shpëtoje Ajjash bin Ebi Rabia-n!

Allahu im! Shpëtoji besimtarët që nuk kanë mbështetje!

Allahu im! Shtojë dënimin dhe trysninë mbi fisin Mudar!

Allahu im! Bëje për ata sikurse vitet e skamjes së Jusufit!"

Ebu Hurejra (r.a.), pasi kaloi pak, afërsisht pas një muaji, pa që Resulullahu (a.s.), e la këtë dua. (Muslimi, Mesaxhid, 294 – 295.)

Hisham ibn As (r.a.), ishte shumë i dhënë pas kumtimit islam; që të pengonte të keqën dhe të këshillonte të mbarën. Ai ishte pjesë e delegacionit që kishte dërguar Hazreti Ebu Bekër es-Siddiku (r.a.), tek Herakliti për ta ftuar atë në Islam.

Ai ishte një hero që kishte shumë guxim dhe trimëri. Dëshironte të vdiste në rrugë të Allahut. Ai u gjend në të gjitha luftërat, pas luftës së Hendekut. Ishte pjesë edhe e ushtrisë që u nis në drejtim të Tulejha bin Huvejlid el-Esedi, i cili ishte vetëshpallur pejgamber.

Ai mori pjesë edhe në luftën e Exhnaabinit, nën udhëheqjen e Halid bin Velidit (r.a.). Aty shpalosi një trimëri të vërtetë. Ndërkohë, vërejti se ushtarët myslimanë po zmbrapseshin, iu drejtua atyreve kështu:

"O myslimanë! Ejani! Ejani!.. Unë jam Hisham Ibn As. Po i largoheni xhenetit?" Nxori shpatën nga brezi dhe duke thënë këto fjalë, u vërsul në drejtim të armikut. Dhe kështu, ra shehid pas një beteje të fortë. La trupin në fushëbetejë, kurse shpirtin ia dorëzoi Zotit të Madhëruar.

Transmetohet se vëllai i madh i Hishamit (r.a.), Amr ibn As (r.a.), shprehej se e kishte zili martirizimin e të vëllait. Madje, tregohet një ngjarje e tillë:

"Një ditë, ndërkohë që ishin të ulur përreth murit të Qabesë, shokët e pyetën kështu:

- Kush është më i virtytshëm, ti apo Hishami?

Ai qe përgjigjur në këtë mënyrë:

- Allahu e ka pranuar atë si shehid, kurse mua jo." (Ibn Sa'd, IV, 191 – 194; Istiab, IV, 1593 – 1540.)

Hisham Ibn As (r.a.), ishte njeri shumë i mëshirshëm dhe shumë falës. Ishte gjithashtu edhe shumë bujar. Ai u përpoq të kryente testamentin që kishte lënë babai i tij mushrik, ndonëse i kishte bërë tortura të panumërta.

Babai i tij, As Ibn Vail kishte lënë amanet që të linin të lirë 100 skllëvër. Hishami liroi menjëherë 50 skllëvër që i takonin atij.

Kurse në zemrën e Amr ibn As-it u krijuar një dilemë nëse duhej ta realizonte një testament të tillë, pasi i ati i tij kishte vdekur si një mushrik.

E diskutoi gjatë me veten e tij nëse duhej apo jo të realizonte porosinë e të atit, i cili dha shpirt si një mushrik. Për këtë çështje u konsultua edhe me Resulullahun (a.s.).

Me përgjigjen që mori nga zotëria i gjithësisë, Muhamedi (a.s.), zemra e Amrit (r.a.), u qetësua dhe mendja iu ndriçua.

Ky diskutim i rëndësishëm ka mbërritur deri në ditët e sotme. Në "Sunen-in" e Ebu Davudit, transmetohet në këtë mënyrë:

"Sipas asaj çfarë ka përcjellë Amr ibn Asi, gjyshi i Amr ibn Shuajbit:

As ibn Vail kërkoi që në emër të tij të liroheshin njëqind skllëvër.

Si pasojë, i biri, Hishami, liroi pesëdhjetë.

Pesëdhjetë skllëvërit e tjerë deshi t'i lironte djali tjetër i tij, Amri.

Por ai tha me vete: "Më mirë të konsultohem me Resulullahun (a.s.).

Shkoi tek Resulullahu (a.s.) dhe i tha:

"O i Dërguar i Allahut! Babai ka lënë testament që të lirohen njëqind skllëvër në emër të tij. (Vëllai) Hishami, liroi pesëdhjetë në emër të tij.

Tani kanë mbetur edhe pesëdhjetë të tjerë që të lirohen, për t'u çuar porosia në vend.

A mund t'i liroj në emër të tij (këta pesëdhjetë skllëvër)?

Resulullahu (a.s.), iu përgjigj në këtë mënyrë:

"Sikur babai të ishte mysliman, sikur të lironit skllëvër në emër të tij apo sikur të jepnit sadaka në emër të tij apo sikur të bënit haxh në emër të tij, sevapi i këtyre do të mbërrinte tek ai" (Ebu Davud, Vesaja, 16.)

Kështu, Resulullahu (a.s.), ua bëri të ditur të gjithë myslimanëve se veprime të tilla që bëhen për njerëz që vdesin si jomyslimanë, nuk kanë asnjëfarë vlere.

Allahu qoftë i kënaqur prej tij!

Zoti na bëftë prej atyre njerëzve që mësojnë nga edukata e tyre shembullore dhe na dhëntë mundësinë që t'u kërkojmë shefaat. Amin!

Fatura e mbështetjes së TË PADREJTIT DHE PADREJTËSISË

All Riza Temel

Padrejtësi do të thotë të mos bësh diçka në mënyrën e duhur, të sillesh pa kriter, të kalosh kufijtë dhe të bësh zullum. E kundërta e padrejtësisë është drejtësia. Ndërsa drejtësi do të thotë që çdo gjë ta bësh siç duhet dhe me maturi.

Padrejtësia shkatërron, ndërsa drejtësia ndërton. Çdo gjë është e lidhur me drejtësinë. Allahu Teala në Kuran thotë:

“Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë Balancën (për çdo gjë), që ju të mos e shkelni atë. Prandaj matni drejt e mos peshoni mangët!” (Rahman, 7-9)

Padrejtësia, siç mund të jetë një veprim që njeriu bën kundrejt vetvetes në formën e mohimit të fesë, shirkut dhe mosmirënjohjes, mund të jetë edhe në formën e sjelljeve të padrejta që njerëzit shfaqin kundrejt njëri-tjetrit apo udhëheqjeje nga ana e të padrejtëve. Në çfarëdo lloji mënyre që të jetë, padrejtësia ka faturë të rëndë për individin dhe shoqërinë. Drejtësia sjell lumturinë, ndërsa padrejtësia sjellë shkatërrimin. Allahu i madhëruar thotë:

“...Njëmend, keqbërësit nuk do të shpëtojnë.” (En'am, 135)

Poeti thotë: “Edhe në qoftë mbret, që ushtria e tij mbush malet e luginat, i padrejti asnjëherë nuk e ndjen veten të sigurt.” Me padrejtësi njeriu shkatërron të ardhmen duke krijuar iluzionin se mund të bëhet i përhershëm.

Shkatërrimi i popujve dhe individëve të padrejtë, është një ligj hyjnor. Historia pothuajse është vitrinë e ekspozimit të popujve të shkatërruar për shkak të padrejtësisë. Allahu i Madhëruar në Kuran thotë:

“Ne i kemi zhdukur shumë breza para jush, sepse bënë në të këqija. Të dërguarit e tyre u sollën prova të qarta, por ata nuk i besuan. Kështu, Ne i dënojmë njerëzit e këqij.” (Junus, 13)

“(Sjelljet e jobesimtarëve të Mekës) ngjajnë me sjelljet e ithtarëve të Faraonit dhe të të tjerëve që jetuan para tyre. Ata i përgënjeshtroan shpalljet e Zotit të tyre dhe kështu, Ne i shkatërruam për shkak të gjynaheve të tyre, ndërsa ithtarët e Faraonit i fundosëm. Të gjithë ata ishin keqbërës.” (Enfal, 54)



“Sa e sa vendbanime, banorët e të cilëve kanë qenë mohues, i kemi shkatërruar dhe pas tyre kemi ngritur popuj të tjerë!” (Enbija, 11)

Siç shihet edhe nga ajetet e mësipërme, shkaku i shkatërrimit të popujve janë mëkatet dhe padrejtësitë që kanë bërë. Ngaqë Allahu Teala është i drejtë dhe ia ka ndaluar vetes zullumin, nuk i bën padrejtësi askujt.

“Ne nuk u bëmë atyre padrejtësi, por ata i bënë padrejtësi vetvetes...” (Hud, 101) Ky ajet është përsëritur tri herë me të njëjtën formë.

Lartësimi, poshtërimi, shpëtimi dhe shkatërrimi i popujve është i lidhur me sjelljet e tyre të mira apo të këqija dhe me mënyrën e jetesës së tyre, të ligjshme apo të paligjshme. Robërit bëjnë, ndërsa Zoti krijon. Të gjithë korrin atë që kanë mbjellë. Allahu i Madhëruar në Kuranin Fisnik thotë:

“Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka. Në dobi të tij është e mira që bën, kurse në dëm të tij është e keqja që punon...” (Bakara, 286)

Shtetet mund të qëndrojnë në këmbë në kufër dhe shirk përderisa janë të drejta, por, nëse janë të padrejta, nuk mund të qëndrojnë qofshin ato edhe myslimane. Kjo e vërtetë shprehet kështu në librin tonë fisnik:

“Zoti nuk do t'i shkatërronte kurrë vendet padrejtësisht, nëse banorët e tyre do të ishin të drejtë.” (Hud, 117)

Nëse në një vend njerëzit nuk i bëjnë padrejtësi njëri-tjetrit, nëse pushtetarët nuk i bëjnë padrejtësi popullit dhe të gjithë i respektojnë të drejtat e njëri-tjetrit, nuk shkatërrohen, nëse janë femohues apo politeistë. Shprehja “bi dhulmin /padrejtësisht” që përmendet në ajet, sipas shumë komentuesve të Kuranit do të thotë politeizëm dhe mohim i fesë. Edhe Kurtubiu dhe Fahreddin Razi janë në këtë mendim. Ndërsa Ibn Tejmije shprehet:

“Allahu e mban në këmbë një shtet të drejtë, edhe nëse e mohan fenë, por nëse është i padrejtë e shkatërron, edhe nëse është mysliman. Thuhet se kjo botë mund ta vazhdojë ekzistencën e saj me drejtësi dhe mohim të fesë, por jo me padrejtësi.”

Në një vend ku është Islami, nuk duhet të ketë padrejtësi, sepse këto dy koncepte janë të kundërt me njëri-tjetrin. Këtu nuk ka ndonjë gjë të habitshme. Këtë e vërteton historia dhe jeta e përditshme. Ne po e shikojmë gjendjen e shumë vendeve myslimane, që në fjalë janë myslimane, por populli dhe udhëheqësit janë të padrejtë. Mbajtja e anës së dikujt, ryshfeti, favorizimi i dikujt, fitimi haram, gënjeshtria dhe shtirja në një vend mysliman me emër,

nuk ka ndonjë kuptim. Sikundër kësaj, është e qartë edhe gjendja e shteteve jomyslimane që janë të drejta dhe e respektojnë drejtësinë.

Sikur Allahu Teala të mos jepte mundësi për të jetuar, që në fillim nuk do t'u jepte mundësi për të jetuar jomyslimanëve. Zoti është i drejtë dhe të gjithëve u jep shpërblimin e veprës së tyre. Në Kuranin Fisnik thuhet:

“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë dhe kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.” (Zelzele, 7-8)

“Ne i mbështesim të gjithë me mirësitë e Zotit tënd edhe ata që duan këtë botë, por edhe ata që duan ahiretin. Mirësitë e Zotit nuk i mohohen askujt.” (Isra, 20)

Të qenët e një myslimani i drejtë në kuptimin e vërtetë të fjalës, e bën atë të largohet nga padrejtësia. Kjo është ajo që i ka hije myslimanit. Por ideali është tjetër dhe realiteti është krejt tjetër. Nganjëherë, besimtari mbart cilësi qafiri dhe qafiri mbart cilësi besimtari. Edhe pse të gënjeshtër, të mos e mbash premtimin dhe të mos e kthesh amanetin është prej cilësive të hipokritëve, këto cilësi po shikohen edhe te shumë besimtarë. Po ashtu, ka edhe shumë jomyslimanë që i respektojnë të drejtat.

Cilësia “i Mëshirshëm” e Zotit, përfshin të gjithë në këtë botë, qofshin besimtarë apo qofshin jobesimtarë. Ndëshkimi i mosnjohjes së Allahut Teala sigurisht se është xhehenemi në ahiret. Ndërsa shpërblimi i besimit është xheneti. Ne do të shpërblehemi sipas veprave që bëjmë në këtë botë që po jetojmë. Umeri (r.a.), ka thënë:

“Drejtësia është baza e çdo gjëje.”

Zoti (xh.sh), ka vendosur një peshore / një masë për çdo gjë. Toka dhe qiejt e vazhdojnë ekzistencën e tyre me këtë masë. Ligjet e natyrës që i quajmë sunnetullah, shprehin këtë masë. Në ligjet e Allahut të madhëruar nuk ka ndonjë devijim apo ndryshim. Heqja e sunnetullahut do të thotë shpërthim i kiametit. Ndërsa kiameti i popujve shpërthen kur ata nuk u përmbahen rregullave dhe drejtësisë. Prishja më e vogël e ekuilibrit, shkatërron çdo gjë.

Kur njëri prej beduinëve shkoi te i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe e pyeti: “Kur do të bëhet kiameti?” Resulullahu iu përgjigj:

“Kur të humbë amaneti, prite kiametin.” Beduini e pyeti:

“Si humbet amaneti? Pejgamberi (a.s.), u shpreh: “Kur puna t'u jepet të paaftëve.” (Buhari, Ilm, 2)

Të paaftët nuk mund ta bëjnë punën si duhet. Nëse puna nuk kryhet siç duhet, atëherë shndërrohet në padrejtësi.

Allahu e mban
në këmbë një shtet të drejtë,
edhe nëse e mohan fenë, por
nëse është i padrejtë
e shkatërron, edhe
nëse është mysliman.

si. Fundi i padrejtësisë është shkatërrim. Padrejtësia i shkatërron vendet dhe e zhduk begatinë, sigurinë dhe qetësinë. Ndjenja e së drejtës dhe drejtësisë dobësohet dhe njerëzit nuk i besojnë njëri-tjetrit. Shpresat shuhën dhe dëshirat thyhen. Siç e shkatërrojnë mikrobet trupin e njeriut dalëngadalë dhe në fund i sjellin vdekjen, edhe padrejtësitë i shpien popujt dalëngadalë drejt shkatërrimit. Kjo është si një shkëndijë e vogël e pafikur, që djeg një pyll madhështor apo një vend të tërë.

Allahu Teala, për shkak të cilësisë së dhembshurisë, nuk i ndëshkon të padrejtët menjëherë në këtë botë. Zoti u jep kohë, por nuk neglizhon asgjë. Këtu ka urtësi të ndryshme. Një padrejtësi që duket e tillë në aparencë, në të vërtetë mund të jetë ndëshkimi i një padrejtësie tjetër. Nganjëherë Allahu, xhelle xhelaluhu, e merr hakun nga një i padrejtë me një të padrejtë tjetër. Allahu Teala thotë:

“...Ne u japim pushtet disa keqbërësve mbi të tjerët, si dënim për veprat e tyre të këqija.” (En’am, 129)

I padrejti është si kërbëçi i Allahut në tokë. Së pari, merr hak me të dhe pastaj, ia merr hakun atij. Njerëzit udhëhiqen me një udhëheqje që meritojnë. Të urtët kanë thënë: “Veprat tuaja janë udhëheqësit tuaj.”

Vonimi i ndëshkimit mund të jetë edhe një shans për t’u penduar nga padrejtësia e bërë. Nëse i padrejti nuk pendohet dhe vazhdon në padrejtësi, ndëshkimi i tij është absolut. Në Kuranin Fisnik, thuhet:

“Mos mendo kurrësi se Allahu nuk e vëren atë që bëjnë keqbërësit! Ai vetëm ua shtyn (dënimin) deri në ditën, kur sytë e tyre do të zgurdullohen (nga tmerret që do të shohin).” (Ibrahim, 42)

Vendi ku do të shfaqet plotësisht drejtësia, është Kiameti. Është Gjyqi i madh. Sepse aty i gjithë autoriteti është i Allahut Teala. Aty nuk bëhet fjalë për favoritizim apo mbajtje të anës së dikujt.

Kushti më i rëndësishëm për të qenë i sigurt në këtë botë dhe në ahiret është qëndrimi larg padrejtësive dhe të padrejtëve. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Qëndroni larg padrejtësisë, sepse padrejtësia do të jetë errësirë për të padrejtin Ditën e Kiametit.” (Muslim, Birr, 56)

Ngaqë i padrejti ia ka bërë jetën burg atij që i ka bërë padrejtësi, edhe jeta e tij në ahiret do t’i kthehet në burg. Përsëri le t’ia vëmë veshin fjalëve të të Dërguarit të Allahut (a.s.):

“Kushdo që mund t’i ketë bërë ndonjë padrejtësi vëllait të tij në fe, në lidhje me nderin, namusin apo pasurinë, le t’i marrë hallallëkun para se të vijë Dita e Kiametit, në të cilën nuk ka florinj dhe argjend. Përndryshe, nëse ka vepra të mira, i merren sevapet aq sa ka bërë padrejtësi dhe i jepen atij që është dhunuar. Nëse nuk ka mirësi, merren mëkatet e vëllait, aq sa i ka bërë padrejtësi dhe i jepen atij.” (Buhari, Mezalim, 10)

Qëndrimi pranë të padrejtëve dhe mbështetja e tyre është qëndrim afër xhehenemit. Allahu i Lartësuar thotë

në Kuran:

“Mos anoni nga ata që bëjnë të këqija, përndryshe do t’ju përcëllojë zjarri. Ju nuk do të kenë mbrojtës tjetër përveç Allahut dhe nuk do të ndihmoheni.” (Hud, 113)

Animi nga të padrejtët bëhet duke i konsideruar të prapueshme padrejtësitë e tyre, duke i mbështetur ata dhe duke marrë mbështetje prej tyre. I padrejti nuk mund të bëhet mik, sepse ai është armik edhe i atij që e bën mik. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Kushdo që e ndihmon të padrejtin, Allahu ia bën atë bela në kokë.” (Keshfu’l-Hafa, Hadithi nr: 2380)

I padrejti është një njeri, që së pari, i bën padrejtësi vetes nëpërmjet të tjerëve. I padrejti është një njeri që i bën gropën vetes. Sa më e madhe të jetë padrejtësia, aq më e madhe bëhet gropa dhe vështirësia për të dalë nga ajo.

Ndihma dhe mbështetja më e mirë që mund t’i bëhet të padrejtit, është të larguarit e tij nga padrejtësia. Pejgamberi, (a.s.), ka thënë:

“Ndihmoje vëllain tënd, qoftë dhunues apo i dhunuar.” E pyetën: “Të dhunuarin e ndihmojmë, por dhunuesin si ta ndihmojmë?” Ai (a.s.), u përgjigj:

“Ndalojeni atë nga padrejtësia. Edhe kjo është ndihmë për të.” (Buhari, Mezalim, 4)

“Nëse njerëzit e shikojnë të padrejtin dhe nuk e pengojnë padrejtësinë e tij, e kanë afër ndëshkimin që do t’u dërgojë Allahu. Ky ndëshkim do të përhapet mbi të gjithë ata.” (Tirmidhi, Fiten 8)

Të gjithë e dinë se çfarë fatkeqësish të mëdha sjell animi nga i padrejti dhe mbështetja ndaj tij, ndërkohë që duhet ndaluar padrejtësia që bën. Edhe ata që e mbështetën Faraonin, u mbytën bashkë me të në det. Allahu i Lartësuar thotë:

“Faraoni dhe ushtria e tij u sollën me arrogancë dhe padrejtësi në tokë, duke menduar se nuk do të ktheheshin te Ne. Por Ne e kapëm atë dhe ushtrinë e tij dhe i hodhëm në det. Shiko se cili ishte fundi i keqbërësve!” (Kasas, 39-40)

Ndërsa, pendimi në jetën tjetër i atyre që i pasojnë të padrejtët, shprehet kështu:

“Ditën, kur fytyrat e tyre do të rrotullohen në zjarr, ata do të thonë: ‘Ah, sikur t’i ishim bindur Allahut dhe të Dërguarit!’ Dhe do të thonë: ‘O Zoti ynë, ne iu bindëm parisë sonë dhe eprorëve tanë, por ata na shmangën prej rrugës së drejtë. O Zoti ynë, jepu atyre dënim të dyfishtë dhe mallkim të madh!’” (Ahzab, 66-68)

Në një hadith fisnik, që transmeton Bejhakui, i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

“Nëse dikush lutet për të padrejtin, do të thotë se i pëlqen kundërshtimi i Allahut në tokë.”

Njëherë Imam Sufjan Theurin e pyetën: “A lejohet t’i japësh një gllënjë ujë të padrejtit, që është duke vdekur?” Ai u përgjigj:

“Jo. Lëreni të ngordhë!”



SËMUNDJET E ZEMRËS

Muhamed El-Gazali

Adhurimi i vërtetë ndaj Allahut është të gërmosh në veten tënde dhe të drejtosh çdo gjë të shtrembër, të fshish çdo gjë të keqe, dhe të shërosh çdo sëmundje kronike, ditë e natë. Që vdekja të të gjejë të pastër ose duke luftuar për arritjen e këtij pastrimi.

Vetëkënaqësia është shenjë e të vegjëlve dhe të mbyllësh sytë ndaj saj, ndërkohë që i bën katër sytë dhe veshët ndaj gabimeve të të tjerëve, është rrugë e humbjes!

Kam parë disa grupime fetare, të cilat rendin duke numëruar gabimet e të tjerëve, ndërsa në të njëjtë kohë ndaj gabimeve të tyre rrinë shumë larg, pothuajse e konsiderojnë veten të pagabueshëm!

Të krenohesh me të vërtetën është një gjë dhe vetëkënaqësia është një gjë tjetër! Të krenohesh me të vërtetën është ndjesi e mirësisë së Allahut, madhështi e suksesit të dhuruar, dëshirë për ta përhapur këtë të vërtetë, në mënyrë që askush të mos privohet nga ajo dhe keqardhje ndaj atyre që largohen dhe privohen prej saj.

Mendo pak rreth këtij dialogu: Një njeri i tha një tjetri: - Unë të dua për hir të Allahut! Tjetri i tha: - Sikur të dish për mua çfarë unë di për veten time, do të më kishe urryer për hir të Allahut!

Njeriu ia ktheu: - Sikur të dija për ty çfarë di ti për veten tënde, atëherë unë do të isha i zënë me ato çfarë di për veten time...

Besimtarin e mençur e shqetësojnë gabimet e tija dhe nuk merret me të metat e njerëzve. Ai e di se është i nevojshëm për Mëshirën e Lartë dhe në qoftë se ka mirësi më tepër se ata, atëherë kjo i konsiderohet barrë dhe jo vlerë.

Dituria e tepërt kërkon përpjekje më të mëdha, jo lakmi ndaj krijesave dhe pusi ndaj tyre, sepse në një hadith thuhet: **"Një njeri tha: - Pasha Allahun, Allahu nuk e falë filanin! Allahu tha: "Kush është ai që ndërhyr në punët e Mia? Unë e kam falur atë dhe ta kam zhvlerësuar punën tënde".**

Më kujtohet, kur një djalë i ri i zemëruar m'u afrua duke më qortuar dhe më tha: - Ti qëndron me student të me mjekra të rruara dhe studente të pambuluara me shami, njerëzit të shikojnë të buzëqeshur dhe jo të vrenjtur dhe nuk dëgjojnë prej teje asnjë urdhër, apo ndalesë. Si justifikohesh ti me këtë mënyrë të sjelluri?

I thashë: - Nuk e besoj që të vrenjturit është prej kushteve të thirrësve. Unë, së pari u shpjegoj gjërat elementare të Islamit, në besim dhe në moral. Në qoftë se fara është e mirë edhe frutat do të vinë në kohën e tyre! Ditën që njerëzit do ta njohin Zotin dhe do të lidhen me Të mbi parimin e dëgjimit dhe të bindjes, atëherë ajo çfarë ti kërkon, madje edhe më shumë se çfarë kërkon do të realizohet...!

Ndërsa për çështjen e justifikimit tim, nuk di se çfarë të them për të? E falënderoj Allahun, i Cili ka lëshuar perden e Tij mbi mua dhe nuk ju ka dhënë mundësi ndaj meje!

Ju keni epsh që krijesat të diskreditohen, në mënyrë të kënaqni veten tuaj dhe ky epsh është sëmundje më e ndytë se sa gjynahet, me të cilat i kritikoni njerëzit.

O biri im, kam frikë se me këto qëllime të errëta do të bëheni një e keqe për të tjerët!

Një gjynahqar zemërthyer është më i ndershëm se sa një predikues, që mbikëqyr njerëzit me ashpërsi.

Përktheu
Lavdrim Hamja

Përkufizimi i zemrës besimtare

Xhafer Durmush

Si përkufizohet zemra besimtare në Kuranin Fisnik? Si duhet ta përfytyrojmë zemrën e mbushur me besim?

Në Kuran, siç përkufizohen zemrat e sëmura dhe të vulosura të jobesimtarëve, ashtu informohemi edhe për nivelet e larta shpirtërore të zemrave të besimtarëve. Tërhiqet vëmendja në aspekte të ndryshme drejt cilësive shpirtërore të besimtarit, i cili ka arritur me metodën e tij të fesë të disiplinojë të ecurit, të ngrënët, të pirët, të komunikuarit dhe të qeshurit.¹ Në suren el-Hashr ka dy ajete që na tregojnë si mund të arrihen gradat e larta:

“Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin që më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndejnë kurrfarë rëndimi për atë, që u është dhënë atyre, por duan t’u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.

Edhe ata që erdhën pas tyre, thonë: “O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!” (Hashr, 9-10.)

Ajeti i parë që përbën temën tonë është ajeti që tregon se kujt do t’i jepet më parë plaçka e luftës. Ai thekson edhe rëndësinë e bujarisë dhe të sakrificës së ensarëve të nderuar. Ndërsa në ajetin pas tij, tregohet një synim sublim për brezat e ardhshëm hallkë pas hallke, duke filluar nga tabiinët dhe tebei tabiinët.

Në ajetin fisnik shprehet domosdoshmëria e mbrojtjes nga koprracia e egos, si kusht për të arritur shpëtimin, sepse askush nuk mund të mbrohet nga ngushtimi i zemrës pa ndihmën e Allahut Teala. Nisur nga kjo, krahas përpjekjes së veçantë, duhet edhe lutje e veçantë për këtë.

Fjala “shuhha” në ajet, në arabisht shpreh dorështrëngimin dhe koprracinë. Por kur kjo fjalë i atribuohet egos, kuptimi i saj bëhet më gjithëpërfshirës dhe do të thotë: i

ngushtë në mendime, smirëzi, koprrac dhe egoist. Ajo është një fjalë kyçe, që tregon me përmbledhje disa sëmundje shpirtërore në mënyrë më përfshirëse nga shprehja “koprracia e egos (vetes)”, që preferohet në përkthim. Nisur nga kjo, *shuhha* konsiderohet edhe si shkak i koprracisë.

Ibn Umeri, (r.a.), e përkufizon kështu fjalën shuhha: “Shuhha nuk është thjesht shtrëngimi që njeriu i bën pasurisë së tij, por lakmimi i asaj që nuk është e tij.” Sepse ai që e mbart këtë cilësi të shëmtuar është koprrac edhe për pasurinë e tjetrit dhe nuk dëshiron të shohë bujari. Pothuajse i ngushtohet zemra nga kjo.²

Nisur nga ato që thamë më sipër, pastrimi i vetes nga kjo cilësi e shëmtuar është konsideruar prej kushteve të shpëtimit. Edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), e konsideronte koprracinë e nefsit si burim shkatërrimi dhe ka thënë:

*“Kini kujdes nga shuhha, sepse ajo i ka shkatërruar popujt e mëparshëm.”*³ Ndërsa në një hadith tjetër, që transmetohet nga Ebu Hurejra, radijallahu anh, ka thënë:

“Besimi dhe koprracia e nefsit, nuk mund të qëndrojnë bashkë.”

Besimtari duhet të ketë kujdes për zemrën e tij, duhet të kërkojë shembuj të përsosur, që e mbartin atë te grada e butësisë dhe mirësjelljes dhe duhet të vendosë për t’u bërë një hallkë e zinxhirit të të mëvonshmëve që lavdërohen në ajet.

Enesi (r.a.), transmeton:

Një ditë, kur i Dërguari i Allahut (a.s.), po qëndronte me shokët e Tij dhe po u thoshte:

“Tani do të vijë pranë jush një burrë, që është prej banorëve të xhenetit.” Pastaj erdhi një burrë prej ensarëve, të cilit i rridhte nga mjekra uji i abdesit.

Kypërgëzim u përsërit tri herë në mexhlisin e sahabëve dhe çdo herë vinte i njëjti ensar. Nisur nga kjo, biri i Amr bin Asit, Abdullahu (r.a.), vendosi ta ndiqte burrin e përgëzuar

2. Shik. Elmallëllë Hamdi Jazër, Hak Dini Kuran Dili, komentimi i ajeteve në fjalë.

3. Shik. Muslim.

1. Shik. El-Haxh, 22/35, el-Gafir 23/60, er-Ra’d 13/28.

me xhenet, në mënyrë që të mësonte se çfarë vepronte. Ensarit i kërkoi leje që të rrinte në shtëpinë e tij si mysafir, duke i thënë se ishte zemëruar me babain. Pasi qëndroi tri ditë si mysafir, e ndjeu të nevojshme t'i tregonte të vërtetën e çështjes. I tha:

“O rob i Allahut! Unë nuk kam pasur ndonjë zemërim apo mosmarrëveshje me babain tim. Por kur po qëndronim me të Dërguarin e Allahut, (a.s.), ai tha tri herë:

“Tani do të vijë pranë jush një burrë, që është prej bano-rëve të xhenetit.” Sa herë që thoshte kështu, vije ti.

Unë u solla kështu për të mësuar veprat prej të cilave u përgëzove me xhenet, por nuk pashë se bëje shumë. Çfarë ke bërë ndonjë gjë që i vërteton ato që ka thënë i Dërguari i Allahut (a.s.), për ty?

Ensari i përgëzuar me xhenet iu përgjigj: “Siç e pe, unë nuk kam ndonjë vepër të madhe. Por në zemrën time nuk gjendet dredhi kundrejt asnjë myslimani. Askënd prej robërve të Allahut nuk e kam zili për ndonjë mirësi që i është dhënë.”

Abdullahu (r.a.), i tha: “Ja, kjo është ajo që të ka ngritur në këtë gradë. Këtë nuk mund ta bëjnë të gjithë.”⁴

Islami është një det i pastër dhe i begatshëm. Çdo virtyt që e zotëroni prej tij, ju shpie te kënaqësia e Allahut

4. Shik. Ibn Kethir, Kometimi me Hadithe i Kuranit Fisnik, shpjegimi i ajetit në fjalë.

Teala. Virtyti më i vlefshëm, sigurisht është paqja shpirtërore, kapërcimi i egoizmit e lakmisë dhe bashkimi me umetin...

Tani po i mbyll sytë dhe po mendoj për një zemër besimtare, të pastër dhe të dëlirë nga kopraccia.

Po mendoj për një ndërgjegje që është bërë peshore e përpiktë në ndarjen e së vërtetës nga e gabuara.

Po përfytyroj një zemër që u jep përparësi vëllezërve në fe ndaj vetes, edhe pse është në nevojë.

Po mendoj një zemër, zotëruesi i së cilës ka një kraharor të gjerë, saqë mund të përqafojë të gjithë botën. Kur i hap duart për t'u lutur, i fut në përgjërimin e tij të gjithë besimtarët me të djeshmen, të sotmen dhe të nesërmen e tyre. Thotë: “O Zot! Mos lër në zemrën time urrejtje kundrejt besimtarëve!” Në këtë mënyrë, kjo zemër që s'e zë as toka, e as qielli, bëhet e tëra e përkushtuar ndaj Rrahmanit. Në këtë kohë, kur mënyra e jetës me në qendër unin është bërë më e vlefshme dhe kur nefsi hidhet duke thënë “së pari unë”, kur bëhet fjalë për interesa, ai mund të thotë: “Jo! Së pari vëllai im.” Ai nuk mbart në zemër urrejtje kundrejt asnjë myslimani dhe nuk mendon për të bërë dredhi. Kapilarët e zemrës së tij ushqehen me virtytet e moralit Islam.

Kur vetëdija e kërkimit të një zemre të tillë të jetë e gjallë dhe kur, së pari, të fillojmë nga vetja jonë, do të thotë se jemi në rrugë të drejtë.

Lexo, Mendo

Çfarë do të thotë kalbi selim?

“Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allah! Atë ditë xheneti do t'u afrohet besimtarëve të devotshëm, ndërsa xhehenemi do t'u tregohet atyre që kishin humbur.” (Shuara, 88-91.)

Zotëruesi i zemrës së pastër është ai që e ka pastruar atë nga çdo lloj dyshimi e shirku dhe ka besuar me sinqeritet. Said ibni Musejjebe (r.a.), thotë: “Zemër e pastër është zemra besimtare e shëndetshme shpirtërisht, sepse zemrat e mohuesve dhe të hipokritëve janë të sëmura shpirtërisht.”

I ndjeri, Hz. Sami Efendi, e përkufizon kështu zemrën e pastër: “Të mos lëndosh askënd dhe të mos lëndohesh nga askush.” Dhe shton: “Të mos lëndosh është e lehtë, ndërsa të mos lëndohesh është e vështirë.”

DRIDHJA ËSHTË SHENJË E NDJESHMËRISË

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që zemrat e tyre dridhen kur përmendet Allahu. Kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten.” (Enfal, 2.)

Besimi që është shenjë treguese e gjallërisë së zemrës, nuk shfaq një natyrë të ngathët. Përkundrazi, ai është një strukturë e volitshme për t'u zgjeruar dhe përmirësuar. Siç e ul cilësinë e tij mohimi i një të vërtete, pranimi e vërtetimi e zhvillojnë atë.

Nëse besimtari dridhet nga përdëllimi kur lexohen ajetet e Allahut Teala, kjo tregon gjallërinë e zemrës së tij. Po ashtu, tregon se do t'i kryejë me sinqeritet edhe ibadetet e përmendura në ajetet vijuese.

Mesazhi i Fjalës së bukur

Prof. dr. Jashar Kandemir

Në suren el-Isra, thuhet:

“Thuaju, robërve të Mi, të flasin atë që është më e mira. Në të vërtetë, djalli mbjell ngatërresa ndër-mjet tyre. Vërtet, djalli është armik i hapur i njeriut.”
(Isra, 53.)

Allahu (xh.sh.), i cili i ka dhënë njeriut aftësinë e të folurit, thotë: ***“Thuaju, robërve të Mi, të flasin atë që është më e mira.”***

Kur lexoni këtë ajet, zemrën ua ngroh dëshira për të hyrë në grupin e fatlumëve, që Allahu i Lartësuar i përmend me shprehjen “ibadi / robërit e Mi”.

Mendoni: Allahu i Madhëruar, me mëshirën e Tij të pafundme, i drejton bisedat tuaja. Me këdo që të flisni, ju urdhëron të zgjidhni fjalët më të mira. Urdhëron të flisni pa e lënduar bashkëbiseduesin tuaj dhe të gjeni e të shprehni atë fjalë që hedh në zemrën e tij dashurinë ndaj së vërtetës.

Ju duhet ta respektoni këtë, kur të flisni edhe me mëkatarët dhe qafirët. Kundrejt tyre nuk duhet të përdorni fjalë të prera dhe lënduese. Çështjen e atij që keni përballë, nuk duhet ta nënçmoni. Bashkëbiseduesin

nuk duhet ta detyroni të përdorë shprehje nxitëse. Duhet të jeni të kujdesshëm kundrejt cytjeve të djallit të mallkuar.

Allahu i Madhëruar i urdhëron besimtarët të zgjedhin më të mirën dhe të sillen me ndjeshmëri pothuajse në çdo çështje. Për shembull, urdhëron që të kenë kujdes se çfarë hanë dhe çfarë pinë. Ndërmjet mirësive të pafundme që i ka nënshtruar ndaj njerëzve, urdhëron që të zgjedhin hallallin dhe të pastrën. (Shik. el-Bakara, 2/168.) Kjo mund të themi se ka lidhje me strukturën fizike dhe me jetën individuale. Ndërsa në ajetin që përbën temën tonë, flitet për dinamikën bazë që formon paqen dhe qetësinë në jetën sociale. Kjo përkon me misionin e vërtetë të besimtarit, që vërtetohet me këtë ajet:

“Ju jeni populli më i mirë, i dalë për njerëzimin. (Sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun...” (Al’Imran, 110.)

Atëherë, gjithmonë jeni të detyruar të flisni duke zgjedhur fjalët më të bukura, më të drejta dhe më të dobishme. Nisur nga kjo, ajeti fisnik që përbën temën tonë, shpreh një domosdoshmëri përtej garës së virtytshmërisë, sepse këtu shprehet një urdhër që s’ka

lidhje me kohën dhe vendin.

Tani po mendoj:

Çfarë është fjala *e mirë*? Sepse jam i detyruar ta di këtë, që të zbatoj urdhrin e dhënë në ajet. Në këtë çështje, përgjigjen e pyetjes e gjej në një ajet tjetër. Në suren Fussilet, Allahu Teala pyet:

“Kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: ‘Unë, me të vërtetë jam mysliman.’” (Shih 41/33.)

Transmetohet se personi, për cilësitë e të cilit bëhet fjalë në këtë ajet, është i Dërguari i Allahut, (a.s.). Kjo e bën edhe më të domosdoshme zgjedhjen e fjalës së bukur në çdo aspekt.

Në Ruhu'l-Bejan thuhet: Fjala më e bukur është përkujtimi i Allahut, duke thënë ‘la ilahe illallah’ me plot sinqeritet. Vepra më e bukur është çdo lloj pune që bëhet në përputhje me të vërtetën dhe me fenë. Ndërsa, karakteri më i bukur është që njeriu t’i dorëzohet me gjithë vullnetin e tij Allahut Teala, t’u bëjë mirë njerëzve pa pritur ndonjë shpërblim prej tyre, t’i falë të keqijat që mund t’i vijnë prej tyre, të gjendet ndërmjet njerëzve duke shfaqur dashuri për ta dhe t’i inkurajojë njerëzit për të bërë vepra të mira, pa i imponuar e t’i ndalojë nga e keqja pa i nënçmuar.

“Thua ju, robërve të Mi, të flasin atë që është më e mira. Në të vërtetë, djalli mbjell ngatërresa ndërmjet tyre. Vërtet, djalli është armik i hapur i njeriut.”

Ndërsa rezultatet e rrezikshme, që lindin nga moszbatimi i këtij urdhri të ajetit fisnik, shpjegohen kështu:

Përndryshe, shejtani do të hyjë ndërmjet njerëzve dhe do t’i inkurajojë për t’u grindur me njëri-tjetrin. Ndërmjet tyre do të mbjellë farërat e prishjes me sjellje të ashpra dhe të vrazhda. Sepse, përderisa njerëzit të mos e këshillojnë njëri-tjetrin dhe të mos sugjerojnë për të mira, djalli hyn lehtësisht ndërmjet tyre dhe ua shkatërron ndjenjat e vëllazërisë.

Tani mund të themi: Fjalët e bukura nxjerrin në pah sjellje të mira dhe me to arrihet uniteti dhe vëllazëria në shoqëri. Ndërsa sjelljet e vrazhda, që lindin prej fjalëve të shëmtuara, e shkatërrojnë mjedisin e qetë, i cili është formuar me përkujdesje. Sepse djalli gjen

mundësinë për t’i ngatërruar njerëzit me anë të fjalëve të shëmtuara, të vrazhda dhe të pahijshme.

Në fjalët e pamatura, që dalin nga goja në momentin e zemërimit, gjenden rrugë që ndikojnë për të prishur.

Atëherë, fjala e bukur është një valvul sigurie, që nuk i jep mundësi kalimi armikut të përbetuar të njerëzve, shejtanit, për të hyrë në fushat, ku mund të ndikojë. Ëmbëlsinë e Islamit mund t’ia shfaqim botës vetëm me anë të tyre (fjalëve të bukura). Kapitali ynë më i rëndësishëm është fytyra jonë e buzëqeshur, është fjala jonë e bukur dhe gjuha jonë e ëmbël. Në të njëjtën kohë, ajeti fisnik tregon edhe zgjidhjen e këtij problemi, në mënyrë që të mos i jepet shejtanit ajo mundësi.

Në suren Bekare thuhet se një fjalë e bukur, që i inkurajon njerëzit për mirësi dhe falja e gabimeve, është më e lartë se lëmosha që përcillet me fyerje. (Shih 2/263.)

Ndërsa i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë se fjala e bukur është më e vlefshme se lëmosha me të cilën ushqehen të uriturit dhe plotësohen nevojat e tyre. (Shih Buhari, Edeb, 34.) Po ashtu, na ka paralajmëruar se fjala e shëmtuar është haram për t’u thënë.

Sa paralajmërim i madh është ky për njeriun, i cili komunikon me anë të të folurit, që është cilësia më e dallueshme ndërmjet të gjitha krijesave.

Sigurisht se fjala më e bukur është Kurani Fisnik dhe njeriu që flet më bukur është i Dërguari i Allahut, (a.s.), nëpërmjet të cilit Kurani iu shpall njerëzimit.

Të tjerat janë të vlefshme dhe të bukura, aq sa kanë afërsi dhe përputhshmëri ndaj këtyre të dyjave.

Meqë myslimanëve u takon autoriteti dhe përgjegjësia për t’ia shpallur njerëzimit fjalët e bukura që burojnë prej këtyre, sot është shumë me rëndësi që ta mbartin, ndjejnë dhe jetojnë këtë hijeshi me të gjithë seriozitetin e madh të saj.

Gjëja e mirë dhe e bukur, sigurisht gjithmonë është e vlefshme. Por vlefshmëria për të cilën po flasim, ndryshon sipas mungesës dhe shumicës së asaj gjëje. Atëherë, të gjithë duhet të themi fjalët më të bukura, në mënyrë që të zbukurojmë veprat, moralin dhe mendimet tona. Zemrave që nuk e njohin këtë shije, duhet t’u thuhet fjalë të bukura si lëmoshë. Ne duhet ta përhapim këtë amanet në çdo vend ku mund të arrijmë, duke filluar nga të afërmit.



TEVHIDI

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Mbas periudhës iluministe, në shekullin e XX-të ndikimi i rrymave materialiste dhe pozitiviste hyri në jetën e përditshme si stil jetese dhe i ndihmuar nga mjetet e komunikimit modern u vetëshpall si modeli më i mirë për gjithë njerëzimin.

Sistemi filozofik i shekullit të kaluar, i cili e përkufizonte jetën vetëm si një interval kohor midis lindjes dhe vdekjes dhe që pretendonte se parajsja e premtuar mund të realizohej vetëm në këtë botë, injoronte çdo vlerë, çdo fe, çdo gjë të shenjtë, duke

i ofruar në këtë mënyrë egos një mjedis me liri të pakufizuar. Sipas kësaj filozofie, njeriu duhet të përfjethë çdo kënaqësi të kësaj bote, pa u penguar dhe kufizuar nga asgjë. Dhe e gjitha kjo në emër të lumturisë së njerëzimit, sepse sipas kësaj filozofie, rruga e lumturisë kalon përmes harbimit dhe shfrenimit të papërmbajtur. Shfrenimi, megjithëse mund t'i sigurojë individit një lumturi momentale, shoqërohet me pangopësi dhe lindjen e dëshirave të reja.

Krahas përhapjes së pozitivizmit dhe ateizmit,

njerëzimi është duke u përballur me probleme serioze fetare, përkundrejt përhapjes dhe ekspansionit të rrymave të shumta të devijuara, si: satanizmi, misionerizmi, budizmi, hinduizmi, jehovaizmi etj. Përpjekjet për të krijuar ndarje dhe dallime duke përdorur ideologji dhe sekte të ndryshme fetare, janë shndërruar sot në një problem madhor. Por krahas këtyre përpjekjeve për të devijuar njerëzit nga feja, është fakt edhe një rikthim i njeriut te feja dhe jeta fetare. Është për t'u gëzuar nga fenomeni i ringjalljes së jetës fetare dhe rikthimit të vështrimit nga feja.

BOSHTI I ZGJIDHJES SË PROBLEMEVE BASHKËKOHORE

Sekreti i zgjidhjes së problemeve bashkëkohore qëndron në përvetësimin e një disipline shpirtërore. Mënyra më e sigurt për të shpëtuar njerëzit nga sektet e devijuara, është pajisja me dituri dhe ndjenja fetare të sakta dhe krijimi i kushteve optimale për zbatueshmërinë e tyre në jetë, sepse jeta fetare nuk mund të ekzistojë vetëm me interesimin dhe dashurinë për të. Por në rrugën e jetës fetare më tepër se mësimi teorik, është i rëndësishëm zbatimi dhe praktika e mësimave fetare. Pra, feja është e bazuar në binomin besim-veprim. Besimi i ushqyer dhe i forcuar me vepra të mira është një udhërrëfyes shumë më i sigurt për jetën në këtë botë dhe botën tjetër. Qëllimi kryesor i njerëzve që jetojnë në vorbullën e modernizmit, duhet të jetë zgjidhja e problemit fetar dhe kthimi me dashuri te Krijuesi i gjithësisë.

Ajo që e mban të gjallë, i jep gjallëri, i jep shpirt njeriut në kuptimin e vërtetë është feja. Njeriu që mbështet dhe strehohet në besimin tek Allahu i Përhershëm dhe i Gjallë, gjen jetë dhe gjallëri. Zemra e njeriut ndriçohet përmes shpalljes hyjnore dhe mbahet e gjallë me frymën e Kuranit. Personi që ka gjetur Kuranin dhe Pejgamberin, është plot gjallëri dhe energji. Kurse kush jeton larg kësaj strehe, zhytet në krizë besimi dhe me kalimin e kohës vdes shpirtërisht.

Një besim i shëndoshë i siguron njeriut një mburojë të fortë kundër ndikimeve të jashtme. Imani ndriçon zemrën si një pishtar. Por kjo dritë është gjithmonë nën sulmet e faktorëve të jashtëm, që përpiqen ta zbehin apo ta shuajnë plotësisht atë. Mbrotja nga kjo, sigurohet duke e lidhur zemrën me Allahun, duke u dhënë gjallëri parimeve fetare dhe duke besuar

fort në botën tjetër.

Besimi në botën e amëshuar rrit kuptimin dhe vlerën e jetës. Një person që jeton me vetëdijen e ringjalljes dhe gjykimit pas vdekjes, sigurisht që do të bëjë një jetë më të kujdesshme dhe të rregullt. Një person që është i vetëdijshëm se pas vdekjes do të pyetet për Zotin, Librin, Pejgamberin, Fenë dhe për çdo vepër të mirë apo të keqe, sigurisht që do të përpiqet ta mbushë librin e tij me vepra të mira dhe të dobishme.

Nevoja për besim është e lindur tek njeriu. Krijuesi ka vendosur në natyrën e njeriut tevhidin. Ajeti Kur'anor: **"Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë."** (Rum, 30.), shpreh pikërisht këtë realitet. Prandaj njerëzit historikisht kanë jetuar të lidhur pas një besimi apo një ideologjie.

Qëllimi i parë dhe kryesor i feve hyjnore dhe pejgamberëve ka qenë pastrimi shpirtëror i njerëzve, rafinimi i zemrave nga veset e këqija dhe të dëmshme. Pastrimi i zemrës fillon me largimin e çdo besimi dhe ideologjie, që bie ndesh me Tevhidin. Misioni kryesor i pejgamberëve të përmendur në Kuran, ka qenë shpëtimi i njerëzimit nga politezimi dhe ndërtimi i një shoqërie mbi baza të shëndosha besimi. Pejgamberi (a.s.), gjithë periudhën e Mekës e kaloi duke luftuar për Tevhidin.

Tevhidi përmirëson zemrën dhe gjendjen shpirtërore të njeriut, sepse përtej një sistemi mendimi dhe besimi, Tevhidi është një stil dhe model jetese. Niveli i parë i Tevhidit është njësimi i plotë i Zotit. Tevhidi është njësimi i plotë i Allahut në besim, në adhurim dhe pastrimi i plotë i botës shpirtërore nga çdo gjë që ndot Tevhidin.

Një person që beson në Tevhidin e pastër, arrin grada të larta shpirtërore. Në këtë mënyrë, çdo veprim i tij është i mbështjellë nga sinqeriteti dhe bindja e plotë ndaj Allahut. Në këtë mënyrë, Allahu, Krijuesi i gjithësisë bëhet syri i besimtarit me të cilin ai shikon.

Personi i vetëdijshëm për Tevhidin, të vetmin qëllim dhe synim ka Allahun dhe askënd tjetër. Personi që ka vendosur në zemër Tevhidin, shpëton përfundimisht nga kurthet e egos. E gjithë kjo bëhet e mundur, jo vetëm duke e realizuar Tevhidin në besim dhe ibadet, por duke e shtrirë atë në çdo fushë dhe aspekt të jetës.

Kurani

- LAJMI TRONDITËS -

Abdullah Draz

Kurani, për vetë rëndësinë e madhe që ka, duke qenë jo vetëm libër hyjnor, por edhe gur themeli mbi të cilin është ndërtuar qytetërimi, kultura dhe shoqëria islame, është bërë objekt studimi për shumë shkencëtarë, myslimanë dhe jomyslimanë. Shumë orientalistë janë përpjekur të hedhin dyshime mbi autorësinë e Tij hyjnore, duke ia mveshur atë Muhamedit (a.s.). Mbi mrekullitë shkencore të Kuranit, që vërtetojnë burimin e Tij hyjnor, janë shkruar shumë libra. Por ne këtu do të përpiqemi të trajtojmë karakterin hyjnor dhe pamundësinë e Muhamedit

(a.s.), për të qenë autor i Kuranit në një këndvështrim ndryshe.

Për myslimanët, Kurani është fjalë e Allahut, si nga përmbajtja edhe nga forma. Ai nuk mund të jetë kurrë një vepër njerëzore. Kurani është një kryevepër letrare dhe estetike. Për nga këshillat, parimet morale, juridike dhe shoqërore që përmban, është një vepër madhështore. Ai po ashtu është një thesar dhe burim i pashtershëm. Për nga informacionet metafizike që jep, është një mrekulli më vete. Një mendimtari ose shkrimtari i mjafton të ketë autorësinë e vetëm një pjese të vogël të këtij libri, për t'u bërë i pavdekshëm në historinë e njerëzimit. Megjithatë, Pejgamberi (a.s.), nuk pretendon autorësinë e këtij libri, të cilin do ta dëshironte çdo shkrimtar. Ai jo vetëm që nuk e pretendon, por me zë të lartë predikon autorësinë e Tij hyjnore. Përballë refuzimit të autorësisë së këtij thesari, kur të tjerët do të sakrifikonin gjithçka për ta pasur, nuk mbetet gjë tjetër përveçse të pranohet siç është.

Është për t'u habitur nga disa që kërkojnë argumente për të pranuar autorësinë hyjnore të këtij libri.

Një mendje djallëzore mund të thotë: Muhamedi (a.s.), ia ka atribuar autorësinë, Allahut për të fituar prestigj dhe autoritet. Por përse i përket lidhjes dhe besimit të fortë të tij tek

Allahu, e gjithë jeta e Tij është dëshmi për këtë. Po ashtu, të gjithë janë të një zëri, qofshin miq apo armiq të tij, përse i përket besnikërisë dhe sinqeritetit të tij. Një njeri që thotë vetëm të vërtetën për njerëzit, nuk mund të mendohet se do të gënjejë për Allahun. Historia e Muhamedit (a.s.), na jep një profil të qartë të sinqeritetit dhe besnikërisë së tij. Në një rast kur një grup vajzash të vogla po thurnin vargje lëvduese për dëshmorët e luftës së Bedrit, një vajzë ndër të tjera thuri një varg të tillë: "Në mesin tonë ndodhet një Pejgamber që di të ardhmen." Pejgamberi (a.s.), sapo e dëgjo, ndërhyri duke e korrigjuar dhe e ndalo i të thoshte një gjë të tillë. Kurse në një rast tjetër, kur vdiq Osman ibn Maz, një grua tha: "Unë jam dëshmitare që Allahu të ka shpërblyer dhe vendosur në një pozitë të lartë." Pejgamberi (a.s.), i tha: "Ku e di ti se Allahu e ka shpërblyer atë, unë jam i dërguari i Allahut dhe nuk e di përfundimin tim..." Kjo sjellje e tij është paralel me ajetin Kuranor: **Thuaju: "Unë nuk jam i pari i dërguar dhe nuk e di çfarë do të ndodhë me mua ose me ju. Unë ndjek vetëm atë që më është shpallur dhe kam për detyrë vetëm të jap paralajmërime të qarta."** (Ahkaf, 9) Të mendojmë për një moment se Pejgamberi (a.s.), nuk gënjente, sepse kishte frikë se mbas një kohe mund t'i dilte gënjeshtër në shesh. Atëherë, çfarë e pengonte të gënjente për çështje metafizike, ku mundësia për t'u zbuluar gënjeshtër nuk ekziston, përveç frikës nga Gjykatësi Suprem.

Vetë Muhamedi (a.s.), ka konfirmuar se fjalët e Tij për nga vlera juridike janë të barasvlefshme me dispozitat kuranore.

Prandaj, për të përcaktuar ndalesën apo lejin e diçkaje

nuk është kusht konfirmimi kuranor. Mjafton gjykimi i hadithit për të përcaktuar dispozitën juridike të saj dhe vlefshmëria e kësaj dispozite është e njëjtë me një dispozitë të përcaktuar qartë nga Kurani. Megjithatë,

Ai bënte një ndarje të qartë midis hadithit dhe Kuranit. Madje, për një kohë relativisht të gjatë, nga frika e përzjerjes me njëri-tjetrin, e pati ndaluar shkrimin e haditheve. Nga ana tjetër, një njeri që ka sadopak shije letrare e kupton shumë lehtë dallimin midis stilit kuranor dhe hadithit sepse kanë stile qartësisht të dallueshme midis tyre. Një kritik letrar, duke lexuar hadithet dhe jetën e Pejgamberit, mund të nxjerrë një profil të qartë në lidhje me mendimet, idetë, ndjenjat dhe botën shpirtërore të tij, gjë që nuk ndodh me Kuranin.

Autori i Kuranit nuk mund të gjendet as midis politeistëve, të krishterëve apo hebrevjve. Sepse Kurani, megjithëse përfshin histori dhe ngjarje nga Bibla dhe Teurati, ai flet për detaje që nuk gjenden në to dhe herëherë bën korrigjimet e duhura. Një nxënës, që mëson dy gjëra nga një mësues, nuk mund të marrë guximin të sfidojë mësuesin. Është e pamundur për një person analfabet të japë informacione të tilla të detajuara historike. Detajet historike hasen edhe në numra, si në ajetin:

"Ata qëndruan në shpellën e tyre treqind vjet (diellorë), duke shtuar nëntë (për vitet hënore)." (Kehf, 25.)

Nuk thotë 309 vjet, por treqind plus nëntë për të shprehur ndryshimin midis kalendarit diellor dhe hënor. Kjo është një matematikë shumë e hollë për një analfabet. Nëse të dhënat historike do të ishin produkte të intelektit të tij, patjetër që me kalimin e kohës do të përballej me gabime. Mendjes së shëndoshë i ka hije të pranojë revelatën hyjnore të Kuranit.

Kurani flet për fitoren dhe triumfin e myslimanëve qysh në periudhën e Mekës. Si mund të marrë guximin një njeri të pretendojë një gjë të tillë në ato kushte që ishin myslimanët, ku ishte në dyshim ekzistenca, jo më të bëhej fjalë për fitore dhe sundim mbi tokë. Si mundet një njeri të jetë kaq i sigurt për fitoren përveçse me ndihmën e një informacioni qiellor? Kush do ta siguronte atë pas vdekjes se feja e tij nuk do të zhdukej?

"Në të vërtetë, jobsimtarët e shpenzojnë pasurinë e tyre për t'i penguar njerëzit nga rruga e Allahut. Ata do ta

shpenzojnë atë, por në fund ajo do jetë vetëm dëshpërim për ta, sepse do të jenë të mundur.” (Enfal, 36.)

“Allahu është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfimin dhe fenë e së Vërtetës, për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e pëlqejnë idhujtarët.” (Saff, 9.)

Përveç disfatës së mushrikëve, Allahu flet edhe për përplasjet e myslimanëve me hebrejtë. **“Kudo që gjeniden, ata janë të kapluar nga poshtërimi, vetëm nëse kanë ndonjë mbrojtje prej Allahut apo prej njerëzve. Ata merituan zemërimin e Allahut dhe do t'i kaplojë mjerimi.”** (Al 'Imran, 111.)

Historia është dëshmitare e poshtërimit të hebrejve dhe pamundësisë për të jetuar dhe siguruar ekzistencën e një shteti normal vetëm kur kanë qenë nën mbrojtjen e myslimanëve dhe kur janë mbështetur nga ndonjë fuqi tjetër botërore. Vetëm në këtë mënyrë kanë arritur ta sigurojnë ekzistencën e vet. Si mundet një njeri të japë informata kaq të përpikta dhe të sakta për të ardhmen dhe të kaluarën. Vetëm Krijuesi i gjithësisë mund të japë një verdikt kaq të prerë për një popull të tërë.

Ku e gjente sigurinë se nuk do të vdiste pa e përmbyshur misionin? Kjo është një siguri që nuk mund ta pretendojnë as njerëzit më të fuqishëm të botës, sepse vdekja mund t'i vijë në çdo moment njeriut. Një siguri të tillë mund ta japë vetëm Ai që jep dhe merr jetën. **“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përçjellë Mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve. Natyrisht që Allahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë.”** (Maide, 67.)

Kur besimtarët emigruan në Medinë, menduan se gjetën qetësinë, mirëpo atje u përballën me luftë, armiqësi dhe rrezik për shfarosje. Në një gjendje të tillë frike dhe pasigurie, ku myslimanët flinin me armë te koka dhe bënin roje me turne për t'u ruajtur nga sulmet, Kurani i lajmëronte për sundim planetar. **“Allahu u ka premtuar atyre që besuan prej jush dhe bëjnë vepra të mira se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu siç kanë bërë ata para tyre dhe do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe frikën do t'ua shndërrojë në siguri.”** (Nur, 55.)

Përmes këtij ajeti, Allahu u premtonte besimtarëve brenda një kohe të shkurtër sundim botëror. Ky sundim nuk u premtohet vetëm besimtarëve të pranishëm në atë kohë, por të gjithë besimtarëve që do të bëjnë vepra të mira.

Një tjetër anë që tregon burimin hyjnor të Kuranit është mungesa e diturisë dhe informacionit të Pejgamberit (a.s.), në lidhje me disa detaje, përfundime dhe kuptimin e ajeteve. Nëse Kurani do të ishte vepër e Tij, është e pashpjegueshme thurja e vargjeve pa u ditur kuptimin. Për më tepër, kur kjo gjendje i trondiste atij

autoritetin dhe shpesh e vendoste në një pozitë shumë qesharake. Një person nuk mund t'i urdhërojë as vetes e as të tjerëve urdhëresa që nuk ua di kuptimin dhe urtësinë. Kjo tregon që Ai ishte thjesht një transmetues i mesazhit.

Në vitin e gjashtë të hixhretit Pejgamberi (a.s.), së bashku me 1500 sahabë niset nga Medina për në Mekë, për të vizituar vendin e shenjtë, Qaben, sepse kishin vite që nuk e vizitonin dot për shkak të idhujtarëve kurejshë. Nga ana tjetër, myslimanët ishin fuqizuar shumë gjatë kësaj kohe, kurse kurejshët ishin dobësuar nga ana ekonomike dhe ushtarake. Nëse do të donte Pejgamberi (a.s.), mund ta merrte me forcë Mekën që atëherë, por nuk e bëri një gjë të tillë, sepse qëllimi ishte vetëm vizita. Kur arriti në vendin e quajtur Hudejbije, deveja e tij ndaloi së ecuri. Me gjithë përpjekjet, nuk e bënë dot të ecte. Përballë kësaj, Pejgamberi (a.s.), tha: **“E ndaloi Ai, i Cili ndaloi edhe elefantin”.** Kjo nënkuptonte që Allahu, ashtu si nuk lejoi Ebrehenë të pushtonte Qaben me luftë, nuk do të lejonte as myslimanët të merrnin Mekën me luftë. Pejgamberi (a.s.), pa e kuptuar urtësinë iu bind shenjë hyjnore dhe fushoi në Hudejbije, duke e ndaluar kështu përparimin drejt Mekës. Kërkesës së myslimanëve për të vizituar Qaben kurejshët iu përgjigjën negativisht, megjithëse myslimanët ishin të veshur me ihram dhe kishin marrë me vete kafshët për kurban. Pra ishin përgatitur me gjithë zemër për të vizituar Qaben. Megjithëse nuk kishte forcë që mund t'i ndalonte të hynin në Mekë, kurejshët vendosën kushte shumë të rënda për myslimanët. Pejgamberi (a.s.), e pranoi marrëveshjen me gjithë kushtet e rënda që përmbante. Ngaqë nuk mundën të vizitonin Qaben, Pejgamberi (a.s.), i urdhëroi të dilnin nga Ihrami dhe të bënin kurbanet aty ku ishin. Me gjithë bindjen absolute ndaj Pejgamberit, sahabët hezituan në zbatimin e urdhrit të Tij. Omeri (r.a.), si përfaqësues i grupit të pakënaqur me kushtet e marrëveshjes, i thotë Pejgamberit (a.s.): **“Përse po e nënçmojmë kështu fenë tonë?”** Pejgamberi (a.s.), megjithë rrezikun për t'u përballur me kundërshtimin e të gjithë sahabëve, i përgjigjet: **“Unë jam i Dërguari i Allahut dhe nuk mund t'i dal kundër Atij, Ai është ndihmësi im.”** Me këtë donte të thoshte se edhe ai ishte një njeri si ata dhe marrja e këtij vendimi nuk ishte në kompetencën e Tij. Si përfundim, Pejgamberi (a.s.), së bashku me sahabët u kthyen mbrapsht pa e kuptuar urtësinë e kësaj marrëveshjeje, në pamje të parë krejtësisht në disfavor të myslimanëve. Urtësia e kësaj marrëveshjeje mbeti enigmë, deri sa Allahu e zbuloi në suren Fet'h. Kur u realizuan sihariqet e Kuranit, e kuptuan që marrëveshja, në dukje kundër tyre, kishte qenë një fitore e madhe për ta. Çfarë vlere kanë masat që merr njeriu përballë masave që merr kaderi? Dijetari i famshëm Zuhri bën një evidentim shumë interesant në lidhje me marrëveshjen e Hudejbijes: **“Asnjë fitore përpara Hudejbijes nuk ka qenë më e madhe**

se ajo, sepse më parë, sapo myslimanët përballeshin me idhujtarët, fillonte grindja dhe luftimi. Por me nënshkrimin e marrëveshjes, gjendja u qetësua, gjakrat u ulën, kjo solli reflektimin e palës kundërshtare dhe gjatë kësaj kohe u kthyen në myslimanë, armiq të përbetuar të Islamit, si: Halid ibn Velidi, Amr ibn Asi e shumë figura të tjera të shquara të kurejshëve. Numri i njerëzve që pranuan Islamin gjatë kësaj periudhe, e kaloi numrin e myslimanëve të konvertuar gjatë 19 të viteve të kaluara."

Një nga kushtet e marrëveshjes ishte që myslimanët të vizitonin Qaben vitin tjetër dhe përveç shpatës që mbahet vazhdimisht me vete të mos merrnin asnjë armë tjetër. Si mund t'u besonin myslimanët kurejshëve, kur ata ishin të gatshëm të bënin gjithçka për të vrarë Pejgamberin (a.s.)? Si mund të ishin të sigurt se ata nuk dëshironin shfarosjen e të gjithëve? Mirëpo Allahu u siguroi atyre kryerjen e rritit dhe kthimin e sigurt. **"Allahu e vërtetoi saktësinë e ëndrrës së të Dërguarit të Tij, Me siguri, ju do të hyni në Xhaminë e Shenjtë, dashtë Allahu, të sigurt, kokërruar dhe flokëshkurtuar, pa kurrfarë frike. Ai e dinte atë që nuk e dinit ju dhe, veç kësaj, ju dhuroi një fitore të afërt."** (Fet'h, 27.)

Shpallja shpesh vinte në kundërshtim me mendimin e Tij për një çështje të caktuar, madje në disa raste kishte ngjyra të forta kritike.

"Nuk i takon të Dërguarit dhe besimtarëve që të kërkojnë falje për idhujtarët, qofshin këta edhe të afërmit e tyre, pasi u është bërë e qartë se ata janë banorë të Xhehenemit." (Teube, 113)

Sa për atë që është i pasur, ti atij po i kushton vëmendje, megjithëse nuk ke përgjegjësi, nëse ai nuk dëshiron të pastrohet. Sa për atë që të vjen duke nxituar dhe ndjen frikë (nga Allahu), ti atij nuk po ia vë veshin. Mos vepro ashtu! Në të vërtetë, ky (Kuran) është këshillë, pra, kush të dojë, le të marrë këshillë! (Abese, 5-12.)

"Asnjë profet s'ka të drejtë të ketë rob për vete, derisa të arrijë fitore të plotë në Tokë. Ju dëshironi të mirat kalimtare të kësaj bote, kurse Allahu dëshiron botën tjetër. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë. Sikur të mos ishin urdhërimet e mëparshme të Allahut (për lejimin e plaçkës së luftës), do t'ju godiste një dënim i madh për atë që keni marrë." (Enfal, 67-68.)

Nëse Muhamedi (a.s.), do të ishte autor i Kuranit, vënia në dukje e gabimeve të veta do ishte jashtë arsyes,


i parrokshëm për mendjen e njeriut.

Megjithëse profetët janë njerëzit më inteligjentë dhe të urtë në botë, ata përsëri kanë rënë në gabime. Për ilustrim po japim rastin e Jakubit (a.s.), kur i akuzoi fëmijët për sjelljen e dëshmisë së rreme në lidhje me gjakun, duke u thënë: **"Nuk është kështu, por ju keni sajuar diçka."** (Jusuf, 18.) dhe në lidhje me vjedhjen në sarajet e Faraonit, kur i thanë se në trastën e Benjamine u gjet një send i vjedhur. Ai edhe në rastin e dytë tha të njëjtën gjë: **"Nuk është kështu, por ju keni sajuar diçka."** (Jusuf, 83.) Jakubi (a.s.), në rastin e parë qëllloi, kurse në të dytin gaboi, sepse ata thanë të vërtetën.

Vetë Pejgamberi (a.s.), ka mbrojtur fajtorin duke e gjykuar si të pafajshëm, deri sa i ka ardhur zbulosa hyjnore. **"Vërtet, Ne (o Muhamed) ta kemi zbritur Kuranin me të drejtën, në mënyrë që ti të gjykosësh ndërmjet njerëzve sipas asaj që të ka shpallur Allahu. Dhe mos u bëj mbrojtës i tradhtarëve!"** (Nisa, 105.)

Shkaku i zbritjes së këtij ajeti ishte gjykimi i gabuar që dha Pejgamberi (a.s.), në lidhje me një vjedhje. Myslimani Tuame ibn Ubejrik i kishte vjedhur parzmoren fqinjit të tij Katade ibn Numanit. Kur Numani filloi kërkimet për gjetjen e parzmores, Ibn Ubejriku nga frika e zbulimit e fshehu parzmoren në oborrin e një hebreu. Kur Numani e gjeti parzmoren në shtëpinë e hebreut, çështjen ia çoi Pejgamberit (a.s.), për gjykim. Kur Pejgamberi (a.s.), e mori në gjykim çështjen, hebreu pohoi se parzmoren e kishte lënë ibn Ubejriku tek ai. Ibn Ubejriku së bashku me një grup burrash nga fisi i tij e mohuan fjalën e hebreut dhe të gjithë dëshmuan se vjedhjen e kishte kryer hebreu. Kur Pejgamberi (a.s.), duke u nisur nga provat dhe dëshmitë po mendonte të jepte gjykim kundër hebreut, zbriti ajeti i mësipërm, i cili e shpallte të pafajshëm hebreun, në këtë mënyrë Allahu zbardhi të vërtetën duke dhënë një gjykim të kundërt me të Pejgamberit (a.s.).

Si mundet një njeri të nxjerrë me anë të mendjes dhe logjikës përfundime të vërteta në lidhje me të ardhmen dhe të shkuarën, kur nuk mund të gjejë të vërtetën midis dy njerëzve në konflikt. Arsyeja dhe inteligjenca humbasin vlerën për sa i përket identifikimit të ngjarjeve që kanë lidhje me të ardhmen dhe botën metafizike. Një njeri që gjykon në këtë sistem, njëherë qëllon dhe shumë herë të tjera gabon. Nëse do të ishte kështu, ajeti Kuranor: **"A nuk përsiatin ata mbi Kuranin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërtënie."** (Nisa, 82.) do të ishte një sfidë e pakalueshme.



PËRMASA SOCI

Jetojmë në një periudhë dhe në një pamësi botë-kuptimore, ku çdo gjë projektohet sipas dëshirave, kënaqësive, veseve dhe prirjeve të egos. Sipas Kuranit, qëllimi i krijimit është ibadeti dhe ndërtimi i jetës, kulturës e qytetërimit në tokë. Kur jeta devijon nga ky qëllim parësor, atëherë ajo shndërrohet thjesht në argëtim, dëfrim dhe lojë. Fatkeqësisht, qëllimi kryesor i jetës po injorohet, duke e paraqitur atë gjithnjë e më tepër si një periudhë që duhet kaluar në përmbushjen e kënaqësive dhe dëshirave fiziologjike. Mënyra mondane dhe hedoniste e të jetuarit po na serviret si një nga qëllimet kryesore të jetës në tokë. Kjo ka sjellë një shfrenim të papërmajtur të epsheve, dëshirave dhe kënaqësive. Njerëzit në mënyrë permanente po largohen dhe distancohen nga vlerat fetare dhe shpirtërore. Të përfshirë nga vorbulla e jetës së përkohshme, kanë harruar qëllimin e vërtetë të jetës, kanë harruar besimin, vdekjen dhe jetën e amëshuar. Njerëzit përpiqen për interesat dhe përfitimet e tyre materiale sikur do të jetojnë përjetësisht në këtë botë.

Nga ana tjetër, jetojmë në një kohë në të cilën përhapja e rrymave të shthurura fetare, ideologjike, morale dhe intelektuale kanë marrë përmasa galopante, duke sjellë jo vetëm prishjen e ekuilibrit në rrafshin individual dhe shoqëror, por edhe prishjen e ekuilibrit kozmik.

Mohimi i vlerave njerëzore, fetare dhe shpirtërore ka sjellë tëhuajsimin dhe denatyrizimin e njerëzores, ka sjellë shfrytëzimin pa kriter të të mirave materiale dhe pasurive natyrore, ka sjellë legjitimitetin e një sërë perversitetesh dhe shthurjeve. Të gjitha këto e kanë vendosur njeriun përballë problemeve serioze, që rrezikojnë edhe vetë ekzistencën e tij.

Kurse problemi më i madh dhe emergjent i myslimanëve sot, është mungesa e bashkërendimit dhe bashkëveprimit midis besimit dhe veprimit. Pejgamberi (a.s.), e ka vlerësuar besimin, veprimin dhe moralin si një tërësi organike. Përmendja bashkëngjitur e fjalëve besim dhe veprim në Kuran mbi njëqind herë, tregon pikërisht këtë lidhje të ngushtë midis tyre. Kurse Pejgamberi (a.s.), në një hadith, krahas Teuhidit, i cili është formula e besimit, ka përmendur edhe heqjen e një pengese nga rruga. Përkufizimi i imanit përfshin të dyja këto dhe çdo gjë të dobishme që ekziston midis tyre. E njëjta situatë është edhe me koceptet besim, islam dhe ihsan, që kalojnë në hadithin e famshëm, të njohur si hadithi i Xhebrailit, ku të tre nivelet janë të gërshtuar dhe ndërvaruar në mënyrë harmonike me njëri-tjetrin. Prandaj, një besim që nuk përqafohet në tërësinë e tij dhe nuk shndërrohet në stil jete, por ekziston vetëm në rrafshin teorik, pa zbritur në zemrën dhe vetëdijen e njeriut, nuk mund të sjellë transformim



VALE E BESIMIT

të individit dhe shoqërisë. Besimtar i vërtetë është ai që imanin teorik e shfaq përmes imanit praktik. Parimet teorike që ka sjellë Pejgamberi (a.s.), janë për ta çuar besimtarin drejt veprimit dhe pasqyrimin të besimit në jetën sociale. Nga mësimet e Pejgamberit (a.s.), mësojmë se Teuhidi nuk është vetëm besimi në ekzistencën dhe njësimin e Zotit. Teuhidi përmban në vetvete përmasa individuale dhe shoqërore. Ai nuk synon vetëm njësimin e Zotit, por edhe unifikim të arsyes me ndjenjën, të tokësorës me qielloren, të shpirtit me trupin. Nga mësimet dhe sjellja e Pejgamberit (a.s.), mësojmë se imani është që mbi të gjitha të duash Allahun dhe Pejgamberin (a.s.), të duash për hir të Allahut, të duash për tjetrin atë që do për vete, të mos biesh në gjumë i ngopur ndërsa fqinji ëshë i uritur. Imani është të jesh i drejtë në mendime dhe sjellje, të jesh besnik, të jesh fjalëdrejtë dhe fjalëbukur, të ushqesh njerëzit, të jesh tolerant, durimtar, me dinjitet dhe moral të bukur. Imani është të qëndrosh larg ndalesave dhe të jesh sa më afër devotshmërisë, të kujtosh vdekjen dhe të bësh përgatitje për pas vdekjes.

Prandaj, përveç vlerës teorike, duhet t'u mësojmë njerëzve edhe vlerën praktike të besimit. Sepse vetëm artikulimi i shehadeit nuk mjafton për të qenë besimtar. **"Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë 'Ne besojmë', pa u vënë në provë?"**

Ne i kemi provuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që, Allahu të dallojë ata, që thonë të vërtetën dhe, ata që gënjejnë." (Ankebut, 2-3) Qindra tregues të imanit gjenden në zotërimin social. Kur besimi humbet përmasën sociale, myslimanët humbasin dinamizmin shoqëror dhe, për pasojë, fillon rrënimi dhe rënia e tyre. Sot fatkeqësisht, ekziston një perceptim shumë i gabuar ndaj besimit, duke e privuar atë nga përmasa praktike dhe sociale. Kjo gjë pengon pasqyrimin e moralit të Islamit në nivel individual dhe social.

Si përfundim, imani është të pranosh ekzistencën dhe njësimin e Zotit dhe t'u bindesh me përkushtim të gjitha urdhëresave dhe ndalesave, që rregullojnë marrëdhëniet e njeriut me Zotin dhe mjedisin. Besimi nuk është thjesht një shqiptim me gojë dhe pranim me zemër, por është një disiplinë që shpjegon gjithë ekzistencën. Boshti i këtij besimi është Allahu. Njeriu fiton vlera në këtë besim, i cili fillon me besimin në një Zot të vetëm, për t'u plotësuar me besimin në botën tjetër. Kuptimi i krijimit, i jetës dhe i vdekjes gjendet vetëm në besim. Sado që imani të përkufizohet si pranim me zemër dhe shqiptim me gojë i ekzistencës së Zotit, treguesi më i madh dhe i rëndësishëm i tij është puna dhe sjellja. Prandaj, në ditën e gjykimit njeriu do të gjykohet sipas veprave dhe jo sipas fjalëve.

Si duhet ta lexojmë *Kuranin*?

Allja Izzetbegović

Në fakt, Kuranin e kisha lexuar shumë herë, por asnjëherë më parë nuk e kisha pyetur veten se si duhet ta lexojmë në të vërtetë Kuranin. Kjo pyetje më nxiti të reflektoj. Prandaj vendosa që mendimet e mia t'i ndaj me ju.

Së pari, duhet të dimë se Kurani nuk mund të copëtohet në fragmente. Çdo ajet diskret i shkëputur nga konteksti nuk mund të na zbulojë plotësisht të vërtetën, ai mund të na japë vetëm një pjesë të saj. Nëse Kurani vlerësohet si i tërë, atëherë Ai e shpreh qartë të vërtetën. Është mëse normale të merren vetëm disa ajete për shqyrtim, por duhet të dimë që kjo është e mundur vetëm për një numër të caktuar ajetesh. Këtë mund ta krahasojmë me një mozaik. Në një mozaik copëzat e kuqe apo të zeza fitojnë kuptim vetëm kur bashkohen me copëzat e tjera. Shkëputja e një copëze nga mozaiku nuk mund të na japë një ide mbi bukurinë e gjithë mozaikut. Për ta kuptuar më mirë do të jap disa shembuj.

Ajeti **"O besimtarë! Është caktuar për ju kisasi' si shpagim për vrasje"** (El-Bekare, 178) mbështet si shpagim për krimin e vrasjes dënimi me vdekje. Kurse në një ajet tjetër këshillohet për falje e amnisti. **"Dënimi për të keqen është i njëjtë me atë të keqe. Por, atë që fal dhe pajton, e pret shpërblimi i Allahut. Ai, në të vërtetë, nuk i do të padrejtët."** (Shura, 40)

1. Kisasi në të drejtën juridike islame është ligji i barazisë në ndësim.

Në një ajet tjetër **"O besimtarë! Mos ia ndaloni vetes gjërat e mira, të cilat Allahu ju ka lejuar dhe mos e kaloni kufirin! Vërtet, Allahu nuk i do ata që e kapërcenë kufirin"** (El-Maide, 87) shembuj të tillë mund të shtohen më tepër.

Një personi që lexon Kuran, disa ajete mund t'i duken sikur janë në kundërshtim me njëri-tjetrin, por në fakt një gjë e tillë është e pamundur. Përkundrazi, e vërteta është krejt ndryshe. Disa urdhëresa të Kuranit, megjithëse janë në një harmoni të plotë me njëra-tjetrën, në pamje të parë, mund të duken kontradiktore. Sepse Kurani nuk kërkon prej nesh të bëjmë vetëm një veprim të caktuar, përkundrazi kërkon të bëjmë dy veprime njëherësh ose thënë ndryshe. Kurani nuk kërkon prej nesh të punojmë vetëm për botën tjetër, në të njëjtën kohë kërkon që ne të punojmë edhe për këtë botë. Pra, thekson se nuk mund të ekzistojë asnjëra pa tjetrën. Prandaj, ashtu si Myslimanët, që megjithëse me të drejtë, nuk mendojnë asgjë përveç ndëshkimit nuk mund të arrijnë në nivelin e imanit të përsosur, edhe myslimanët që mendojnë vetëm mëshirën nuk mund të arrijnë këtë nivel. Kështu pra, mysliman i pjekur është individ i vetëdijshëm dhe i matur për të dyja, ndëshkimin dhe mëshirën.

Arritja e përfundimeve të sakta është e mundur vetëm përmes qasjes në tërësi të Kuranit dhe jo duke marrë në konsideratë një fragment të vetëm. Kjo është metoda më e mirë dhe e saktë për të kuptuar Islamin dhe mesazhin Islam.

Një tjetër çështje që dua të prek këtu është domosdoshmëria e leximit periodik dhe të vazhdueshëm të Kuranit. Mendoj se kjo është mënyra më e mirë për të zbuluar dritën dhe rrezet e Kuranit. Sepse çdo lexim i tij na ndihmon për të kuptuar diçka të re. Kurani ka ardhur deri

tek ne pa pësuar as ndryshimin më të vogël. Por përballë Kuranit qëndron ndryshimi që kemi pësuar ne, bota dhe mjedisi që na rrethon. Këto ndryshime u bënë shkak për përqendrimin tonë në fusha të tjera, duke i hapur rrugë neglizhencës së plotë ndaj Kuranit. Dhe papritur kuptuam se ishim bërë plotësisht gafil ndaj jehonës që lëshonte leximi i Kuranit në zemrat tona.

Çdo mysliman mund ta vërtetojë këtë nga përvoja e vet që ka përjetuar me Kuranin. Por unë këtu dua të jap disa shembuj nga përvoja ime personale.

Shumë kohë më parë, gjatë leximit të Kuranit përqedrohesha më shumë në ajetet që trajtonin xhihadin, drejtësinë dhe veprat. Kisha një fletore të vogël shënimesh të mbushur plot me ajete. E kujtoj shumë mirë se një nga ajetet që trajton personalitetin e individit mysliman në lidhje me refuzimin dhe kundërshtimin e armiqve dhe despotizmit ishte ajeti: **"Kur ata i godet ndonjë padrejtësi e madhe rezistojnë duke ndihmuar njëri tjetrin."** (Shura, 39)

Ndërsa në çdo rast, gjatë për-siatja mbi ajetet e lartpërme-ndura, më tërhoqnin vëmendjen ajetet që flasin për Allahun, dhe karakterin kalimtar e të përkohshëm të jetës së kësaj bote. Këto ajete e nxisin njeriun të mendojë, jo të veprojë... Edhe sot e kujtoj shumë mirë ndikimin e fortë dhe pushtimin që më bënë ajetet që deklaroin se përveç Allahut çdo gjë tjetër do të zhduket. Sepse premtimi i Allahut është i vërtetë. **"Çdo gjë në tokë do të zhduket, e do të mbetet vetëm Zoti yt plot Madhëri dhe Nder"** (Er-Rahman, 27/28) Pra, Allahu ishte para se të krijohet universi, është tani që po flasim dhe do të jetë edhe mbasi të shkatërrohet universi. Kjo është e vërteta e pandryshueshme. Kur nëna ime udhëtoi për në botën tjetër isha i mbuluar me hidhërim dhe pikëllim. Ajetet **"O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!"** deri atëherë nuk i kisha dalluar. Por pikërisht në këto gjeta çuditërisht ngushëllimin e vërtetë.

Kurani në një gjendje lartëson sheriatin, në një gjendje xhihadin, kurse në një gjendje tjetër është ngushëllim përballë vështirësive pazgjidhje që të përball jeta. Pra Kurani tërheq vëmendjen sipas gjendjes sonë shpirtërore. Ndërsa në një rrethanë na tërheq vëmendjen në një kah, në një tjetër na tërheq vëmendjen në një drejtim tjetër.

Kjo rezonancë e përmbajtjes së Kuranit siç është e lidhur me gjendjen individuale të personit është po aq e lidhur edhe me gjendjen e shoqërisë dhe kushtet historike. Atëherë gjendjet që kanë lidhje me shoqërinë dhe kushtet historike, si: përçarja e shoqërisë për shkak të ndarjes etnike, barazia dhe të drejtat e gruas, etj, na bëjnë

t'i japin përparësi dhe të përqendrohemi në disa ajete të caktuara. Në rastet kur shkelet e drejta e besimit, mënjëherë bëhet aktual një ajet i shkurtër dhe i qartë **"Nuk ka dhunë në fe."**

Ne si myslimanë nuk bëjmë dallime mes ajeteve. Por jomyslimanët janë këmbëngulës për ta shfaqur ajetin e mësipërm, si ajetin më të mrekullueshëm në shprehjen e tolerancës fetare. Kjo është një temë që mund të trajtohet më gjatë, por është përtej qëllimit të këtij artikulli.

Duhet të përcaktojmë qartë çfarë kemi për qëllim nga leximi dhe dëgjimi i Kuranit. Meqenëse në përgjithësi myslimanët nuk e kuptojnë Kuranin, disa njerëz e kanë konsideruar shumë pak të dobishëm leximin e tij. Unë nuk jam i këtij mendimi dhe në lidhje me këtë mendoj se është rasti të kujtoj një ngjarje që nuk do ta harroj kurrë. Shumë vite më parë mora pjesë në një konferencë islame ndërkombëtare. Konferenca organizohej në një nga qytetet më të mëdha të Evropës. Në konferencë merrnin pjesë shumë dijetarë dhe intelektualë për të paraqitur mendimet dhe kërkimet e tyre në lidhje me rindërtimin e mendimit

Islam. Çdo ditë në fillim dhe mbarim të konferencës këndohej Kuran nga hafizë të njohur nga e gjithë bota islame. Pjesëmarrësit dëgjonin me një interes të jashtëzakonshëm fjalimet e dijetarëve dhe mendimtarëve Islam. Por gjatë fjalimit dëgjonim dhe shikonim qindra pjesëmarrës në konferencë ndërsa pëshpëritnin me njëri-tjetrin, lëviznin karriget dhe merreshin me gjëra të vogla. Kur fillonte leximi i Kuranit papritmas ndalonin së foluri dhe çdo gjë e mbulonte qetësia. Të gjithë ishin të përqendruar në dëgjimin e këndimit të Kuranit. Leximi i Kuranit i ngjasonte një lumi që rrjedh i qetë dhe në heshtje nëpër shtratin e

tij. Pastaj Kurani i dërgonte larg në kreshtë të një ujëvare. Por kulmi i ngjarjes ishte Dita e Fundit, e cila nuk mund të tregohet, ajo vetëm mund të përjetohet. Për të mbyllur konferencën, hafizi kishte zgjedhur si dhuratë suren Rahman. Kjo është një sure shumë e njohur e Kuranit, e cila me bukurinë e stilit dhe harmoninë midis ajeteve e mrekullon njeriun. Veçanërisht ajeti që përsëritet **"Cilën të mirë të Zotit tuaj po mohoni?"**, i cili sikur i tërhoqi në fund të oqeanit dëgjuesit.

Kurse unë ndjeva që ajetet që po këndoheshin i kuptoja tërësisht. Gjatë konferencës e ndjeva më afër veten dhe pjesëmarrësit. E njëjta gjë dukej edhe në fytyrat e të tje-rëve. "Sikur donin të thoshin: A nuk e shikoni? A nuk jemi të gjithë vëllezër në Islam?"

Pas kësaj ngjarjeje kuptova rëndësinë e leximit të Kuranit duke e kuptuar. Zemrat e besimtarëve në një mënyrë apo në një tjetër mund ta kuptojnë Kuranin. Myslmanët janë përgjegjës për ta kuptuar atë.



*"Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin
atij që dëshiron ta udhëzojë, ndërsa atij që dëshiron
ta lërë në humbje, (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin,
si të jetë duke u ngjitur në qiell.
Kështu, Allahu, i ndëshkon ata që nuk besojnë."*

(El-E'nam, 125)

Një Ajet

Kush beson dhe zbaton urdhëresat e Krijuesit, Allahu i jep atij një qetësi shpirtërore. Zemra e tyre ndriçohet nga drita e imanit. Detyrat e ngarkuara i bëjnë me zell të madh, pa asnjë lloj dembelizmi. Kurse jobesimtarët, megjithë të mirat materiale që zotërojnë, janë gjithmonë në stres e depresion. Një nga qëllimet kryesore të njeriut në këtë botë është edhe sigurimi i një jete të lumtur pa probleme e telashe. Gjithë jetën njeriu përpiqet ta arrijë këtë qëllim. Dikush mendon se lumturia arrihet duke plotësuar objektivat materiale dhe kënaqësitë trupore. Ky grup e kufizon lumturinë vetëm me zotërimin e të mirave materiale të kësaj bote.

Dikush tjetër e shikon lumturinë në një këndvështrim tjetër, duke besuar se është një shpëtim shpirtëror në botën e amëshuar. Në këtë kuptim, rruga e vetme për të arritur lumturinë e përjetshme është devotshmëria ndaj Allahut. Për rrjedhojë, lumturia nga këndvështrimi material me lumturinë në këndvështrimin shpirtëror, janë të ndryshme. Ndërsa njëra realizohet duke plotësuar në mënyrë të shfrenuar dëshirat trupore, tjetra realizohet duke arritur përsosmërinë shpirtërore përmes mbajtjes nën kontroll të dëshirave.

Nga ky këndvështrim dallohet se Islami ka sjellë një sistem për ta bërë njeriun të lumtur. Feja islame merr parasysh edhe anën materiale edhe atë shpirtërore. Islami e vlerëson njeriun si të tërë, pa bërë ndarjen

trup-shpirt. Islami nuk e shikon jetën të kufizuar vetëm në këtë botë, përkundrazi jeta e vërtetë dhe e pafundme fillon pas jetës tokësore. Dëshirat dhe nevojat e njeriut janë të pafundme, kurse mundësitë për t'i plotësuar janë të kufizuara. Për këtë arsye, nuk mund të plotësohen të gjitha dëshirat në këtë botë. Nga kjo pikëpamje, bota e përtejme është një shpresë për besimtarët, të cilët besojnë se do të shpërblehen me mirësi të pafundme nga ana e Allahut. Kurse për jobesimtarët nuk mund të mendohet një gjë e tillë, sepse sipas tyre, i vetmi vend ku mund dhe duhet të plotësohen dëshirat është kjo botë. Kjo filozofi jete e shtyn njeriun në një liri totale për të plotësuar dëshirat, nëpërmjet të cilave, gjoja realizohet lumturia, por kjo është një iluzion, sepse përmbushja e gjithë dëshirave, së pari është e pamundur dhe e dyta, asesi nuk sjell lumturi. Ndërsa për jobesimtarin, fundi i kësaj bote ndjell frikë, kurse për besimtarët nuk ndodh një gjë e tillë, ata e presin me mall dhe aspiratë. Kjo gjendje rrjedh, sepse Islami e mëson njeriun të jetë pozitiv dhe optimist për jetën. Ai e shikon botën të mbushur me mirësi, krijuesi i të cilave është Allahu. Dhe për këtë falënderon Allahun për mirësitë e pafundme që i janë dhënë. Njeriu, duke qenë i vetëdijshëm se krijuesi dhe zotëruesi i të gjitha këtyre është Allahu, i dorëzohet vullnetit dhe përcaktimit të Allahut dhe kjo sjell tek ai një qetësi shpirtërore të papërshekruar. **Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai.** (Talak. 3)

Transmetohet nga Ebu Musa el-Esh'arij (r.a.),
se Pejgamberi -sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem-, ka thënë:

*"Shoku i mirë ngjan me tregtarin e aromave të këndshme.
Prej tij mund të blihet parfum, mund të të vijë dhuratë
një parfum ose tekefundit, mund të të vijë era e parfumit.
Kurse shoku i keq është si farkëtari, qëndrimi pranë të cilit
ose të djeg teshat ose të mbyt nga era e keqe."*

Ky hadith është në përputhje të plotë me ajetet që këshillojnë besimtarët të shoqërohen gjithmonë me njerëz të mirë e të devotshëm. Shoqëria dhe miqësia, përtej një marrëdhënieje shoqërore natyrale, e ka të nevojshme sinqeritetin dhe sinqeriteti arrihet më së miri midis njerëzve që ndajnë besim dhe ideale të njëjta. Hadithi i mësipërm na këshillon të jemi të kujdesshëm në zgjedhjen e shokut, për vetë faktin se, edhe pse me besim të njëjtë, por me sjellje të papajtueshme, njerëzit ndikohen reciprokisht pozitivisht apo negativisht. E këshillueshme është shoqërimi me njerëz të mirë, për të përfutur nga edukata e morali i tyre dhe distancimi nga personat me sjellje të keqe, sepse shoqërimi sjell patjetër ndikim. Siç e shpreh më qartë hadithi tjetër: *"Personi është në fenë e shokut të tij, prandaj të shikojë çdonjëri prej jush se me kë shoqërohet"* (Ahmed. ibn. Hanbel, Musnedi, 2/334)

Ky hadith i mrekullueshëm, i thënë katërmbëdhjetë shekuj më parë, e ruan edhe sot aktualitetin. Tema e ndikimit zë një vend të

rëndësishëm, sidomos përsa i përket edukimit të fëmijëve dhe të rinjve. Sepse sjelljet që fitohen në këtë moshë, do të përbëjnë një pjesë të karakterit të tij në të ardhmen. Në shumicën e rasteve duhanpirja fillohet thjesht duke u nxitur nga një shok, për të vazhduar gjithë jetën. Përhapja e veseve të tjera të këqija, si alkooli, droga dhe kumari është e lidhur ngushtë me ndikimin e rrethit shoqëror. Prandaj, zgjedhja e shokut është shumë e rëndësishme, për më tepër në kohën tonë, ku komunikimi ka marrë përmasat e një zhvillimi marramendës duke bërë të mundur edhe krijimin e shoqërive virtuale. Familja duhet të tregohet shumë e kujdesshme për grupmoshat nga klasa e parë deri në moshën e pjekurisë, sepse kjo është moshë ku fillon të formësohet personaliteti, por është edhe moshë, e cila është shumë e prirur ndaj ndikimeve pozitive apo negative.

Mburoja më e sigurt për të mbrojtur fëmijët nga ndikimet negative është strehimi tek feja islame.

Një Hadith

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Nxitja për t'u shoqëruar me njerëz të mirë.
2. Njeriu ndikohet nga shoku me të cilin shoqërohet.
3. Qëndrimi larg shoqërisë së keqe.



TË ZGJEDHËSH AHIRETIN NË VEND TË DYNJASË

Padyshim që njeriu është një rrugëtar vdekatar, që ka nisur udhëtimin drejt ahiretit. Të mohosh një gjë të tillë, bie në kundërshtim me mendjen, logjikën dhe arsyen e shëndoshë dhe është sikurse të mbyllësh sytë dhe të thuash: "Nuk ekziston dielli!". Prandaj dhe të rregullosh jetën sipas kësaj të vërtete, është një detyrim mendor, logjik dhe ndërgjegjësor.

Myslimanët, ashtu sikurse duhet të bëjnë kujdes ndaj gjërave që bëjnë në këtë botë, njëkohësisht nuk duhet të harrojnë kurrë të përgatiten për botën e përtejme, sepse jeta e kësaj bote nuk është dhuruar vetëm që të shijohet kënaqësitë kalimtare dhe të plotësohen dëshirat epshore. Përkundrazi, është një hapësirë që të është dhuruar të mbledhësh ushqim për ahiretin, të bësh vepra të mira dhe të bësh bamirësi të ndryshme përmes lëmoshave që nuk u kufizohet shpërblimi (sadaikai xharije). Ndaj dhe miqtë e Allahut kanë thënë:

"Sado vujatje të kesh për një lumturi të përjetshme, tekefundit ikën mundimi dhe mbetet lumturia. Mirëpo, nëse mëkaton për shijet e perkohshme të kësaj bote kalimtare, në fund do të të ikë kënaqësia e shijes dhe tek ti do të mbesin vetëm pendesa, ndëshkimi dhe vuajtja."

Ibn Mina shpjegon:

Isha nisur për në varreza, i veshur me një rrobë të hollë. U përballa me një acar të mprehtë dhe u shtriva pranë një varri, që të ruhesh nga i ftohti. Fala dy

rekatë namaz aty dhe rashë të flija. Pasha Allahun, duke qenë i zgjuar dëgjova një zë të tillë:

- Ngrihu nga varri im! Ju mund të bëni akoma vepra. Ah sikur ta dinit gjendjen e varreve. Ne e përfunduam jetën e dynjasë dhe kemi nisur jetën e varrit, e pamë të gjithë të vërtetën dhe e kuptuam. E kuptuam mjaft mirë se sa gjë e vyer është të bësh vepra të sinqerta në dynja. Mirëpo, nuk na ka mbetur tashmë ndonjë mundësi që të bëjmë vepra, sikur të mund të falja këto dy rekate namaz që ti i fale lehtësisht, pasha Allahun, kjo do të ishte më e vyer dhe më e dashur se e gjithë bota dhe gjithçka që ajo ka brenda. (Bejhaki, Delail, VII, 40-41)

Hazreti Mevlana ka thënë:

"Kush sheh fundin e punës, sapo të ketë nisur punën, bëhet më i lumtur dhe i gëzuar. Njerëz të tillë i përkushtohen më shumë punës, mbjellin më shumë dhe në fund mbledhin shumë fruta, sepse e dinë se kjo botë është botë e të mbjellave, është parapërgatitje për të hyrë në ahiret. Kurse ahireti është bota e të korrurave, është bota e tjetërsimit."

Të zgjedhësh ahiretin, nuk do të thotë të shpërfillësh këtë botë. Kjo gjë ka të bëjë më shumë me rregullimin e qëllimit në zemër. Njeriu duhet ta rregullojë jetën sipas asaj që pëlqen Allahu dhe kur punon me qëllim që të fitojë riskun e tij prej hallalli dhe të bëjë vepra të mira, atëherë çdo hap që hedh, çdo punë që bën, vlerësohet si ibadet.



Hazreti Omeri e shpjegon kështu:

“Një ditë shkova pranë Profetit tonë të dashur. Pashë që ai ishte shtrirë mbi një rrogë. Motivet e rrogës kishin lënë gjurmë në trupin e tij. Nuk kishte as edhe një dyshek që të shtronte mbi rrogë. Kishte një jastëk prej lëkure të mbushur me fije hurmash...

Kur pashë që Zotëriu ynë po buzëqeshte, iu ula menjëherë pranë dhe pashë përreth dhomën. Pasha Allahun, nuk kishte asgjë me vlerë përveç tri lëkurave që prisnin të përpunoheshin. Nuk durova dot dhe i thashë:

- O Resulullah! Bëni dua Allahut, që Ai t'i falë pasurinë tuaj, sepse, romakëve dhe persëve u ka dhënë pasuri dhe shumë begati të tjera, edhe pa adhuruar fare Allahun.

Resulullahu (a.s.), u drejtua nga vendi ku ishte mbështetur dhe tha kështu:

- O biri i Hattabit, a ke dyshim (lidhur me fjalën hyjnore për botën tjetër)? Ata janë njerëz që e kanë dhënë jetën pas kësaj bote dhe kanë ndërtuar gjithçka kundrejt saj.”

Pas kësaj edhe unë i thashë:

- O Resulullah, bëj istigfar për mua.” (Buhari, Me-



**“Ditën kur do ta shohin atë,
(njerëzve) do t’u duket
se kanë qëndruar (në Tokë)
veç një mbrëmje
apo një mëngjes.”**

(En-Naziat, 46)

zalim, 25)

Sërish një ditë tjetër, Resulullahu (a.s.), lidhur me këtë çështje pati thënë:

“Për çfarë mund të më duhet kjo botë! Lidhja ime me këtë botë është si shembulli i atij rrugëtarit që po bën udhëtim, pushon nën hijen e një peme dhe pastaj ngrihet e vazhdon rrugën.” (Tirmidhiu, Zuhd, 44/2377; Ibni Maxhe, Zuhd, 3; Ahmed, I, 301)

Kurani Famëlartë thotë:

“Ditën kur do ta shohin atë, (njerëzve) do t’u duket se kanë qëndruar (në Tokë) veç një mbrëmje apo një mëngjes.” (En-Naziat, 46)

Abdullah ibni Mes’ud (r.a.), u thoshte miqve të vet:

- Ju falni më shumë namaz se sahabët dhe përpiqeni më shumë se ata. Mirëpo, ata ishin më të virtytshëm se ju.”

- Çfarë bënin ata, që ishin më të virtytshëm?

- Ata ishin më asketë se ju ndaj kësaj bote dhe më të dhënë për ahiretin sesa ju. (Ibni Xhevzi, Sifatus-Safve, I, 420)

Shumë njerëz i kushtohen së tepërmi posteve, karrierave dhe prestigjeve të kësaj bote dhe për t’i mbrojtur ato, tregohen tolerantë ndaj ahiretit. Në fakt, një mysliman, për ahiretin e tij, duhet të marrë përsipër të gjitha llojet e shqetësimeve të kësaj

bote, nuk duhet të marrë përsipër kurrë të vuajë në ahiret për arsye të kësaj bote.

Resulullahu (a.s.), para se të ndërronte jetë, këtë çështje e ka shprehur në këtë mënyrë në testamentin e tij:

“O njerëz! Secili që i ka hyrë në hak tjetrit, le ta shlyejë menjëherë atë, le të mos mendojë për poshtërimin në këtë botë. Le ta dini mirë që poshtërimi në këtë botë, përballë poshtëritimit të botës tjetër nuk ka fare vlerë.” (Shih. Ibni Sa’d, II, 255; Taberi, Tarih, III, 191)

Një pjesë e njerëzve, pasi dëgjuan këtë fjalë të të Dërguarit të Allahut, rrëfyn disa padrejtësi dhe gabime që kishin bërë më parë dhe iu lutën Profetit të bënte dua dhe istigfar për ta. Njëri prej tyre u ngrit në këmbë dhe tha:

- O Resulullah! Pasha Allahun, unë jam shumë gënjeshhtar, jam edhe hipokrit. Nuk kam lënë gjë të keqe pa bërë.

Atëherë Resulullahu (a.s.), tha:

- O Omer! Poshtërimi në këtë botë nuk është asgjë përballë poshtëritimit në botën tjetër! – dhe më pas u lut për këtë njeri në këtë mënyrë:

“O Allahu im! Bëje të mundur që ai njeri të jetë njeri me fjalë të drejta dhe të piqet nga aspekti i besimit! Bëje të mundur që veprat e tij të këqija, t’ia kthesh në të mira!” (Taberiu, Tarih, III, 190)

Le të japim këtë shembull kaq domethënës, që tregon se sa rrezik i madh është të lësh mënjanë ahiretin dhe t’i përvishesh pasurisë dhe posteve të kësaj bote:

Në periudhën e emevive ushtria islame kishte nisur udhëtimin me shpresën që ta meritonte ajo përgëzimin dhe lajmin e mirë profetik lidhur me ngadhënjimin e Stambollit. Në mesin e kësaj ushtrie gjendej edhe **Ebu Ejjub el-Ensari** (r.a.). Kur bizantët po luftonin duke u mbështetur në kështjellat e qytetit, një njeri nga ensarët shkoi hipur në kalin e tij deri në mes të Bizantit. Pasi besimtarët e panë këtë gjë, duke u nisur nga ajeti **“Mos e hidhni veten tuaj në rrezik”**, thirrën të tmerruar duke e qortuar sahabiun në këtë mënyrë:

“La ilahe il-lall-llah! Pa shikoni si e hedh veten në rrezik!”

Kurse Ebu Ejjub el-Ensari (r.a.), tha kështu:

*“O besimtarë! (Të mos keqkuptohem!) Ky ajat ka zbritur lidhur me ne ensarët. Kur Allahu e ndihmoi Pejgamberin dhe i dha triumf fesë së tij, ne i patëm thënë: “Le të qëndrojmë në krye të punëve tona dhe të angazhohemi me to.” Atëherë, Allahu i Madhëruar i pati shpallur këtë ajat të Dërguarit të Tij: **“Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.”** Qëllimi i “mos e çoni veten tuaj në shkatërrim”, që përmendet në këtë ajat, ishte për arsye se ne kishim mënjanuar dhe kishim lënë përpjekjen për rrugën e Allahut dhe ishim kredhur në angazhimin e gjërave të kësaj bote, si vreshtat dhe kopshtet.”* (Shih. Ebu Davud, Xhihad, 22/2512; Tirmidhiu, Tefsir, 2/2972)

Pejgamberi ynë i dashur (a.s.), thotë po ashtu:

“Sikur dynjaja të kishte vlerë në syrin e Allahut sa një krah i mushkonjës, Ai nuk do të bënte të mundur asnjë të pafe që të pinte qoftë edhe një gllënjë ujë.” (Tirmidhiu, Zuhd, 13)

“Kujtojeni shpesh vdekjen, e cila shkul nga rrënjët të gjitha dëshirat.” (Tirmidhiu, Kijamet, 26)

“Kush ka dëshirë ahiretin, Allahu i jep pasuri zemrës së tij dhe ia bën të mbara punët. Pas kësaj, dynjaja i përulet atij dhe ikën pas tij. Dhe cilitdo që ka vënë synim dynjanë, Allahu i vendos varfërinë mes dy syve dhe ia ngatërron punët. Si përfundim, njeriu nuk arrin të përvetësojë nga kjo botë më shumë sesa i është caktuar.” (Tirmidhiu, Kijamet, 30/2465)

Një nga paraardhësit (shehzade) e pafat të historisë osmane, Xhem Sulltani, ishte zënë rob nga kalorësit e Rodosit, si përfundim i betejës për pushtet dhe ata ia shitën Papës. Papa Inocenti VIII, i premtoi Xhem Sulltanit se, nëse do të bëhej i krishterë, do ta ndihmonte të kalonte në pushtet. Ky propozim i erdhi shumë i rëndë Xhem Sulltanit. U mërzit dhe tha:

“Jo pushtetin osman, por pushtetin e të gjithë botës sikur të ma jepnit, nuk ndërroj fe!”

1. El-Bekara, 195.

Kur vuri re se do të përdorej nga kryqëzatat kundër myslimanëve, iu drejtua Zotit dhe tha kështu:

“O Zot! Nëse të pafetë duan të më bëjnë vegël kundër myslimanëve, mos e bëj të mundur që ky njeri i yti të jetojë më shumë! Bëma të mundur të ma marrësh shpirtin në praninë Tënde!”

Një ditë, padishahu i Telemsanit, Sulltan Jahjai, kishte dalë me oborrtarët të shëtiste qytetin. Popullit po i shkëlqenin sytë përballë madhësisë së tij dhe të atyre që kishte përreth, nga frika u ngrit në këmbë dhe po e nderonte duke brohoritur: “Rroftë Padishahu!” Por padishahut, po i binte në sy një njeri që ishte i shkëputur nga masa, një njeri, nuri i të cilit po vezullonte përreth. Kur pyeti se kush ishte ai njeri, ata i thanë:

- Madhëri, ai është Shejhu i njohur nga Tunizia. Jeton një jetë askete (inziva) në një shpellë.

Sulltanin e zuri një kureshtje edhe më e madhe, e drejtoi kalin drejt Shejhut nga Tunizia dhe i bëri këtë pyetje:

- A është e lejuar të fal namaz me këtë rrobë të mëndafshhtë që kam sipër?

Sado që Shejhu nga Tunizia refuzoi të përgjigjej dhe rekomandoi t’ia bënte këtë pyetje dijetarëve të sarajit të vet, për arsye të këmbënguljes së sulltanit, dha këtë përgjigje:

- Mendoni sikur një qen të ketë gjetur një kafshë të ngordhur, ta ketë ngrënë atë duke pëlcitur, ta ketë bërë berbatë përreth dhe të ngrejë këmbët lart që të mos përlyhet me ndotjen kur ai po kryen nevojën...

Sulltani nevrikoset dhe thotë:

- Çfarë do të thuash me këtë?


Shejhu i tha:

- Dua të them këtë, që stomaku dhe trupi juaj është i ngarkuar me peshat më të mëdha të haramit dhe me padrejtësi ndaj njerëzve. Ndërkohë, ju më pyesni nëse është e lejuar apo e ndaluar të fal namaz me veshje të mëndafshëta?

Këto fjalë të urta ndikuan thellë te sulltani. Pas kësaj, i flaku tutje rrobat e mëndafshëta. Më pas, hodhi në një krah shpatën që kishte në mes dhe tha:

- Myslimanë! Bëmani hallall dhe gjeni tjetër sulltan për veten tuaj!

Pasi tha këto, shkoi pas Shejhut nga Tunizia dhe u bë nxënësi besnik i tij.



“O njerëz! Secili që i ka hyrë në hak tjetrit, le ta shlyejë menjëherë atë, le të mos mendojë për poshtërimin në këtë botë. Le ta dini mirë që poshtërimi në këtë botë, përballë poshtërimit të botës tjetër nuk ka fare vlerë.”

Sulltan Jahjai arriti në një stad aq të lartë në edukimin shpirtëror nga Hazreti Shejhu, sa që Shejhu nga Tunizia, kur filloi t’i kërkonte populli të bënte dua për ta, tha:

- Kërkojeni duanë nga Jahjai, sepse po të isha unë në vendin e tij, nuk do të bëja atë që ka bërë ai... Sikur sulltanët ta dinin thesarin e lumturisë që ka arritur ai, edhe ata do të sakrifikonin gjithçka të tyre, siç bëri Jahjai.”

Hazreti Ibrahim bin Ed’hem, i cili la pushtetin e kësaj bote dhe arriti pushtetin shpirtëror, ka thënë kështu:

“Sikur të ishte diçka konkrete entuziazmi dhe përmallimi ynë në dashurinë hyjnore; mbretërit do të flijonin të gjithë thesarin dhe të gjithë pushtetin për ta përvetësuar atë.”



Disiplina trup-shpirt në Ramazan

Murat Akgyn

Meqë në shekullin tonë qytetërimi është shndërruar në fuqi dhe linja fizike, puna më e madhe e njeriut i kushtohet mbajtjes në formë të trupit, veprimtaritë sportive të organizuara në sektor më vete, degët e ndryshme të sporteve, ministritë përgjegjëse për mbarëvajtjen e veprimtarive sportive dhe drejtoritë e përgjithshme që varen prej tyre, degët e mjekësisë të specializuara në kurimin e sëmundjeve fiziologjike, dietat e praktikuara për të ruajtur dhe zhvilluar formën fizike, të gjitha këto tregojnë se rëndësia e një fiziku të mirë ka dalë në plan të parë, duke lënë pas dore kujdesin për një shpirt të bukur.

Ndërsa shprehemi në këtë mënyrë, nuk kemi aspak qëllim të nënvlerësojmë rëndësinë e një shëndeti të mirë dhe një fiziku të fuqishëm, sepse gjithsesi trupi është kafsha mbartëse e shpirtit.

Lidhjen që ekziston mes trupit dhe shpirtit, mendimtari Gazali e krahason me rastin e haxhiut që shkon në haxh së bashku me devenë e tij. Nëse ai do ta shpenzonte të gjithë kapitalin që ka për devenë e tij, atëherë ai do të mbetej trokë, por nga ana tjetër, nëse e nënvlerëson ushqimin dhe fizikun e devesë me të cilën po udhëton, atëherë ka për të mbetur në mes të rrugës. Zgjidhja me e logjikshme është t'u japë secilës prej tyre, hakun që meritojnë, duke vendosur kështu një ekuilibër.

Kohët e fundit janë duke u rekomanduar dieta të ndryshme për të humbur kilet e tepërta e për t'u ruajtur nga sëmundjet që burojnë nga të ushqyerit e tepërt dhe lëvizjet e pakëta, arsye për të cilën janë duke u shpenzuar vlera të mëdha parash.

Ofrohen receta ushqimore për t'u praktikuar në periudha tre-ditore, javore, mujore apo gjashtëmujore. Pirja vetëm e ujit për periudha të caktuara, apo të ushqyerit vetëm me shalqi a pjepër, ngrënia e përzierje të caktuara të ushqimeve apo dhënia gjak, janë vetëm disa prej praktikave të kryera me këtë qëllim.

Si është e mundur që njerëzit, të cilët bëjnë shpenzime të mëdha dhe pehriza të rënda vetëm që të shpëtojnë nga sëmundjet fizike, nuk e marrin aspak në konsideratë dietën fizike e shpirtërore që përmban

muaji i Ramazanit, një dietë nëpërmjet së cilë mund të ruhen nga sëmundjet shpirtërore që përbëjnë rrezikun e tyre të vërtetë?

Kur Profeti (a.s.), qe shprehur **“Agjëroni që të jini të shëndetshëm”**, ka pasur për qëllim shëndetin si në planin fizik, ashtu edhe në atë shpirtëror. Programi i agjërit dhe i muajit Ramazan, të cilin ua porosiste njerëzve (si edhe e praktikonte vetë), kryente detyrën e “dietës” më të vlefshme në formimin e një personaliteti të përkryer.

Sëmundjet moralo-shpirtërore janë më të rënda se sëmundjet fizike për njeriun, ndërsa ndikimi negativ i llojit të parë të sëmundjeve ka efekt më shkatërrues për individin e për shoqërinë. Prandaj, për të shpëtuar nga sëmundjet shpirtërore duhet që Kuranin ta konsiderojmë si një kartë, agjërimin si një spital, ndërsa muajin e Ramazanit si një saunë që na pastron nga ndotjet shpirtërore.

Ka lloje të ndryshme sëmundjesh shpirtërore, si: injoranca, përtacia, kopracia, egoizmi etj. Me një dietë të rreptë të zbatuar gjatë muajit Ramazan është e mundur të shpëtojmë nga këto sëmundje.

Ilaçi i parë që duhet marrë për të shpëtuar nga injoranca, është të lexojmë tekstin dhe komentet e Kuranit, në të cilin urdhri i parë i zbritur qe “Lexo”, ndërsa më pas duhet t’i zbatojmë ato që lexojmë e të nxjerrim mësim, të mësojmë prej tyre. Leximet pjesë-pjesë të Kuranit gjatë natës apo gjatë ditës, leximet individuale dhe përsiatjet mbi ajetet kuranore, duhet të na ndriçojnë me rrezet e Kuranit. Gjatë muajit Ramazan duhet ta bëjmë hatme Kuranin në kushtet që sapo treguam, të paktën një herë.

Për të shpëtuar nga përtacia duhet që namazet t’i falim në kohën e tyre, të falemi së bashku me xhemat. Në mënyrë të veçantë nuk duhet të na ikin namazet e teravisë, madje po të jetë e mundur t’i falim ato nëpër xhami të ndryshme e të ngrihemi për syfyr. Në mënyrë të veçantë janë namazet ato që formojnë një program të disiplinuar për jetën.

Për të shpëtuar nga sëmundja e koprracisë ka rrugë shërimi siç janë dhënia e zeqatit, e sadakai fitrit dhe e lëmoshave të tjera, si dhe shtruarja e sofrës së iftareve për agjëruarit e tjerë. Për të na treguar se sa mjet i mirë është zeqati për pastrimin shpirtëror, Zoti thotë në Kuran: **“Pranoje një pjesë të pasurisë së tyre**

si sadaka që do t’i pastrojë ata nga gjynahet dhe do t’i pastrojë shpirtërisht.” (Tevbe, 103) Sa më shumë që të dhurojë njeriu, aq më shumë i shtohet fuqia e tij për të dhuruar, ndërsa kur nuk dhuron, kopracia i shndërrohet në shprehje të karakterit të tij.

Dieta kundër sëmundjes së përgojimit, veçanërisht kur je agjërueshëm, është ta zotërosh fjalën që thua, dhe kur të tjerët kërkojnë të hyjnë në konflikt me ty nëpërmjet fjalëve, atëherë duhet të largohesh nga rrethi i thashethemeve dhe i ngatërresave, duke u shprehur ashtu siç na ka mësuar Profeti (a.s.): **“Unë kam agjëruar sot”**. Agjërimi i personave që bëjnë thashetheme, që përgojnë dhe kërkojnë të grinden me fjalë, nuk është gjë tjetër përveç se të rrinë me barkun bosh. Ilaçi më i mirë për parandalimin e përgojimit, është të lexosh sa më shumë Kuran dhe të bësh sa më shumë dhikr.

Që të shpëtosh nga sëmundja e mosmirënjohjes, duhet të pranosh përherë e më shumë begatitë kur përjeton ndjenjën e urisë, të meditoesh se çfarë do të kishte ndodhur me ne po të mos ishin këto begati, si dhe ta falënderosh Zotin që na i ka dhuruar këto begati të pafundme. Ndodh shumë herë që njeriu të mos e kuptojë begatinë që zotëron, por vlerën e tyre e kupton vetëm atëherë kur i mohohen ato begati. Në këtë kuptim agjërimi është një mjet falënderimi.

Mënyra e duhur për kurimin e egoizmit dhe të mungesës së mëshirës është të mendosh për hallet e të uriturve dhe të të mjerëve, t’i vizitosh ata, të

mund tua fitosh zemrat dhe të marrësh dua prej tyre. Uria dhe pamundësia që përjetojmë gjatë agjërit duhet të na shtyjë të mendojmë më shumë rreth jetës së përditshme të njerëzve të uritur dhe të varfër.

Siç vihet re, Kurani dhe muaji i agjërit, Ramazani, përbëjnë një dietë të vlefshme dhe një muaj të tërë kurimi, krejtësisht të lirë nga aspekti ekonomik dhe të lehtë për t’u përmbushur, por që të shëron nga një numër të madh sëmundjesh si shpirtërore, ashtu edhe fizike.

Lutem që edhe muaji i Ramazanit që po vjen të shndërrohet në një dietë të fortë dhe në një stinë kurimi për shpirtrat e sëmurë që kanë etje të kurohen. Për sa kohë që nuk pastrohemi nga mëkatet, të cilat janë burimi i vërtetë i sëmundjeve, nuk do të jetë e mundur të jetojmë të shëndetshëm në këtë botë, ashtu siç nuk do të jetë e mundur as të hyjmë në vendin e prehjes së përhershme që është parajsja.

Ilaçi i parë që duhet marrë për të shpëtuar nga injoranca, është të lexojmë tekstin dhe komentet e Kuranit, në të cilin urdhri i parë i zbritur qe “Lexo”, ndërsa më pas duhet t’i zbatojmë ato që lexojmë e të nxjerrim mësim, të mësojmë prej tyre.



Jonida Tashi

10 SËMUNDJET QË SHËRON AGJËRIMI

Shkenca e sotme ka zbuluar se agjërimi forcon sistemin imunitar tek agjëruesi, për t'u bërë ballë shumë sëmundjeve. Agjërimi është një adhurim i veçantë tek Allahu i Lartësuar. Ai është një prej detyrimeve me të cilat nuk u dallua vetëm umeti mysliman, por edhe bashkësitë e tjera fetare para nesh. Kjo tregon rëndësinë e tij. Më poshtë do të njihemi me rolin e agjëritimit në shërimin e shumë sëmundjeve, të vërtetuara në sajë të eksperimenteve reale.

1. OPERACIONI

Agjërimi kryen funksionin e kirurgut duke eliminuar prej trupit qelizat e shkatërruara dhe të dobëta. Uria që shoqëron agjërimin vë në lëvizje aparatet e brendshme të trupit duke konsumuar qelizat e dobëta për të përballur këtë uri, kështu që trupit i jepet rasti i volitshëm të rikthejë gjallërinë dhe aktivitetin e tij. Gjithashtu, agjërimi është mbrojtje për trupin prej shumë tepricave të dëmshme si për shembull: gurët, shtresat e mishit, gjëndrat dhjamore, madje edhe vetë plagët në fillimin e formimit të tyre.

2. SËMUNDJET E LËKURËS

Agjërimi është i dobishëm në kurimin e sëmundjeve të lëkurës pasi ai pakëson përqindjen e ujit në gjak. Pakësimi i tij në lëkurë sjell forcimin e imunitetit të lëkurës dhe rezistencë ndaj mikrobeve dhe sëmundjeve epidemike, pakësimin e sëmundjeve të lëkurës, të cilat përhapen në sipërfaqe të mëdha të trupit, pakësimin e sëmundjeve

alergjike duke i vënë kufi problemeve të lëkurës së yndyr-të. Me agjërimin pakësohen sekrecionet helmuese të zorrëve dhe zvogëlohet përqindja e thartimit që shkakton puçrra të vazhdueshme.

3. DHIMBJET E KYÇEVE

Kjo është një sëmundje shumë e përhapur, sidomos në moshat 30-50 vjeç. Problemi i vërtetë është se mjekësia e sotme ende nuk ka arritur në ndonjë mjekim për këtë sëmundje. Eksperimentet praktike në Rusi kanë vërtetuar se agjërimi gjate tri javëve të njëpasnjëshme, ndihmon trupin që të shkarkojë mbeturinat dhe lëndët helmuese, shkaktare të kësaj sëmundjeje. Këto eksperimente janë bërë mbi një grup të sëmurësh dhe rezultatet kanë qenë të kënaqshme.

4. TROMBOZA

Agjërimi ka ndikim te madh në mbrojtjen prej trombozës së zemrës dhe trurit. Shumë studime shkencore e mjekësore kanë vërtetuar se agjërimi zvogëlon përqindjen e yndyrave në trup, duke zvogëluar kështu kolesterolin. Kjo lëndë ngjitet në muret e damarëve duke sjellë rritjen e përqindjes së tij dhe rritjen e yndyrave në trup, si rrjedhim çon në ngrirjen e damarëve duke shkaktuar edhe hollimin e damarëve të zemrës dhe të trurit.

5. DIABETI

Agjërimi është një rast i mire për të zvogëluar përqindjen e sheqerit në gjak në pikën më të ulët të tij. Ai i jep gjëndrave të pankreasit një rast të mire për pushim, sepse detyra e tij është të prodhojë insulinë, e cila e shndërron sheqerin në yndyra që depozitohen në inde. Kur ushqimi e kalon masën e insulinës së sekretuar, pankreasi lodhet dhe, si rrjedhojë, e ndërpret aktivitetin e tij, kështu sheqeri grumbullohet në gjak duke rritur përqindjen e tij gradualisht, derisa shfaqen simptomat e sëmundjes. Për këtë arsye, klinikat e ndryshme kuruese, në tërë botën, praktikuan agjërimin si metodë kurimi për të sëmurët me diabet, në periudha të ndryshme kohe, në varësi të gjendjes shëndetësore të tyre. Kjo metodë ka pasur rezultate dhe sukses të kënaqshëm pa përdorur ilaçe të tjera.

6. PËRDHESI

Sëmundja e mbretërve, ndryshe quhet edhe "përdhesi", krijohet nga ngrënia e tepërt, sidomos e mishit. Shkaku është defekti që ndodh në grumbullimin e proteinave të gjendura në mishra, sidomos në mishin e kuq, gjë që çon në grumbullimin e acidit të urinës, sidomos në nyjën e gishtit të madh të këmbës. Gjatë prekjes së nyjës me këtë sëmundje ajo enjtet dhe skuqet duke u shoqëruar me dhimbje të mëdha. Ndoshta masa e kripërave në urinë mund të rritet e pastaj të grumbullohet në veshka duke formuar gurë. Pakësimi i masës së ushqimit është kurimi kryesor i kësaj sëmundjeje shumë të përhapur.

7. INFEKSIONET

Dobia e agjërimit shfaqet në mënyrë të hapur tek të sëmurët me infeksionet periodike të tretjes e në krye të tyre janë: infeksioni periodik i stomakut, vështirësia e tretjes dhe trazimi i zorrëve. Agjërimi i jep këtyre organeve mundësinë e pushimit për më se një muaj. Gjithashtu, ai ka ndikim të madh edhe në kurimin e tyre, madje edhe të sëmurët me kolonë përfitojnë shumë prej agjërimit. Tek të sëmurët me alergji, agjërimi dhe racionalizimi i ushqimit ndihmojnë të largohen shumë sëmundje alergjike. Pushimi i aparatit tretës është i domosdoshëm për të shëruar shpejt disa sëmundje.

8. SËMUNDJET E ZEMRËS

Agjërimi ka një vlerë të madhe për shumë sëmundje të zemrës, pasi 10 për qind e gjakut të pompuar nga zemra shkon në aparatit tretës gjatë procesit të tretjes. Kjo sasi zvogëlohet gjatë agjërimit, sepse nuk kemi proces tretjeje gjatë ditës. Kjo do të thotë më pak lodhje dhe më shumë qetësi për muskujt e zemrës.

9. DHJAMOSJA

Agjërimi, pa e tepruar, është mjeku më i afte dhe më i lirë. Ai çon në uljen e peshës, me kusht që ta shoqërojnë normaliteti në sasinë e ushqimit në kohën e iftarit dhe njeriu të mos e fryjë stomakun me ushqim e lëngje pas agjërimit. Vetë profeti Muhamed (a.s) e fillonte iftarin me disa kokrra hurma ose me pak ujë e pastaj ngrihej dhe falte namazin e akshamit. Kjo është tradita dhe metoda më e mirë për atë që agjëron, që ndërpritet nga ushqimi e lëngjet për orë të tëra. Sheqeri i gjendur në hurma i sjell njeriut ndjesi ngopjeje, pasi gjaku e thith shumë shpejt e në të njëjtën

kohë i jep trupit energjinë e nevojshme për të vazhduar aktivitetin e mëtejshëm. Por nëse e fillon ngrënien pas një urie të gjatë duke ngrënë mish e bukë, atëherë tërë këto ushqime duan një kohë të gjatë të treten e një pjesë e tyre të shndërrohet në sheqer që si rrjedhim njeriu të ndihet i ngopur. Kështu njeriu vazhdon të mbush stomakun e tij mbi masë, duke menduar se ai akoma është i uritur.

10. BOX: KURIM PSIKOLOGJIK

Agjërimi nuk shëron vetëm sëmundjet e trupit, por ai është edhe një kurim i mirë psikologjik. Më poshtë po paraqesim mendimin e një personi që ka provuar të agjërojë pa pasur asnjë lidhje me islamin. Tom Bernez, student në shkollën "Kolumbia", dega gazetari, thotë: "Unë e konsideroj agjërimin më shumë si eksperiencë të thellë shpirtërore, sesa trupore. Megjithëse fillova të agjëroj për të ulur peshën e tepërt, e kuptova që ai është shumë i dobishëm edhe për aktivitetin e trurit. Agjërimi ndihmon si në mënyrën e të menduarit, në lindjen e ideve të reja, ashtu edhe në përqendrimin e ndjenjave. Nuk kishin kaluar shume ditë nga fillimi i agjërimit në strehimin shëndetësor "Bulling", kur ndjeva që po kaloja një gjendje lartësimi shpirtëror të paimagjinueshëm. Tani e bëj një gjë të tillë disa herë e në periudha kohore nga një deri në gjashtë ditë. Në fillim qëllimi ishte të pastroja trupin nga shëndeti i tepërt, por tani agjëroj për të pastruar edhe shpirtin tim nga tërë të metat që kane ngecur në të gjatë jetës sime, sidomos pasi shëtita nëpër bote për disa muaj dhe pashe padrejtësitë në të cilën jetojnë shumë njerëz. Ndiej se jam përgjegjës në një mënyrë apo tjetër për atë që u ndodh atyre, kështu që agjëroj si falje për këtë. Kur agjëroj më ikën tërë dëshira për ushqim e tërë trupi ndien një rehati të madhe. Ndiej që shpirti im largohet nga ndjenjat e këqija si: lakmia, xhelozia, dëshira për sundim. Gjithashtu, ndiej të largohen edhe disa gjëra që më ndjekin pas si: frika, luhatja, ndjenja e mërzi. Tërë këto nuk i ndiej të ndikojnë tek unë gjatë agjërimit dhe gjej një mirëkuptim të mrekullueshëm me tërë njerëzit gjatë tij".

STUDIM MBI VLERAT KURUESE TË AGJËRIMIT

Në një studim të paraqitur në konferencën e sëmundjeve të zemrës në Arabinë Saudite në shkurt të 1998, janë eksperimentuar mbi 86 të sëmurë me sëmundje të ndryshme të zemrës si, damarët apo valvulet e zemrës. 86 për qind e tyre arritën të agjëronin tërë muajin e Ramazanit dhe vetëm 10 për qind e tyre u detyruan ta ndërprisnin atë disa ditë dhe në përfundimin e muajit, 78 për qind e tyre ndjenë përmirësim të gjendjes shëndetësore, kurse 11 për qind e tyre ndjenë të shtoheshin simptomat nga të cilat ankoheshin. Agjërimi ndihmon në kurimin e tensionit të lartë të gjakut, sepse ulja e peshës që shoqëron agjërimin, ul gjithashtu edhe tensionin e gjakut në mënyrë të dukshme, si edhe lëvizjet fizike në namazin e teravisë ndihmojnë në uljen e tensionit të gjakut. D. Shahid Ethar në një hulumtim të botuar në revistën amerikane "Jirir" përcakton se personi gjatë namazit të teravisë konsumon 200 kalori. Kështu, nëse agjëruesi i përmbahet një ushqimi normal, duke evituar teprimin në yndyra dhe sheqerna, do të gjejë tek Ramazani mbrojtje për zemrën e tij dhe kurim për sëmundjen e saj.



Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

I dërguari profeti Muhamed (a.s.), mëshirë për botët, na e ka sqaruar muajin e ramazanit me të gjitha dimensionet që ka. Këtë muaj e kishte bërë shprehi ta quante edhe “muaji i myslimanëve”. Literatura e hadithit është e mbushur përplot me shumë thënie që rrëfohen prej profetit Muhamed dhe me raportimet e ndryshme të tyre. Do të qe e pamundur të mund t’i radhisim dhe t’i trajtojmë të gjithë ato hadithe brenda një artikulli. Për këtë arsye edhe ne, zgjodhëm një ligjëratë profetike (hutbe) në të cilën profeti Muhamed (a.s.) e ka sqaruar më gjerësisht muajin e Ramazanit. Ligjëratat profetike në fjalë është shkëputur nga një ndër veprat më eminente të literaturës së hadithit, më saktësisht nga vepra Sahih e dijetarit të hadithit Muhamed b. Ishak Ibn Huzejme (311 H / 923)

Në kapitullin në lidhje me vlerat fetare dhe shpirtërore të muajit të Ramazanit, që gjendet në veprën e Ibn Huzejmes, pasi jepet zinxhiri i raportuesve që shkon pas deri tek Selman Farisiu thuhet: “I dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.), mbajti një ligjëratë në ditën e fundit të muajit Shaban në të cilën tha:

“O myslimanë!

“Mbi ju ka rënë hija e një muaji madhështor dhe të bekuar. Ky është muaji në të cilin gjendet edhe nata

e Kadrit, natë që është më e mirë se një mijë muaj së bashku.

Ky është muaji në të cilin Allahu u obligoi të agjëroni ditën dhe u begatoi me faljen e namazit (të teravisë) mbrëmjeve.

Kush punon ndonjë vepër të mirë në këtë muaj, fiton po aq sevape sa fiton personi që kryen një detyrë fetare të detyruar (farz) në një kohë tjetër përjashta këtij muaji. Ai që përmbush një farz në këtë muaj fiton sevapin e kryerjes së shtatëdhjetë farzeve në muajt e tjerë.

Ky është muaji i durimit, shpërblimi për të cilin është xheneti.

Ky muaj është muaji i bamirësisë, ndihmës dhe bazarisë.

Ky është muaji në të cilin besimtarit i shtohet begatia hyjnore materiale.

Kush i shtron iftare një personi që ka agjëruar, ky veprim bëhet shkas që t’i falen mëkatet që ka vepruar dhe të shpëtojë nga zjarri i xhehenemit. Ai me këtë rast do të fitojë po aq sevape sa fiton ai që ka agjëruar, por pa marrë nga sevapet e këtij të fundit.”

Të pranishmit e pyetën:

- "Jo të gjithë ne i kemi mundësitë financiare që të mund të ushqejmë për iftar ata që kanë agjëruar..."

Këtyre profeti Muhamed (a.s.) iu përgjigj duke u thënë se:

"Allahu (xh.sh.), këtë sevap ia dhuron edhe atij personi që e gostit një person që ka agjëruar qoftë edhe me një hurmë apo disa gllënjka ujë apo qumësht" dhe vazhdoi ligjëratën me këto fjalë:

**"Bëjini sa më shpesh katër gjëra në muajin e ramazanit. Me dy prej tyre fitoni kënaqësinë e Allahut, ndër-
sa prej dy të tjerave nuk mund të rrii larg edhe po të doni. Dy gjërat me të cilat do të fitoni kënaqësinë e Allahut (xh.sh.) janë të dëshmoni për njësinë e Allahut duke thënë shpesh La ilahe illallah dhe të kërkoni sa më shpesh nga Zoti juaj që tua falë mëkatet. Sa i takon dy gjërave të tjera nga të cilat nuk mund të qëndroni larg ato janë të kërkoni nga Zoti xhenetin dhe t'i luteni që t'u shpëtojë nga xhehenemi."**

Hytbja e profetit Muhamed, sikurse shihet, është shumë e qartë dhe e prerë, por gjithsesi ne jemi të mendimit se ka vlerë të ndalemi në disa pika të saja që na tërheqin vëmendjen.

ARDHMËRIA E VËRTETË

Muhamedi (a.s.), e ka prezantuar në këtë ligjëratë muajin e ramazanit nga aspekti i rezultateve pozitive që u dhuron ai besimtarëve si në jetën personale, ashtu edhe në atë të botës së përtejme, sepse çdo mysliman pret diçka të re nga muaji i ramazanit që ai ka mbërritur. Këto aspirata të tijat sa kanë lidhje me jetën e kësaj bote, po aq, madje edhe më shumë, kanë lidhje me jetën në botën e përtejme, sepse e ardhmja e vërtetë për besimtarin është bota e përjetshme.

Nga ana tjetër, është një e vërtetë e njohur fakti që përmirësimi një e nga një i njerëzve shpie në një përmirësim të caktuar të shoqërisë, sepse bashkësitë njerëzore formohen nga individët. Kur ndahen me të tjerët momentet e gëzimit dhe hareshë, kanë ndikim edhe më të madh, prandaj edhe hareja që të fal muaji i ramazanit, do ta rrethojë shoqërinë në atë masë që ajo ndahet me tjerët.

Profeti Muhamed (a.s.) na e ka bërë të qartë se nuk është domosdoshmëri që të kemi të ardhura financiare në mënyrë që të fitojmë sevape nga kryerja e bamirësive në muajin e ramazanit. Me këtë deklaratë të Tijën që ne e cituam në ligjëratën e mësipërme, ai sikur dëshironte të na mësonte se **"Allahu nuk ka nevojë për pasuri të mëdha që të shpërndajë mëshirën e Tij të cilën njeriu mund ta fitojë edhe duke kryer një akt të thjeshtë bamirësie".** Edhe t'i japësh personit që ka agjëruar për të çelur iftarin një gllënjë ujë apo qumësht mjafton që ne të përfitojmë nga kjo mëshirë hyjnore. Sa është i rëndësishëm akti bamirës që kryhet, po aq i rëndësishëm është edhe qëllimi me të cilin ai kryhet. Prandaj, askënd nuk duhet ta kaplojë pesimizmi po qe se mendon se të ardhurat materiale që ka nuk do t'i mundësojnë të kryejë akte bamirësie. Në qoftë se ne do të tregojmë kujdesin e duhur në përbushjen e dy akteve që na këshilloi profeti

Muhamed (a.s.) që të kryejmë gjatë muajit të Ramazanit, të cilat qenë shprehja e dëshmisë dhe lutja që të na falen mëkatet, kuptojmë sesa e lehtë është për një besimtar të singërt që vetëm duke përdorur gjuhën e tij në ziqër të mund të fitojë shumë sevape.

Ndjesia e besimit në njësinë e Zotit dhe ndërgjegjësimi rreth kësaj të vërtete duhet forcuar dhe i duhen mundësuar të hedh rrënjë sa më thellë me anë të përsëritjeve të dëshmisë islame, sepse **"zemrat gjejnë qetësi vetëm kur e përmendin Allahun".**

HUMBJA E RËNDË

Sqarimi profetik që "nata e Kadrit që është më e mirë se një mijë muaj", qoftë shpërblimi hyjnor (sevap) që fitohet kur kryhen vepra të mira dhe bëhen bamirësi në këtë muaj, shpërblim që është shumëfish më i lartë kur të njëjtat akte dhe vepra kryhen në muajt e tjerë përjashta Ramazanit, tregojnë se muaji i ramazanit në vetvete është një "mundësi e jashtëzakonshme që na dhurohet". E vërteta që njihet nga të gjithë është se, momentet e jashtëzakonshme sjellin me vete edhe përgjegjësi të jashtëzakonshme. Teksa na tregon rreth vlerës së veprave të mira që bëhen në muajin e ramazanit, profeti ynë i dashur, na ka sqaruar njëkohësisht se personat që do të mbeten indiferentë ndaj këtyre mundësive do të përjetojnë humbje dhe dështime shumëfish më të rënda se ato që do të përjetonin në muajt e tjerë për shkak të indiferencës së tyre.

TË JESH POZITIV

Meqë ra fjala në këtë temë, e konsiderojmë me vlerë të theksojmë se çdo veprim dhe akt që do të kryejmë duke u nisur nga respekti që ushqejmë për muajin e ramazanit, do të ketë pa tjetër një vlerë të veçantë. Shpresojmë që këto lloj aktesh bamirësie do të jenë plotësim për gabimet që njerëzit mund të kenë kryer gjatë jetës së tyre. Mirëpritja me nderim dhe respekt e çdo mjeti apo metode që mundëson të ndërgjegjësojë shoqërinë rreth temave fetare dhe domosdoshmërisë së jetës fetare, janë të përshtatshme që të arrijnë të masivizojnë nismat e këtilla. Qoftë edhe një muaj gjatë gjithë vitit, çdo ndërmarrje që do të ndihmonte në përthithjen më të shpejtë të atmosferës fetare brenda shoqërisë, do të ishte shumë më e efektshme që të mirëpritet duke u parë si një ftesë e shpërndarë në emër të veprave të mira.

Ata që meritojnë me të vërtetë për të ndjerë keqardhje, janë individët tek të cilët nuk dallohet as ndryshimi më i vogël për sa i përket ndjesive dhe mënyrës së vjetër të jetesës, të cilët nuk ndikohen qoftë edhe një grimë nga atmosfera e muajit të ramazanit. Më mjeranë se personat në fjalë janë ata individë që nuk e durojnë dot formën e re të bukur që sjell atmosfera e jetës së përditshme gjatë këtij muaji dhe përhapjen e saj në shtresat e ndryshme të shoqërisë, madje përpiqen të vënë në dukje shqetësimin që ndjejnë nga kjo atmosferë e përshtatshme.

AKTUALIZIMI I NAMAZIT

HETIM RRETH NDËRGJEGJES SOCIALE

Dr. Kerim Bulladë

Nuk ka dyshim se njëri prej farzeve më të rëndësishëm në fenë islame, pas dëshimit të shahadetit, është namazi. Po të lexohet Kurani, me qëllim që të nxjerrim prej tij një përfundim në lidhje me historikun e namazit, do të shohim se namazi si adhurim ekzistonte që nga krijimi i njeriut. Praktikën e sexhdes e shohim që me rastin e njeriut të parë, Adem (a.s.), atëherë kur Allahu i urdhëroi melekët të bënin sexhde respekti ndaj njeriut. Kjo ngjarje mund të numërohet si një shenjë për të treguar se të gjithë njerëzit që do të vinin pas Ademit, do të kishin të bënin me sexhden.

Sipas vetë Kuranit, të gjithë profetët qenë urdhëruar të falnin namazin. Këtë të vërtetë e shpreh edhe ajeti, ku thuhet: **“Ne i dhuruam Ibrahimit Is’hakun dhe Jakubin si dhuntë, dhe të gjithë i bëmë të drejtë. Ne i bëmë ata udhëheqës, që udhëzonin sipas urdhrin Tonë dhe i frymëzuam të bënin vepra të mira, të kryenin faljet dhe të jepnin zeqatin dhe ata vetëm Ne na adhuruan.”** (Enbija, 72-73) I njëjti urdhër i qe komunikuar edhe profetit Muhamed (a.s.) dhe umetit të tij. (Bakara, 43, 110; Nisa, 103; Ibrahim, 31; Isra, 78; Ta Ha, 132; Haxh, 78)

Profeti Ibrahim, i cili në përputhje me urdhrin e Allahut, i dërgoi personalisht, gruan e tij Haxheren dhe të birin Ismailin, nga Palestina në Mekë, ku i la pranë pusit të tharë të ujit zemzem, kur u nda prej tyre dhe kishte mbërritur te mali Kubejs, u kthye në drejtim të vendit, ku vite më pas, do të ndërtonte së bashku me të birin e tij Ismailin, Qaben dhe u lut me këto fjalë: **“O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pasardhësit e mi,**

në një luginë që nuk mbillet, afër Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin...” (Ibrahim, 37) Sikurse shihet, profeti Ibrahim (a.s.), kishte lënë aty një pjesë të pasardhësve të tij, që ata të falnin aty namazin. Ky fakt tregon se Qabja u ndërtua, që aty të falej namazi. Qabja është simboli i dëshimit të besimit monoteist, si pasojë edhe namazi është shenjë e këtij besimi, pra e fjalës së dëshmisë në besimin monoteist dhe praktikimi me vepra i kësaj dëshmie. Namazi e ruan njeriun nga devijimi prej fjalës së dëshmisë së besimit monoteist. Për këtë arsye, namazi është vërtetim me vepra se një person është besimtar.

Shumë ajete të Kuranit si: **“Unë të kam zgjedhur ty, prandaj dëgjo atë që po të shpallet! Me të vërtetë, Unë jam Allahu, s’ka zot tjetër përveç Meje, prandaj, vetëm Mua më adhuro dhe kryej faljen për të më kujtuar Mua!”** (Ta Ha, 13-14) **“Me të vërtetë, Allahu mori besëlidhjen e bijve të Izraelit dhe nga mesi i tyre caktoi dymbëdhjetë mbikëqyrës dhe u tha: “Unë jam me ju! Në qoftë se do të kryeni namazin...”** (Maide, 12) **“O Merjeme! Bindju Zotit tënd! Bëj sexhde dhe përkulu në ruku, bashkë me ata që përkulen (duke adhuruar Allahun)!”,** (Al-i Imran, 43) tregojnë se edhe profetët dhe bashkësitë e mëparshme janë urdhëruar të falin namazin dhe se nuk ka pasur asnjë popull në historinë e njerëzimit që nuk ka qenë i informuar në lidhje me sexhden dhe rukunë.

Namazi është një obligim që përfshin të gjitha llojet e adhurimeve. Të qenët rob i Zotit kokë e këmbë, arrihet



në sajë të namazit. Një nga parimet e pandryshueshme të besimit islam është që çdo njeri që hyn në moshën e pubertetit, e ka detyrim faljen e namazit dhe duhet ta përbushë këtë detyrë sublime, deri sa ta dorëzojë shpirtin e tij te Zoti i gjithësisë.

Profeti Muhamed (a.s.), e ka shprehur me këto fjalë rëndësinë e namazit: "...Dijeni mirë se vepra më e mirë, që mund të kryejë një njeri, është namazi." (Ibn Maxhe, Taharet, 4) Ky hadith sqaron faktin se namazi është akti më i rëndësishëm në mesin e të gjitha llojeve të adhurimeve dhe të veprimtarive të lejuara fetarisht. Besimtari duhet të veprojë në atë mënyrë, që të tregojë se është i ndërgjegjshëm që asnjë punë apo detyrë nuk është më e rëndësishme se namazi.

Namazi është një adhurim shumë i rëndësishëm. Ashtu siç shprehet qartë edhe në hadithin, ku thuhet: "Mes njeriut dhe shirkut e kufrit qëndron braktisja e namazit" (Muslim, Iman, 134), namazi është akti kryesor që e mban një besimtar larg kufrit dhe shirkut. Namazi është edhe faktori bazë, që e dallon besimtarin nga mohuesi i fesë. Namazi është pengesa më e madhe kundër çdo lloj shirku, mosbindjeje ndaj mësimave të fesë, presionit dhe padrejtësisë.


Aq i rëndësishëm është namazi si adhurim, sa edhe në luftë nuk lejohet braktisja e tij. Kurani tregon se si duhet falur namazi farz, në rast kërcënimi nga një sulm i mundshëm nga ana e armikut, duke theksuar në këtë mënyrë faktin që namazi nuk mund të lihet pa u falur. Kjo është arsyeja përse komandantët dhe ushtarët myslimanë nuk e kanë lënë pa falur namazin, kur kanë qenë në front të luftës. Ata nuk e patën braktisur vijën e luftës asnjëherë, derisa patën rënë dëshmorë të fesë (shëhid), në sajë të emocioneve, pasionit, aksionit dhe trimërisë që u jepte falja e namazeve.

Mua personalisht më ka ndodhur të shkoja me autobus në vendlindje, me rastin e festës së Kurban Bajramit. E pyeta shoferin e autobusit se ku mendonte të

ndalej, për faljen e namazit të sabahut. "Mos u bëj merak!" – më tha shoferi. "Edhe unë e fal namazin, kështu që do të ndalim në një vend të përshtatshëm." Që nga ajo ditë, nuk harroj të bëj dua për shoferin e autobusit. Ai e ndali autobusin në një vend të përshtatshëm për të falur namaz. Në autobus ishin afërsisht gjashtëdhjetë vetë, së bashku me personelin. Afërsisht njëzet pasagjerë, ishin gra dhe vajza të reja myslimane, që praktikonin mbajtjen e mbulesës. Të gjitha këto po i shkruaj, që të kuptohet më mirë situata e asaj dite. Kuptohej shumë mirë se të gjithë po shkonin për të festuar Kurban Bajramin. Dita e nesërme, që dita kur haxhilerët do të shkonin në Arafat për të përbushur njërin nga kushtet më të rëndësishme të adhurimit të haxhit. Fillonte periudha e kohës së vyer, kur këndohen tekbirot teshrik. Periudha kur pranohen duatë dhe lutjet që i bëhen Allahut. Megjithatë, ata që falën namazin qenë vetëm pesë vetë. Ky fakt më la një shije të hidhur në zemër. Umeti mysliman po përballet me problemin e moskorrektësisë në faljen e namazeve. Duket se dëshirat vetjake, puna, veprimtaria ditore kanë filluar t'u duken më të rëndësishme se namazi.

Namazi është adhurimi më i rëndësishëm, nisur edhe nga fakti që gjëja e parë, për të cilën ka për të dhënë llogari njeriu në botën tjetër është pikërisht vetë ky adhurim. Në lidhje me këtë çështje, profeti Muhamed ka thënë: "Gjëja e parë, për të cilën ka për të dhënë llogari njeriu në Ditën e Kiametit, është namazi. I lumi ai që i ka kryer me rregull namazet farz! Në qoftë se ai nuk i ka falur rregullisht namazet farz, atëherë do të shihet në regjistrin e punëve, në qoftë se ka falur namaze nafle. Ato namaze do të llogariten për t'iu plotësuar namazet farz, që ka lënë pa falur." (Ebu Davud, Salat, 149) Pra, namazi është shenja e besimtarit të vërtetë në këtë jetë dhe llogaria më e rëndësishme dhe më e vështirë që ka për t'u dhënë në jetën tjetër. Nëse mund të shprehemi edhe kështu, imani dhe namazi do të jenë pragu për të kaluar provimin e jetës tjetër.





Qytetërimi Islam

Prof. dr. Zijë Kazëxhë

Historia ka dëshmuar se aty ku ka njerëz, pak apo shumë ka edhe elementë qytetëruar. Zhvillimet civile, që lindin si rezultat i të jetuarit në mënyrë kolektive, vazhdojnë të jenë që nga dita kur njeriu nisi të jetojë mbi faqen dheut. Ndaj dhe nuk dihet saktësisht sa qytetërime të ndryshme nga njëri-tjetri kanë ardhur. Toynbee tregon se 16 qytetërime kanë vdekur dhe pesë të tjerë janë në prag të zhdukjes nga qytetërimi perëndimor.¹ Sot vërehen dy zona qytetërimi, njëra prej të cilave është qytetërimi perëndimor, i cili është nën ndikimin e Krishtërit, Hebraizmit dhe të sistemeve të tjera. Kurse tjetri është qytetërimi islam, i cili vazhdon ndikimin në zonat ku është përhapur feja islame.

Gjatë lindjes dhe zhvillimit të tij, qytetërimi islam është takuar me katër qytetërime apo kultura:

1. Bizanti (Greqia)
2. Irani
3. India
4. Kina

Në sajë të qytetërimit islam, i cili u zhvillua në një kohë të shkurtër, myslimanët morën një zonë që nga Ngushtica e Gjibraltarit deri tek Muri Kinez. Ata u sollën mirë me popullin aty. Pas një periudhe të shkurtër, myslimanët krijuan qytetërimin më të madh, në shkencë të ndryshme si ato ekzakte, art, ekonomi, mjekësi, letërsi, filozofi etj. Qytetërimi islam nuk mbeti vetëm me futjen nën sundim të disa zonave të rëndësishme të Azisë, Afrikës dhe Europës, njëkohësisht ka luajtur një rol të madh për të zhvilluar qytetërimin perëndimor, i

cili njihet si qytetërimi i Europës së sotme. Qytetërimi islam, që ende sot ruan ekzistencën e tij, megjithëse duket sikur ka humbur funksionin aktiv, ka ushtruar një ndikim të madh mbi qytetërimin perëndimor. Kjo gjë është më se e natyrshme. Një anëtar i një feje, e cila nxit për dituri duke vlerësuar meditimin dhe angazhimin për shkencë, si më të rëndësishme edhe se adhurimet vullnetare (nafilet); që vlerëson edhe gjumin e dijetarit/shkencëtarit dhe që vlerëson më shumë bojën e dijetarit, sesa gjakun e shehidit, natyrisht do të interesohet për shkencë. Kjo përpjekje do të ndihmojë të zhvillohet qytetërimi dhe mjetet e tij. Në sajë të këtij zhvillimi, bota islame, krahasuar me Perëndimin, u ngjit në një nivel më të lartë të qytetërimit. Kur bota perëndimore u përball me diturinë, shkencën natyrore, mendjen dhe teknikën e qytetërimit islam, e pa veten shumë të pafuqishme dhe të dobët. Për të plotësuar mungesën dhe për të jetuar si njerëz, zgjodhën rrugën për të përfituar nga myslimanët. Kur perëndimorët hodhën themelet e qytetërimit të tyre, ata përdorën elementë të qytetërimit islam. Ndërkohë, pa kuptuar kishin mbetur nën ndikimin e tij.

VEÇORITË E PËRBASHKËTA TË QYTETËRIMEVE

Kur vërehet me kujdes në hapësirën e përhapjes së komunitetit të ndonjërit nga qytetërimet, me gjithë shumicën e kombeve, ndryshimit të gjakut, llojit, ngjyrës dhe gjuhës që përmbanin ato, vërehet se qytetërimet kanë disa pika të përbashkëta. Këto pika të përbashkë-

¹. Ibrahim Kafesoğlu, *Türk Milli Kültürü*, Ankara 1977, fq. 9.

ta përbëjnë bazën, shpirtin dhe esencën e qytetërimit. Fjala vjen, nëse një njeri i thjeshtë i Stambollit ikën në Merakesh, Mezopotami, Kajro, Mekë, Damask, Baku, Tahrani, Kabul, Lahor, Kalkuta apo Semerkand, nuk e ndjen veten plotësisht të huaj. Të paktën nuk e ndjen veten në një tjetër atmosferë apo rreth, sa ndihet në Sofje apo Athinë, të cilat i ka shumë më afër. E ndjen veten brenda atyre imazheve, formave, lëvizjeve dhe sjelljeve që është mësuar t'i shohë.

Mënyra e veshjes, jetesës, traditat dhe situatat në ato zona, u ngjajnë atyre çfarë është mësuar ai. I njëjti fes, e njëjta xhelabije, gratë vishen njëllor, xhamitë e njëjta, adhuret e njëjta, i njëjti ezan, të njëjtat rituale, të njëjtat lutje etj.

Kjo ngjashmëri nuk mbetet vetëm në aspektin e jashtëm, por edhe në botën e brendshme të tyre, gjenden shpirtërore dhe në mentalitet.²

Edhe në grupet e tjera të qytetërimeve mund të vërehen situata të ngjashme. Pikat e përbashkëta mes popujve që janë pjesë e një grupi të një qytetërimi të caktuar, materiale apo shpirtërore qofshin, dëshmojnë veçorinë e atij qytetërimi.

Ajo çfarë i dallon popujt e ndryshëm nga aspekti kulturor, më shumë se mjetet dhe veglat që përdorin, janë tërësia e vlerave intelektuale dhe shpirtërore që ndodhet pas mjeteve dhe veglave.

Qytetërimi islam është emri i një qytetërimi të përbashkët, në të cilin bëjnë pjesë popujt të ndryshëm, që pranojnë besimin islam. Arabët, persët dhe turqit kanë dhënë kontribut të vyer në themelimin dhe zhvillimin e këtij qytetërimi. Ashtu sikurse shprehet edhe W. Barthold, emri qytetërimi islam apo qytetërimi arab i përket qytetërimit lindor të Mesjetës. Myslimanët që sollën këtë qytetërim, nuk ishin vetëm arabët, por thuajse tërë popujt e Azisë së Vogël dhe Afrikës, të cilët i bashkon Islami si fe zyrtare dhe gjuha arabe si gjuha e letërsisë dhe shkencës.³ Ky unitet pati sjellë një qytetërim të atillë, të cilit qytetërimi perëndimor i sotëm i është borxhli. R.V.C. Bodley (1546-1613), e rrëfen këtë të vërtetë në këtë mënyrë: "I jemi borxhlinj Islamit për Rilindjen". Krahas këtyre, sot jemi dëshmitarë që dita-ditës disa zhvillime të ndryshme po arrihen duke u frymëzuar nga studimet që po bëhen sot lidhur me institucionet osmane.

Pjesa e historisë së qytetërimit botëror, mes shekujve VII - XIII është Qytetërimi islam. Një nga të vërtetat e pamohueshme të historisë, është se mes shekujve VII - XIII populli islam ishte populli më i qytetëruar dhe i përparuar i Azisë së Vogël edhe i Europës. Në ato kohë, Bagdadi dhe Kordova ishin qytetet më të pasura të botës, në të cilat gjallëronte tregtia dhe zhvilloheshin artet e ndryshme. Këto qytete ishin njëkohësisht qendra aktivitetesh të dendura kulturore dhe burim energjie për qytetërimin. Shkenca dhe letërsia, që u zhvillua në një mënyrë marramendëse, tërhiqte vëmendjen e çdo dijetari apo artisti në botë.


Nëse një qytetërim përkufizohet sipas nivelit të përparimit material, përmes pasurisë intelektuale që ka dhuruar dhe nga vlerat shpirtërore dhe të veprave kreative, atëherë që me shfaqjen e Islamit, këto pesë shekuj në fjalë duhen pranuar si një nga periudhat më të ndritura të historisë botërore.

Ky zhvillim marramendës veçanërisht i aspektit shpirtëror të botës islame, me fuqinë reformatore të Islamit, aftësinë e aksionit shpirtëror dhe krahas këtyre, bashkë me aftësitë artistike dhe të menduarit e ndritur të popujve arabë dhe joarabë, që kanë kryesuar në këtë qytetërim, mund të shpjegohen me vlerën që Islami i ka dhënë shkencës.⁴ Ne nuk e ndjejmë të nevojshme t'u referohemi ajeteve dhe haditheve për këtë temë. Kontributin e Islamit është e pamundur ta kufizojmë vetëm në planin material apo atë shpirtëror, pasi është një sistem që zbatohet në çdo fushë të jetës, si në atë materiale, ashtu dhe në atë shpirtërore. Në sajë të kësaj veçorie, bota islame është marrë me çdo kategori të shkencave. Sipas botëkuptimit islam, shkenca dhe adhuremi janë dy elementë të pandashëm nga njëri-tjetri. Ndaj dhe myslimanët, që nga shekujt e parë të Islamit, nisën të studiojnë shkenca të ndryshme. Këto studime filluan në një farë mënyre me përkthime, pastaj me zhvillimin e tyre, nisën të dalin veprat e para autoriale. Në këto studime, krahas shkencave fetare, si Kurani, Suneti, Fikhu dhe Kelami, të cilat nuk nevojiteshin për përkthim, shkencat, si historia, gjeografia, astronomia, mjekësia, filozofia, matematika, arkitektura, ekonomia, sociologjia etj., ishin shkenca që hynin në interesin e tyre. Kështu që, zhvillimi i shumë shkencave, që pak ishin harruar dhe pak ishin braktisur, u realizuan përmes myslimanëve. Ndaj dhe mund të themi që qytetërimi i sotëm është

2. Ahmet Ağaoğlu, Üç Medeniyet, İstanbul, 1972, fq. 4-5.

3. M. Fuad Köprülü-W. Barthold, İslam Medeniyeti Tarihi, Ankara 1973, fq. 3.

4. Haydar Bammât, İslam'ın Çehresi, përkth turq. Osman Fehmi Giritli, İstanbul 1975, fq. 93-94.



Hasan Basriu

rahmetullahi alejh

Emri i tij është Hasan bin Ebi'l-Hasan el-Basri, ndërsa nofka është Ebu Muhamed dhe Ebu Said. Ai ishte kryeura e "Brezit të Artë", që arrinte deri te "Shekulli i Lumturisë". Ishte prej imamëve të brezit të tabiinëve dhe profesor në fikh e në tasavuf.

Përgjatë çlirimeve islame, babai i tij u soll si rob në Medine nga Mejsani, i cili është një vend afër Basrës së Irakut dhe u lirua nga Zejd bin Thabit el-Ensari. Nëna e tij është zonja Hajra, që u lirua nga Umu Seleme, e cila ishte njëra prej bashkëshorteve të Pejgamberit, sallallahu alejhi ve sellem. Ai lindi në vitin 21 hixhri (642 p.e.s.), në kohën e hilafetit të Hazretit Umer, radijallahu anh. Kur lindi, e dërguan te Hazreti Umer për t'i vendosur emrin. Kur Hazreti Umer pa fytyrën e tij të bukur, tha: "Emri i tij le të jetë Hasan!"

Hasan Basriu u rrit në shtëpinë e nënës së besimtarëve, Umu Seleme. Ai fitoi dashurinë, interesimin dhe lutjet e saj.

Lidhja e tij është me Imam Aliun, radijallahu anh. Nga ai veshi pelerinën e misticizmit. Ai është takuar me rreth njëqind e tridhjetë sahabë, shtatëdhjetë prej të cilëve patën marrë pjesë në Luftën e Bedrit. Po ashtu, ka transmetuar hadithe nga sahabët e mëdhenj, si Imran bin Husejn, Themure bin Xhundeb, Ebu Hurejre, Ibn Umer dhe Ibn Abas.

Pasi përfundoi studimet shkencore dhe edukimin shpirtëror në Medinë, u vendos në Basra, që ishte vendi i babait të tij. Ai formoi një fushë të madhe ndikimi me karakterin e fortë, me asketizmin dhe devotshmërinë, me adhurimin dhe frikërespektin ndaj Allahut. U takua me personalitete të nderuara, si Ibn Shirin dhe Shabi. Në Basra u bë një xhemat i madh, që dëgjonte vazat e tij. Rabi'at'u'l-Adevije, Malik bin Dinar dhe Habib Axxemi, ishin prej mistikëve të mëdhenj që përfituan prej tij.

Ai u shkroi letra burrave të shtetit, si Imam Hasan bin Aliut, radijallahu anh, dhe Umer bin Abdulazizit, të cilat synonin predikimin. Me këto letra, ai konsiderohet prej mistikëve të parë që këshillonin njerëzit për në udhëzim. Duke shfaqur një trimëri të rrallë, ai i shkroi këto fjalë Umer bin Hubejre el-Fezarit, i cili ishte emëruar prefekt i Irakut dhe i Horosanit

nga Jezid bin Abdulmeliku:

“O Ibn Hubejre! Ki frikë Allahun për Jezidin, por mos ki frikë Jezidin për Allahun! Sepse Allahu të shpëton ty nga Jezidi, ndërsa Jezidi nuk mund të të shpëtojë ty nga Allahu. Allahu Teala të dërgon befasisht ëngjëllin e vdekjes dhe ti bie nga vila jote e bukur, drejt e në varrin e ngushtë. Aty asgjë nuk mund të të shpëtojë, përveç punës sate.”

Me punën e tij, Hasan Basriu konsiderohet përfaqësues i tasavvufit, që mbështetej në frikë dhe brengë. Cilësia dalluese e jetës së tij askete ishte meditim, i cili e shpie njeriun te besimi dhe frika e brengosja që e pastrojnë veten, e bëjnë njeriun që të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe e shpjen atë te mirësitë e xhenetit. Baza e jetës së tij shpirtërore, ishte heqja dorë nga kjo botë, mosinteresi mbi

*S*ikur t'i shihnit ata, do t'i pandehnit të çmendur. Sikur ata të shikonin të mirët tuaj, do të thoshnin: “Këta janë njerëz që nuk kanë pjesë nga e mira dhe mirësia”. Ndërsa po të shikonin të këqijtë tuaj, do të pyesnin: “Edhe këta janë myslimanë?”

të ardhmen e botës, drejtimi nga Allahu dhe besimi ndaj tij.

Vishte rroba prej leshi dhe këtë e konsideronte si shenjë të modestisë. Ai thoshte:

“Unë kam arritur rreth shtatëdhjetë sahabë që kanë marrë pjesë në Luftën e Bedrit. Asnjëherë nuk kam parë që këta të vishnin diçka tjetër përveç leshit.” Përsëri thoshte: “Atij që vesh rroba të bardha për modesti, Allahu ia shton dritën e largpamësisë, por, nëse i vesh për shtirje dhe mburrje, e hedh në xhehenem.”

Duke krahasuar brezin e mëvonshëm me sahabët, thoshte:

“Sikur t'i shihnit ata, do t'i pandehnit të çmendur. Sikur ata të shikonin të mirët tuaj, do të thoshnin: “Këta janë njerëz që nuk kanë pjesë nga e mira dhe mirësia”. Ndërsa po të shikonin të këqijtë tuaj, do të pyesnin: “Edhe këta janë myslimanë?”

Ai ishte asket. Shkaku i të drejtuarit nga asketizmi, ishte shpëtimi nga një e keqe dhe arritja e një mirësie. Mirësia që dëshironte të arrinte, ishte sevapi i xhenetit, ndërsa e keqja prej së cilës dëshironte të sigurohej, ishte ndëshkimi i xhehenemit. Sepse asketizmi i vërtetë, është mosvlerësimi i tepërt i kësaj bote.

Nuk është parë asnjë njeri që të gjejë ahiretin duke kërkuar këtë botë, por ka shumë prej atyre që e kanë gjetur këtë botë, duke kërkuar ahiretin. Kjo botë është vendi i punës. Ai që e shoqëron atë pa e dashur dhe heq dorë prej saj, arrin kënaqësinë nga kjo shoqëri dhe përfiton. Por ai që e shoqëron duke e dashur, bëhet fatkeq.

Një ditë, Malik bin Dinar pyeti Hasan Basriun:

- Cili është ndëshkimi më i rëndë në këtë botë?

- Është vdekja e zemrës së njeriut.

- Përse vdes zemra?

Hasan Basriu iu përgjigj:

- Për shkak se do këtë botë.

Sepse ai që e nderon interesin e kësaj bote, bie në poshtërim. Sado që të jetë e madhe, përsëri e përkohshmja nuk është e barabartë me të përherëshmen.

Ai thotë:

“Vesvesi që vjen në zemër është nga shejtani. Nëse diçka dëshirohet vazhdimisht, ajo vjen nga vetja. Mënyra për të shpëtuar nga këto dëshira, është praktikimi i rrugës së rijazetit me agjërim dhe namaz.”

Ai tregon:

Në Abadan ishte një njeri i zi, i cili jetonte në gërmadha. Një ditë, mora disa gjëra nga pazari dhe shkova ta vizitoja. Ai më pyeti:

- Çfarë janë këto?

Unë i thashë:

- Disa gjëra për të cilat mund të kesh nevojë. Pa thënë asgjë, me dorën e tij më tregoi murin dhe qeshi. Befas pashë, por çfarë të shikoja, muret e atyre gërmadhave ishin komplet flori. Upendova për atë që bëra, menjëherë i lashë ato që kisha sjellë dhe u largova me ndikimin e asaj madhështie.



Ai ishte i devotshëm. Gjithmonë thoshte: "Një grimcë e devotshmërisë së sinqertë, është më e mirë se mijëra rekate namaz." Një ditë në Mekë, pa njërën prej fëmijëve të Hazretit Ali, i cili po mbante vazë duke u mbështetur në murin e Qabes dhe e pyeti:

-Cila është baza e fesë?

-Devotshmëria!

-Cili është shkatërrimi i fesë?

-Tamahu!

Hasan Basriu u kënaq shumë nga kjo përgjigje dhe u bë njeri i devotshëm. Për devotshmërinë thoshte kështu:

"Devotshmëria ka tri shkallë:

E para: I devotshmi thotë vetëm të drejtën edhe kur është i zemëruar edhe kur është i qetë.

E dyta: Imbron gjymtyrët e tij nga sjelljet që i hapin rrugë zemërimit të Allahut.

E treta: Synon çështjet prej të cilave Allahu është i kënaqur."

Një herë, hyri në një xhami për të falur namazin e akshamit. Namazin po e falte Habib Axhemi. Ngaqë Habib Axhemi nuk ishte Arab, ai nuk e fali namazin pas tij, duke u shqetësuar se mos bënte ndonjë gabim në leximin e Kuranit. Atë natë në ëndërr, iu tha: "Përse nuk u fale pas tij? Sikur të ishe falur, do të të faleshin të gjitha mëkatet që ke bërë deri në atë çast."

Një herë, u detyrua të dëgjonte një përgojim në kuvendin ku merrte pjesë. Gjërat që pa atë natë në ëndërr, i tregon kështu:

"Një njeri, i cili kishte një pjatë në dorë, u afrua te unë. Në pjatë kishte mish derri. Më urdhëroi që të haja nga ai. I thashë: "Ai është mish derri dhe nuk mund ta ha". Duke insistuar që ta haja, ma hapi nofullën dhe më futi me zor një kafshatë në gojë. Unë kisha frikë që ta nxirrja mishin nga goja dhe, po ashtu, kisha neveri ta gëlltisja. Në këtë gjendje u zgjova. Këtë erë e kam ndjerë tridhjetë ditë e tridhjetë net, në çdo gjë që kam ngrënë dhe kam pirë."

Edhe pse e dinte se ndëshkimi shpirtëror i imponim për të dëgjuar përgojimin, qoftë edhe pa dashje, është shumë i rëndë, asnjëherë nuk zemërohej me ata që e përgojnin. Një ditë, dikush i tha:

- Filani të ka përgojuar.

Ai i dërgoi një pjatë ëmbëlsirë përgojuesit dhe i tha:

- Dëgjova se më ke dhuruar të mirat e tua. Edhe unë po të dhuroj këtë si kundërvlerë.

Jeta e tij askete ishte e mbushur plot me frikë dhe pendim ndaj Allahut të Madhëruar. Ishte i shqetësuar dhe i brengosur. Ai nuk flinte dhe nuk dinte ç'ishte dremitja. Ishte një adhurues, i cili i kishte përveshur mëngët për ibadet. Ata që e shikonin, kujtonin se mos i kishte ndodhur ndonjë fatkeqësi, për shkak të brengosjes që kishte në aparençë. Ai shprehej:

"Besimtarët zgjohen të shqetësuar dhe ngrysen të shqetësuar ndërmjet dy frikëve. Njëra është një mëkat i kaluar, i cili nuk dihet se si pritët nga Allahu. Ndërsa tjetra është një jetë, përgjatë së cilës nuk dihet se me çfarë rreziqesh do të përballesh."

"Ai që e di se në fund do të vdesë, që beson se do të ngrihet në kiamet dhe që është i bindur se, kur të ringjallet do të dalë në audiencën e Allahut, duhet të jetojë me brengosje dhe shqetësim."

Sipas konceptit të tij në frikërespekt ndaj Allahut, zemra ka nevojë për një frikë të përhershme.

Ai frikësohej aq shumë nga zjarri i xhehenemit, saqë pandehte se xhehenemi është krijuar vetëm për të. Kështu, kur dëgjoi hadithin fisnik, i cili thotë: "Njeriu i fundit që do të dalë nga xhehenemi, është një person i cili quhet Hunad", qau dhe tha: "Ah sikur të isha unë Hunadi, sepse qoftë edhe në fund, ai ka një siguri se do të dalë nga xhehenemi. Ndërsa ne nuk e kemi një siguri të tillë."

Ai thotë:

“Nëse lexon Kuran dhe i beson atij, le të kesh shumë brengosje e shumë frikë në këtë botë. Po ashtu, qaj shumë.”

Atyre që thoshnin se i trembte njerëzit me fjalë të tilla, u përgjigjej kështu:

“Të frikësohesh derisa të arrish sigurinë, është më mirë se të frikësohesh pasi të arrish sigurinë.”

Një bedevi e pyeti se çdo të thotë sabër. Ai iu përgjigj:

- Sabri është dy llojesh: njëri është durimi ndaj belave e fatkeqësive dhe tjetri është durimi ndaj ndalesave hyjnore.

Kur bedeviu i tha:

- Unë nuk kam parë njeri më asket se ti.

Hasan Basriu iu përgjigj:

- Asketizmi im është plotësisht dëshirë. Durimi im është plotësisht qarje.

- Çdo të thotë kjo? A mund të ma shpjegosh pak? Më është ngatërruar koka fare.

-Durimi im në fatkeqësi e bindje, shpreh frikën time ndaj zjarrit të xhehenemit. Çfarë mund të jetë tjetër kjo, përveçse qarje? Ndërsa fakti që unë jam asket dhe nënvlerësues ndaj kësaj bote, çfarë mund të jetë tjetër përveçse dëshira ime për ahiretin? Lum për atë që duron vetëm për Allahun e jo për faktin se shqetësohet për xhenetin dhe xhehenemin!”

Ai thotë:

“Ëmbëlsinë shpirtërore kërkojeni në këto tri gjëra: Në namaz, në dhikër dhe në leximin e Kuranit. Lum për ju, nëse e gjeni. Nëse nuk e gjeni, dijeni se ju është mbyllur dera e veprës, e ëmbëlsisë shpirtërore, për shkak të ashpërsisë së zemrës.”

Kur i thanë:

- O shejhu ynë i nderuar! Zemra po na fle. Ju lutemi na qortoni.

Ai u tha:

- Ah sikur të flinte zemra juaj, sepse është shumë lehtë që ta zgjosh atë që fle. Por zemra juaj është e vdekur, sepse u bënë shumë kohë që përpiqem ta vë në lëvizje, por nuk ia dal dot mbanë.

Ilmu'l-Batin,
sipas Hasan
Basriut:

“Është një mister hyjnor, të cilin Allahu e vendos në zemrën e robërve të tij dhe të cilin nuk e di asnjë prej krijesave”. Ajetin: “Pastro rrobat e tua!” e komenton në formën: “Zbukuro moralin tënd!” dhe thotë: “Gjuha e të urtit është e lidhur me zemrën e tij. Kur dëshiron të thotë diçka, konsultohet me zemrën dhe, nëse është e dobishme, e thotë, përndryshe hesht. Ndërsa zemra e injorantit është e lidhur me gjuhën e tij. Gjuha nuk ndjen nevojë për t’u konsultuar me zemrën, kështu që flet mbarë e prapë.”

“Njerëzit e devotshëm vazhdimisht zgjedhin hesh-tjen. Asnjëherë nuk flasin pa folur zemrat a tyre.”

Së fundi, burri i dijes dhe i veprës, murshidi i madh Hasan Basriu, i cili thotë: “Kur të duash t’i urdhërosh diçka dikujt, së pari bëje vetë!”, u bë shembull për popullin, duke i përjetuar në vetvete vazat dhe këshillat e tij.

Në vitin 110 hixhri (728 p.e.s.), kur ndërroi jetë, xhenazeja iu fal nga një kallaballëk i madh në vendin e tij, Basra. Madje, sipas një transmetimi, kur ai ndërroi jetë, disa miq të Allahut kanë parë se janë hapur dyert e qiellit dhe kanë dëgjuar një thirrës që thërriste kështu:

“Hasan Basriu ndërroi jetë, kur Allahu ishte i kënaqur prej tij.”

SHËNIMET:

Ibn Sa’d, Tabakat, VII, 156 vd.; Isfahani Hiljetu’l-evtija, II, 130 vd, Huxhviri, Përktimi i Keshfu’l-mahxhub, 183, Sha’rani, Tabakalli’l-kubra, I, 31 vd., ibn Hallikan, Vefejatu’l-a’yan, II; 69, Attar, Tezkiretu’l-evlija, 30 vd, en Nebhani, Xhami’u kiramati’l-evlija, 21. Kushejri, Përktimi i Risales, 213. Kelabazi et-Ta’arrui; Munavi, el-Kevak Ibnu’d-durrije, I, 17.

Kurani dhe Ramazani

Salih Zeki Meriç

Agjërimi i Ramazanit, i cili qëndron nën hijen e Kuranit Fisnik, i faljetës sonë të përkohshme një freski përjetësie. As që mund të mendohet që njeriu, i cili është nderuar me ekzistencën, ta humbë këtë mirësi të madhe.

Në këtë jetë të vështirë, pa dashje në mendje të vjen pyetja, “a ka ndonjë vend lumturie?”. E ndërsa njerëzit mundohen t’i japin kuptim ndodhive, Ramazani i fton në atmosferën e Kuranit.

Ramazani është muaji i Kuranit.

Libri i pashoq, i cili i tregon njerëzimit mënyrën për të arritur përjetësinë, këtë muaj mbush me dituri hojet e shpirtit. Pastaj me qëllim që t’i përvetësojmë ato (dituri), na vë përpara jetën.

Për të kuptuar jetën, për të thithur të vërtetat brenda kohës së një dite dhe për t’u pajisur me zemra që do të luftojnë me të keqen, kemi nevojë për zërin e Kuranit. Shpëtimi i njerëzve që janë futur në rrugë pa krye, mund të jepet vetëm me Kuranin. Islami, i cili konceptin teori-praktikë e ka shkrirë në enën e punëve të mira, i ka ndaluar edhe debatet e kota që të përziejnë stomakun dhe tërheq vëmendjen ndaj këtyre gabimeve.

Përveç Allahut, kush do të japë informacion më të besueshëm në lidhje me vdekjen, e cila konsumon jetën dhe na e vështirëson çdo ditë që kalon?

Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është i

sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër, le të agjërojë më vonë aq ditë sa nuk i ka agjëruar. Allahu dëshiron që t’jua lehtësojë dhe jo t’jua vështirësojë. Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimin dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimin), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë. (El-Bekare, 185.)

Agjërimi është një urë vlerash. Nëse njeriu nuk largohet nga mirësitë e përkohshme, nuk mund të arrijë ato të përjetshmet. Nëse fëmija nuk ndërpret qumështin, nuk mund t’i shijojë ushqimet e ndryshme. Në agjërim gjenden shumë gëzime dhe mirësi materiale e shpirtërore, individuale e shoqërore, jetësore e morale.

Fjalët e Profetit tonë të dashur (a.s.), na mbushin me shpresë:

“Agjërimi dhe Kurani do të jenë ndërmjetësues për robin në ditën e gjykitit¹. Agjërimi është gjysma e durimit. Heshtja e agjëruarit është dhikër, gjumi i tij është adhërim, dua ja i pranohet, ndërsa shpërblimi i punës i shumëfishohet.”

Çdo besimtar duhet ta shfrytëzojë këtë muaj, duke u larguar nga gjynahet dhe të këqijat, duke lexuar dhe dëgjuar Kuran, duke dëgjuar ligjëratat dhe duke falur namazet e teravisë. Nuk duhet ta kalojmë kohën me punë dhe fjalë të padobishme. Ramazani është pranvera e botës shpirtërore, prandaj le ta mbushim bahçen e kësaj bote me dhikër, Kuran dhe salavate për Profetin (a.s.) dhe ta ruajmë atë nga erërat e pakujdesisë.

1. Ahmed ibën Hambel; Musned, no: 626, 11/199).



Lulja e Prillit

(Profetit Muhamed a.s.)

*Kur ti i kyç ngjyrat, pemët dhe lagjet,
Më humbasin adresat e vjetra të botës,
Mandej zhytem zbrazëtime të mia,
Mes t'bardhës e t'zezës lëkundet jeta.*

*Kur rrezet e diellit
Prej teje nuk mbijnë,
Humbasin mëngjeset,
E koha hapsirash ngrin.*

*Kur ti hanën mban në dorë,
Nata ime mbushet me hir,
E shuhet koha, hapsira ikën,
E lind një lule n'prill...*

*Bletët e shikimeve të mia punojnë,
Në zgjua jeta hareshëm gumëzhin,
Sillen rreth teje plot dashuri,
Ti je për to e vetmja stinë.*

*Edhe zemrat si trupat e kanë një atdhe,
Në liqenin romantik të dijes notojnë,
Eja n'kuvendin e fjalëve, të bisedojmë
Pak në shqip e pak në heshtje...*

Alban Kali

RINIA

ideale

Husejn Kerim Exhe

RINIA NË KURAN

Në Kuran, fjala “el-Feta”, së bashku me format e saj, kalon në dhjetë ajete. “el-Feta” do të thotë, “djalë i ri, djalosh”. Arabët e kanë zakon që në të shumtën e rasteve, djemtë të cilët punojnë si shërbyes, t’i thërrasin me fjalën “feta / djalosh”¹.

Profeti ynë (a.s.), ka thënë: “Shërbyesit tuaj mos i thërrisni me fjalët “skllav apo skllave”, por me fjalët “djalosh apo i ri” (fetaje, fetajeti)” (Buhari, Ilim, 44)

Sigurisht që midis fjalëve skllav, shërbyes etj. dhe fjalëve vëlla, djalosh ose thirrjes me emër, Ahmed, Hasan etj., ka ndryshim të madh. Me fjalët e para nënkuptohet poshtërim dhe mendjemadhësi. Ndërsa me fjalët e tjera, tregohet modesti dhe nderim për krijesën e Allahut. Kjo, sepse Allahu e ka krijuar njeriun me nder dhe i ka dhënë shumë vlerë. (Shih. El-Isra, 70.)

Edhe në kohët e vjetra, nxënësit që shkonin për të marrë mësim prej ndonjë dijetari, thirrreshin me fjalën “feta”. Por kjo fjalë ka edhe kuptimin skllav apo skllave. Këtë kuptim e gjejmë në Kuran, në suren Jusuf, 30 dhe suren en-Nisa 25.

UDHËTIMI I MUSAIT (A.S.), ME NJË DJALË TË RI

Kurani Kerim na e tregon kështu këtë ngjarje:

(Kujto) **kur Musai i tha djaloshit që e shoqëronte: “Nuk do të pushoj së ecuri, derisa të arrij në vendin ku takohen dy detet, edhe nëse do të më duhet të udhëtoj për shumë kohë.” Dhe, kur arritën në vendin, ku bashkoheshin dy detet, ata e harruan peshkun e tyre dhe ai rrëshqiti në det, duke e hapur atë si**

tunel. Kur kaluan më tej, Musai i tha shoqëruesit të vet: “Na jep drekën tonë, sepse jemi lodhur nga ky udhëtimi ynë”. Ai u përgjigj: “Shiko! Kur ndaluam tek ai shkëmbi, unë e harrova peshkun. Vetëm djalli më bëri ta harroj e nuk ta thashë se peshku mori rrugën nga deti në mënyrë të habitshme!” (Musai) tha: “Kjo është ajo që po kërkojmë”. Andaj u kthyen nëpër gjurmët e veta.” (Kehf, 60-64)

Koha dhe vendi ku udhëtoi Musai (a.s.), nuk dihet. Por është e qartë se këtu kemi një mesazh, një mësim ose një të vërtetë të fshehur. Këtu flitet edhe për besnikërinë e djaloshit që shoqëronte Musain (a.s.), edhe për fillimin e udhëtimit misterioz të Musait (a.s.). Pas këtij momenti, Musai (a.s.), do të bëjë një udhëtim interesant me dikë, që në popull njihet si Hidri, të cilit Allahu Teala i ka dhënë dije dhe urtësi.

Ubej b. Ka'b, transmeton se Profeti (a.s.), ka thënë: “Musai (a.s.), u ngrit në këmbë për të folur me popullin e tij. Populli e pyeti se kush është më i dituri prej njerëzve dhe ai u përgjigj, duke thënë: “Unë!”. Për shkak se Musai (a.s.), nuk ia la Allahut këtë dije, Allahu e qortoi dhe i tha: “Një robi Im që ndodhet në vendin ku bashkohen dy dete, është më i ditur se ti.” Musai (a.s.), pyet: “O Zoti im, si mund të takohem me të.” Allahu i thotë: “Merr me vete një peshk dhe fute në një çantë. Aty ku peshku do të humbë, aty e gjen edhe robin tim.” (Buhari, Ilim, 44 no: 122)

Siç tregohet edhe në një hadith tjetër, Musai (a.s.), e porositi djaloshin që ta njoftonte, kur peshku të ndahej prej tyre. Mirëpo, peshku filloi të përpëlitej kur ata ishin duke fjetur. Djali po ngurronte ta zgjonte Musain (a.s.) dhe peshku mori rrugën e tij për në det. Të nesërmen,

1. IbënMandhur, Lisau'l-Arab, 11/127-128. Isfehani, el-Mufredat s: 560

kur Musai (a.s.), kërkoi torbën e ushqimeve, djaloshi e njoftoi për punën e peshkut. Atë moment, Musai (a.s.), e kuptoi se ai që po kërkonin, ndodhej në atë vend ku peshku u zhyt në det. (Buhari, Tefsir, 18 no: 4726.)

Megjithëse në disa burime thuhet se djaloshi ishte Jushabin Nun, një prej nipërve të Jusufit (a.s.), apo djali i motrës së Musait (a.s.), ajo që ka rëndësi, nuk është identiteti i tij, por roli dhe puna e tij, që simbolizon besnikërinë.

Burimet thonë se ky djalosh i ka shërbyer Musait (a.s.), për shumë vite me radhë dhe ka mësuar shumë gjëra prej tij. Gjithashtu, shtojnë se pas vdekjes së Musait (a.s.), ky djalosh është bërë profeti dhe prijësi izraelitëve. Nëse informacioni që vjen prej këtyre burimeve është i vërtetë, kjo gradë i është dhënë, sepse ai ka qenë ndjekës dhe nxënës i Musait (a.s.). Gjithashtu edhe si rezultat i bindjes dhe besnikërisë ndaj tij.

Mbase kur Musai (a.s.), i ka thënë, “eja të shkojmë”, ai nuk ka kundërshtuar aspak. Nuk ka pyetur, “Ku është vendi në të cilin bashkohen dy dete dhe pse po shkojmë?”. Madje, kur Musai (a.s.), ka thënë: “Nëse është nevoja, do të shkoj edhe më larg”, ai nuk u ankua e të thoshte, “unë nuk vij”, sepse ai ishte më se i sigurt se Musai (a.s.), po vepronte me vullnetin e Allahut Teala. Ai iu bind fjalëve të Musait (a.s.), duke marrë me vete torbën me ushqime dhe duke dalë për udhë me të.

Mbase ai e kishte kuptuar urtësinë, synimin dhe fundin e bukur të këtij udhëtimi, sepse njeriu që po ndiqte nuk ishte një njeri çfarëdo, por një profet, të cilit i kishte ardhur shpallje prej Allahut. Ai nuk ishte një aventurier, që vraponte pas aventurave, as një zbulues që dilte për zbulime dhe as një gjuetar thesaresh, që kishte dalë për të kërkuar thesare, por ishte një profet i lartë, i cili ishte dërguar për t'i ftuar njerëzit në rrugën e drejtë.

Këtu është e mundur të gjejmë sinqeritetin e besimit të një të riu, pastërtinë, bindjen dhe mundin e tij në rrugë të Allahut. Duke u nisur nga kuptimi i fjalës “feta”, pra, merrni kuptimin që dëshironi, i ri, trim, djalosh ose edhe shërbëtor, ndihmës dhe skllav. Në fund të fundit, të gjitha ato kuptime tregojnë edhe për rëndësinë e detyrës së tij, por edhe për sinqeritetin e tij në çuarjen në vend të asaj detyre.

Ai ishte feta, trim dhe i guximshëm. Me këtë shembull, u thuhet të rinjve tanë sot: Edhe ju bëhuni udhëtarë të

rrugës së vërtetë. Edhe ju ndiqni rrugën e Profetit, që me shpallje i ftonë njerëzit në rrugën e drejtë. Edhe ju merrni përgjegjësi dhe përmbushini më së miri. Edhe ju bëhuni seriozë në punë, realistë në pretendime dhe të sinqertë në adhurimet tuaja. Ndërsa në shpresat tuaja, mbështetuni gjithmonë tek Allahu i Madhëruar.

RINIA IDEALE

Kurani Kerim na jep shumë shembuj me të rinj dhe na tregon shumë skena të jetës së tyre, prej të cilave duhet të marrim mësim. Një nga këta, është edhe njëri nga bijtë e Ademit (a.s.), i pafajshmi i parë, që vritet nga një tjetër prej bijve të Ademit (a.s.).

NJË PREJ BIJVE TË ADEMIT (A.S.)

Dy prej bijve të Ademit (a.s.), me qëllim që të afroheshin më tepër me Allahun, i kushtuan Atij nga një kurban. Mirëpo, vetëm kurban i njërit prej tyre u pranua, ndërsa i tjetrit u refuzua. Për këtë arsye, ai të cilit nuk i ishte pranuar kurban, papritur dhe pa asnjë arsye, i thotë tjetrit: “Patjetër që unë do të të vras ty”. Ndërsa përgjigja e atij, të cilit i ishte pranuar kurban, ishte përgjigja e një besimtarit të vërtetë dhe të sinqertë:

“...Allahu pranon vetëm prej të devotshmit. Nëse ti ngre dorë të më vrasësh mua, unë nuk do ta ngre dorën që të të vras, sepse, në të vërtetë, unë i frikësohem Allahut, Zotit të gjithësisë.” (Maide, 27-28)

Në këtë ndodhi, ndihet shumë ndikimi serioz dhe i rrezikshëm i iblisit mbi dobësitë dhe ambiciet e njeriut. Kjo ngjarje, e cila ndodhi midis dy djemve të Ademit (a.s.), është fillimi i luftës midis dy poleve të kundërta dhe dy zgjedhjeve të kundërta, e cila është zvarritur dhe ka ardhur deri në ditët tona.

Këto dy pole të kundërta, janë ata që pranojnë dhe duan të jetojnë me parimet e Allahut, të cilat i dërgoi me anë të profetëve të Tij dhe ata që me mashtrimin e iblisit, mendimin e tyre e pranojnë si më të drejtin dhe duan të jetojnë siç ua ka ënda.

Këto dy pole të kundërta, janë ata që besojnë Allahun si Zotin e vetëm dhe që veprojnë sipas këtij besimi dhe ata që veprojnë sikur Allahu nuk ekziston fare ose ata që nuk i pëlqejnë kufijtë e hallallit dhe haramit, që ka vendosur Allahu, por guxojnë t'i vendosin vetë ata kufij. Në një farë kuptimi, kjo luftë bëhet midis atyre që mbajnë krahun e iblisit dhe atyre që mbajnë anën e Allahut.



Në këtë luftë, qëndrimi i atyre që janë në anën e Allahut, është: ftesa, udhëzimi, mëshira, afrimi, ruajtja, kujtesa, këshilla dhe puna për largimin e të tjerëve prej së keqes. Ndërsa qëndrimi i atyre që janë në anën e iblisit, është: hilja, mashtrimi, kërcënim, mizoria, tirania, shtypja, terrori, shkelja e të drejtave, gënjeshtria, ambicia e verbër dhe abuzimi me fenë.

Një anë mundohet që të ndajë me drejtësi burimet e jetesës që ndodhen në tokë për njerëzit, të mos ia ngulin sytë pasurisë së tjetrit dhe të këshillojnë të mos jenë ziliqarë e të pangopur. Ndërsa ana tjetër i hedh pas krahëve të gjitha parimet e drejtësisë dhe përpiqet të zotërojë gjithçka, fuqinë dhe pushtetin.

Shihet qartë se djali i pafajshëm është munduar shumë të ndikojë tek vëllai i tij dhe ta bindë që të mos e bëjë atë veprim (vrasjen). Ai u mundua ta shuajë zjarrin e ambicies së tepërt dhe të zilisë që kishte pushtuar shpirtin e vëllait të tij, duke i thënë: "Mos bëj kështu! Kjo gjë është në kundërshtim me devotshmërinë. Përndryshe do të marrësh përsipër edhe gjynahun tim edhe tëndin. Pastaj do të bëhesh prej mizorëve dhe do të përfundosh në Xhehenem", por nuk ia doli mbanë që ta bindte.

Në këtë shembull na prezantohen dy lloj të rinjsh. Njëri ishte dorëzuar plotësisht dhe me sinqeritet ndaj ligjeve të Allahut, që kishin ardhur me profetin e parë dhe jo dëshirave të tij. Ai i kishte pranuar parimet që kishin zbritur për bashkësinë e parë njerëzore dhe mundohej të jetonte me to, duke qëndruar larg ngatërresave, ambicieve të tepërta, padrejtësisë dhe zilisë. Ndërsa tjetri, ishte një kryeneç që i kishte refuzuar këto parime, ishte bërë peng i egos së vet dhe ambicieve të tij dhe ishte mashtruar me vesveset e iblisit.

Djali i pafajshëm bëri atë që i takonte dhe zgjodhi të vepronte me vetëdijen e përgjegjësisë ndaj Allahut. Ndërsa tjetri, bëri të njëjtën gjë që bëri edhe iblisi dhe derdhi gjakun e vëllait të tij. Ai nuk i njohu kufijtë e Allahut, por i kaloi ata dhe u bë prej të humburve. Më e keqja është se ky djalë i ri, ishte ai që filloi për herë të parë zakonet e keq të derdhjes së gjakut pa të drejtë që ka ardhur deri në ditët tona. Tashmë, që këtej e tutje, të gjithë vrasësit, të gjithë ambiciozët, të gjithë të pasionuarit mbas pushtetit me pa të drejtë dhe të gjithë ata, për të cilët pasuria është më e shtrenjtë se çdo gjë tjetër, do të marrin për shembull këtë djalë të ri, Kabilin.

Me këtë shembull, Kurani Kerim i bën thirrje të gjithë

rinisë: "Bëhuni si djali i pafajshëm i Adem (a.s.) dhe mos u bëni kurrë si djali i tij vrasës."

TË RINJTË E SHPELLËS

Në Kuran, gjejmë edhe ndodhinë e të rinjve të shpellës, të cilët me guxim dhe trimëri kundërshtuan mbretin idhujtar të kohës ku jetonin dhe i kthyen shpinën fesë pagane të të parëve të tyre. Për ta, Kurani përdor fjalën "el-feta" dhe i nderon ata, duke i thirrur: "Ashab-i Kehf dhe Ashab-i Rakim". Kurani i bën ata të pavdekshëm, duke na sjellë këtë ndodhi.

Të rinjtë e shpellës, janë shembull i veçantë, i përsosur dhe interesant. Sipas disa burimeve, ata ishin princa në pallatin mbretëror. Mbase kishin baballarë të pasur, të fuqishëm dhe me autoritet. Ata do të kishin trashëguar pasurinë e baballarëve të tyre dhe do të zotëronin çdo gjë që ua kishte ënda. Mbase jetonin të zhytur në luks e rehati. Mirëpo ata, ashtu si edhe shumë udhëtarë të tjerë të së vërtetës, nuk zgjodhën anën luksoze të kësaj bote, e cila i përshtatej egos së tyre, por me anë të dritës hyjnore që lindi në zemrat e tyre, zgjodhën besimin dhe mënyrën e jetesës, e cila do t'u bënte dobi pas vdekjes dhe do t'i çonte tek Allahu. Ata e kuptuan se jeta që bënte shoqëria ku jetonin dhe feja idhujtare që ndiqnin prindërit e tyre, nuk ishin të sakta. Prandaj dhe iu dorëzuan Zotit të gjithësisë, Allahut Teala. Ata hodhën mënjane mundësinë për të qenë të pasur e të fuqishëm dhe, duke marrë përsipër çdo lloj rreziku, deklaruan besimin e tyre tek Allahu.

Me vetëdijen se rinia e tyre dhe çdo gjë që zotëronin ishte e përkohshme dhe se një ditë çdo gjë do të merrte fund, ata u lidhën pas një fuqie, e cila është e përjetshme. Allahu Teala u kënaq me zgjedhjen e tyre të vështirë por të sinqertë dhe ua mundësoi të strehoheshin në një shpellë. Pastaj bëri që ata të flinin të fshehur në atë shpellë për 309 vjet. Me këtë, Allahu deshi të tregonte edhe fuqinë e Tij, edhe se sa fitim i madh është zgjedhja e një rruge për hir të Allahut.

Ja rinia, ja të rinjtë... Shembuj të përsosur... Qëndrime që të mahnitin... Përfundime që të bëjnë t'i kesh zili...

Të flesh në shpellë 309 vjet pa vdekur dhe të jetosh përjetë në zemrat e myslimanëve si dëshmitari më i fuqishëm i së vërtetës...

Ky përfundim i shkëlqyer, është shpërblim për ta, sepse pavarësisht gjendjes në të cilën ndodheshin, ata nuk zgjodhën një besim dhe një mënyrë jetese të



diktuar nga të tjerët, por zgjodhën të adhuronin Zotin e botëve, Allahun e Madhëruar. Ky përfundim, është shpërblimi që morën, për shkak se nuk dëgjuan zërin e egos, por të zemrës, nuk zgjodhën të përkohshmen, por të përgjeshmen, nuk zgjodhën munkerin (të keqen), por ma'rufin "të mirën".

Njëri prej shkaqeve, që këta të rinj u mbajtën për një kohë kaq të gjatë në atë shpellë, mund të jetë edhe ky: Zgjohuni o të rinj! Sot jeni të rinj, të fortë dhe të mbushur me energji. Por kjo është e përkohshme. Ashtu si çdo gjë është e përkohshme, edhe periudha e rinisë suaj është e tillë.

Ata u vunë në gjumë për 309 vjet dhe e gjithë rinia u kaloi në atë shpellë, në një gjumë të thellë. Por besimi i tyre, guximi dhe punët e tyre të singerta ngelën si trashëgim dhe shembull për të gjithë brezat e mëvonshëm. Ashab-i Kehf do të qëndrojnë përpara të rinjve deri në ditën e kiametit, si shembull për zgjedhjen që duhet të bëjnë në jetë.

PROFETI, BIRI I PROFETIT

Kurani ka bërë shembull për të gjithë rininë deri në ditën e kiametit edhe Ismailin (a.s.), që ishte në lule të rinisë.

"Kur fëmija u rrit aq sa ta ndihmonte në punë, Ibrahim i tha: "O djali im, kam parë ëndërr se duhet të të flijoj. Çfarë mendon ti?" - I biri i tha: "O ati im, vepron ashtu siç je urdhëruar! Dash-të Allahu, unë do të jem i durueshëm!" Pasi iu nënshtuan që të dy urdhrat, (Ibrahimi) e vuri (Ismailin) me ballë për tokë. Ne e thirrëm: "O Ibrahim, ti e përmbushe ëndrrën." Vërtet, Ne kështu i shpërblejmë vepërmirët! Kjo, me të vërtetë ka qenë një provë e qartë!" (Saffat, 102-106)

Ismaili (a.s.), e kaloi me sukses këtë provë që mund të përfundonte me vdekje. E zgjati fytyrën i dorëzuar dhe u kënaq me urdhrin e Allahut. Jetën Ai ia kishte dhënë dhe Ai do t'ia merrte. Herët apo vonë, sot apo nesër... Çfarë ndryshimi kishte? Ai e dinte shumë mirë se nuk mund t'i shpëtonte vdekjes, sado i fortë të ishte. Ai i besoi ashtu siç duhet caktimit të Allahut. Ndërsa prova e këtij besimi, ishte dhënia si dhuratë e gjësë më të shtrenjtë, jetës, për t'u afruar tek dera e të Lartmadhëruarit. Dhe ai ishte gati për këtë.

Ashtu siç e kuptojmë edhe nga ajetet, shpërblimin e këtij veprimi e mori të shumëfishtë. Allahu u dha nderin e ndërtimit të shtëpisë së parë në faqen e dheut për adhurin e Tij, Qaben, të cilën e ndërtoi së bashku

me babanë e tij. Dhe të dy, u bënë prej njerëzve që do të kujtohen për mirësi deri në ditën e kiametit. Ata kujtohen sa herë që pihet prej ujit të zemzemit ose kur bëhet fjalë për të, sepse zemzemi ishte një dhuratë për të dhe nënën e tij të nderuar. Por më e rëndësishmja ishte se Ismailit (a.s.), iu dha nderi të ishte prej gjyshërve të Profetit tonë të dashur, Muhamedit (a.s.). Ja pra, kështu shpërblehen ata që bëjnë mirësi.

Ismaili (a.s.), qëndron përpara të rinjve si një shembull i gjallë dhe i përsosur. Ashtu si edhe shumë të tjerë!

TË RINJË QË MERITOJNË HIJEN E ARSHIT

Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

"Në ditën e kiametit, kur nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së arshit, Allahu Teala, do të strehojë shtatë grupe njerëzish nën hijen e tij (arshit): Prijësin e drejtë. Të riun që është i devotshëm ndaj Allahut dhe bën një jetë të pastër. Myslimanin, zemra e të cilit është e lidhur me xhaminë. Njerëzit që bashkohen dhe ndahen vetëm për hir të Allahut. Njeriun që i përmbahet tundimit të ftesës amorale të një gruaje me pozitë, duke i thënë: "Unë kam frikë Allahun". Atë që jep sado-ka, aq fshehtas, sa që dora e majtë nuk e di se çka dhënë e djathta. Atë që e përmend Allahun dhe derdh lot kur është në vetmi." (Buhari, Ezan, 36)

Ja pra, një i ri shembullor, një i ri trim: I riu që është i devotshëm ndaj Allahut dhe që bën jetë të pastër. Ai që i kalon vitet e rinisë brenda kufijve që ka caktuar feja të cilën e beson, që e ruan veten e tij nga kundërshtimi i urdhrave të Allahut, që i bën ballë ndikimit të dëshirave, epsheve dhe pasioneve, të cilat janë të vështira për t'u frenuar dhe që kapet fort pas besimit dhe adhurimit të Allahut... Padyshim se qëndrimi i një njeriu të tillë, është rezultat i respektit dhe përgjegjësisë që ndjen ai ndaj Zotit të vet. T'u bindesh urdhrave të Allahut dhe të largohesh prej gjynaheve, të çon drejt një fitoreje të madhe. Dhe veçanërisht, nëse kjo është arritur gjatë viteve të rinisë.

I riu, zemra e të cilit është e lidhur me xhaminë, është një i ri që e do xhaminë, ndihmon në ndërtimin e xhamive, kontribuon në çdo aspekt të jetës së xhamive dhe është pjesë e xhemit të përhershëm të xhamisë.

I riu që refuzon ftesën amorale të një gruaje me pozitë, duke i thënë: "U kam frikë Allahun", tregon një trimëri të vërtetë. Ai po vepron në kundërshtim me dëshirën e madhe të egos dhe po e refuzon këtë ftesë joshëse për egon e tij, duke thënë: "Unë kam frikë nga Allahu



dhe nga kalimi i kufijve që ka vendosur Ai”.

Lum për ata që kanë një devotshmëri të tillë!..

Kurani Kerim i përgëzon me mirësi ata që kanë frikë Allahun dhe veprojnë me respekt ndaj Tij. Një nga këto përgëzime shprehet qartë edhe në këtë ajet fisnik:

“...Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t’ia lehtësojë çështjen.” (Talak, 4)

Një shembull në lidhje me lehtësimin e çështjes, është edhe gjendja e këtyre personave për të cilët na tregon Profeti (a.s.):

“Një herë, tre persona kishin dalë për udhë. Kur erdhi mbrëmja, ata u futën në një shpellë për të kaluar natën. Sapo hynë në shpellë, nga mali ra një gur i madh dhe zuri hyrjen e shpellës. Të shqetësuar, filluan të mendonin për një rrugëzgjidhje. Njëri prej tyre thotë:

- Nuk kemi rrugëzgjidhje tjetër, përveçse t’i lutemi dhe t’i përgjrohemi Allahut, duke përmendur punët e mira që kemi bërë për hir të Tij.

Për këtë arsye, çdonjëri prej tyre filloi të kërkonte ndihmë prej Allahut, duke përmendur nga një punë për të cilën shpresonte se i ishte pranuar. Njëri prej tyre fillon e lutet, duke thënë:

- O Zot! Unë kisha një vajzë xhaxhai dhe e doja më shumë se të gjithë. Unë desha të kryeja marrëdhënie intime me të, por ajo nuk e pranoi propozimin tim. Më në fund, në një vit kur ra zia e bukës, vajza e xhaxhait erdhi tek unë për të kërkuar ndihmë. Unë i propozova njëqind e njëzet dinarë, nëse ajo do të kryente marrëdhënie me mua. Ajo pranoi dhe sapo u bëra gati të shkoja me të, ajo më tha:

- Ki frikë Allahun! Mos përfito prej meje në mënyrë të pamoralshme!

Megjithëse e doja më shumë se gjithçka, pasi dëgjova këto fjalë, hoqa dorë prej saj dhe nuk i mora as paratë që i dhashë. O Zoti im! Nëse e kam bërë këtë punë për të fituar kënaqësinë tënde, na shpëto prej gjendjes në të cilën ndodhem!

Më në fund, të treve iu pranuan lutjet dhe ata shpëtuuan prej shpellës. (Buhari, Ixhare, 12)

Të shpresojmë që të rinjtë myslimanë të kohës sonë, të veprojnë sipas këshillave të Kuranit, të marrin shembull botëkuptimin e devotshmërisë së Profetit (a.s.) dhe të mundohen të bëhen si të rinjtë e devotshëm, për të cilët folëm më sipër.

Nuk duhet të harrojmë edhe faktin se ata që i besuan më parë Profetit (a.s.) dhe e ndihmuan atë në misionin e tij, ishin të rinjtë. Më vonë, këta të rinj u bënë figurat më të ndritura të historisë islame dhe gëzuan ndihmën e Allahut. Ata u nderuan edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër.



Lutbe të zgjedhura

Naim Drljaj



Fjala islam ka të njëtin burim me fjalët “es-salam që do të thonë “paqe” dhe me fjalën “silm” që do të thotë nënshtrimi ndaj vullnetit të Allahut (xh.sh.). Shkurtimisht, islam do të thotë paqe e mbërritur me anë të nënshtrimit ndaj vullnetit të Zotit (xh.sh.).

Paqja, sipas fesë islame, duhet të përfshijë të gjitha sferat e jetës njerëzore. Kjo do të thotë që paqja nuk duhet konsideruar vetëm si dukuri që përfshin pjesë të kufizuara të jetës ose si një mjet i krijimit të një marrëdhënieje të caktuar, por si mënyrë të jetuari, e cila arrin ta përfshijë jetën njerëzore në tërësinë e saj.

Mesazhi kryesor që feja islame u transmeton njerëzve, është shprehur në vetë emrin që ka ky besim, që është “paqe”.

Edhe pse në ditët e sotme bota mbarë predikon paqen, ajo vazhdon t’i mungojë njeriut dhe njerëzimit. Njerëzit kujtohen për paqe, vetëm kur privohen prej saj. Njerëzimi do të ketë paqe vetëm atëherë, kur individët do të jenë në paqe me veten e tyre, me shoqërinë dhe me krijuesin e tyre, Allahun (xh.sh.).

Paqja me Zotin. Mund të themi se njeriu e arrin gradën më të lartë të paqes, vetëm atëherë kur ai është në gjendje të plotë përlësie ndaj Krijuesit të tij, duke zbatuar urdhrat e Zotit. Moszbatimi i porositve të Zotit, sjell zemërimin e Tij.

Paqja me familjen. Duke kryer detyrimet që individit ka si familjar.

Paqja

SI PARIM I ÇDO MYSLIMANI

Paqja me njerëzit. Njeriu duhet të krijojë marrëdhënie të mira me të gjithë njerëzit e tjerë dhe duhet të jetë i dobishëm për shoqërinë njerëzore.

Paqja me vetveten. Njeriu që jeton në paqe me Krijuesin dhe me njerëzit e tjerë, ka shpëtuar nga streset. Ai mundohet të distancohet nga ngatërresat dhe përleshjet, arrin të kontrollojë instinktet e tij impulsive dhe shndërrohet në një person që mendon vetëm mirë, sepse ai ka gjetur lumturinë e brendshme dhe qetësinë shpirtërore.

Paqja në islam është një koncept gjithpërfshirës për mbarë njerëzinë, që fillon tek bota e brendshme e individit dhe zhvillohet në marrëdhëniet e tij shoqërore dhe ato që ai ka me Krijuesin. Islami është rruga e paqes, e harmonisë dhe e vëllazërimit njerëzor.

Allahu (xh.sh.), thotë: ***"O ju që besuat, jetoni në paqe të plotë! Pranojeni islamin me të gjitha rregullat e tij dhe mos shkoni gjurmëve të shejtanit, sepse ai është armiku juaj i përbetuar."*** (Bekare, 208.)

Paqja ka vend edhe në konfliktet e lindura. Allahu (xh.sh.), thotë: ***"Nëse ata tregojnë se duan paqe, atëherë edhe ti ano nga ajo dhe mbështetu tek Allahu..."*** (Enfal, 61.). Islami ka përcaktuar rregulla bazë të rëndësishme që sigurojnë vijimësinë e paqes. Disa prej tyre janë:

Bindja ndaj së drejtës dhe drejtësisë. Islami kërkon një shoqëri ku zbatohet drejtësia. Myslimani, i cili e njeh mirë fenë Islame dhe e ka përqaftuar Kuranin, nuk merret me gjërat e ndaluara, por shikon që të mos çënojnë të drejtën e askujt. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: ***"Besimtari është vëlla për besimtarin. As nuk e dhunon dhe as nuk e lë në dorë të mizorëve."*** (Buhari). Në bazat e fesë Islame qëndron ***"Tevhidi"***, ndërsa në bazë të të

gjitha marrëdhënieve njerëzore qëndron ***"Drejtësia"***.

Sjellja e mirë dhe e drejtë. Që jeta e njeriut të jetë e ekuilibruar dhe e rregullt, është e domosdoshme barazia mes njerëzve. Sjellja në mënyrë të pabarabartë me njerëzit sjell urrejtjen, dhunën dhe gjëra të tjera të pakëndshme. Në një atmosferë të tillë, është e pamundur të mbizotërojë paqja.

Morali i lartë. Allahu (xh.sh.), na ka urdhëruar çdo lloj mirësie dhe na e ka ndaluar çdo lloj keqbërjeje. Myslimani i edukuar me etikën e Kuranit, është i sjellshëm dhe paqësor me të gjithë njerëzit.

Liria e të besuarit dhe e të menduarit. Islami jo vetëm që siguron lirinë e mendimit dhe të të shprehurit të njerëzve, por edhe ka ndaluar punët që çojnë në mosmarrëveshje dhe presionet ndaj mendimeve të lira. Ai ka vënë si kusht që njerëzit të besojnë me vullnetin e tyre të lirë dhe po me këtë vullnet të adhurojnë edhe Krijuesin e tyre. Allahu (xh.sh.), thotë: ***"Nuk ka detyrim në fe..."*** (Bekare, 256.). Paqja është një thesar shumë i çmueshëm dhe shumë i shtrenjtë për njeriun. Ajo është ndër çështjet më madhore në zhvillimin dhe mbarëvajtjen e jetës së njeriut në tokë.

Si realizohet paqja në Islam? Duke zbatuar ligjet e Kuranit, që janë urdhrat e Zotit (xh.sh.)

Duke i dhënë çdo njeriu të drejtën që i takon.

Duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin në ato gjëra që na bashkojnë.

Paqja është e gërshetuar kudo me mësimet e islamit mbi gjithësinë, jetën dhe njerëzimin. Të gjitha sistemet, doktrinat, ligjet dhe rituali islam, janë ndërtuar mbi parimin themelore të paqes.

E lusim Allahun (xh.sh.), që në vendin tonë të mbizotërojë paqja, harmonia dhe respekti mes njëri-tjetrit.

BUKA E BARDHË “BOMBË SHEQERI”!

Jemi mësuar që ta përdorim shpesh në tavolinë pa menduar gjatë për pasojat që mund të ketë në peshën tonë trupore. Buka e bardhë përbëhet nga një miell shumë i rafinuar, gjë që përbën një rrezik të vërtetë për linjat trupore.

Sipas një studimi spanjoll, kjo lloj buke cilësohet si “bombë sheqeri” dhe nëse konsumohen më shumë se pesë feta nga kjo bukë në ditë, rritet me 40% rreziku i mbipeshës dhe obezitetit.

Studimi u drejtua nga Miguel Martinez-Gonzalez i Universitetit të Navarra në Spanjë, ku u

analizuan 927 persona me moshë të re, për pesë vjet rresht, që të gjithë me peshë normale në fillim të studimit. Studiuesit grumbulluan informacione lidhur me konsumin e bukës dhe ushqimeve të tjera, si dhe duke analizuar ndryshimin e peshës së tyre trupore.

Rezultoi se ata persona që konsumonin dy ose më shumë racione buke në ditë, mesatarisht gjashtë feta buke, rrezikonin me 40% për tu shëndoshur dhe shfaqën një shtim të ndjeshëm peshe.

Martinez-Gonzalez shpjegon se buka bardhë bëhet me një miell shumë të rafinuar, pa fibra, vitamini

na dhe embrion gruri, duke bërë që të cilësohet si “bombë sheqeri”.



FRUTI I MREKULLIVE

Bananja, fruti i mrekullive. Bananet përmbajnë tre sheqerna natyrore, saharozen, fruktozën dhe glukozën të kombinuar me fibra. Një banane jep një rritje të menjëhershme, të qëndrueshme dhe substanciale të energjisë.

Hulumtimet kanë vërtetuar se vetëm dy banane ofrojnë energji të mjaftueshme se sa një stërvitje 90 minutëshe. Nuk është çudi që bananja është fruti që përdoret më së shumti nga të gjithë atletët e botës. Por energjia nuk është e vetmja mënyrë që një banane mund të na ndihmojë ta shohim atë si një ushqim racional. Ajo gjithashtu ndihmon apo parandalon një numër të

konsiderueshëm të sëmundjeve dhe kushteve të ndryshme shëndetësore, duke e bërë atë një domosdoshmëri për ta shtuar në dietën tonë të përditshme.

Depresioni: Sipas një sondazhi të fundit të ndërmarrë nga Asociacioni për shëndetin mendor në Britaninë e Madhe, në mesin e njerëzve që vuajnë nga depresioni shumica ndjehet shumë më mirë pasi ha një banane. Kjo, është për shkak se bananet përmbajnë triptofan, një lloj i proteinës që trupi e konverton në serotoninë, e cila është e njohur për relaksim që jep. Ajo përmirëson gjendjen shpirtërore dhe në përgjithësi bën të ndjeheni më të lumtur. Sindromi Postmenstrual: Harroni pilulat dhe hani vetëm një banane. Vitamina B6 që ajo përmban, rregullon nivelet e

glukozës në gjak.

Anemia: Me shumë sasi të hekurit bananja, mund të stimulojë prodhimin e hemoglobinës në gjak dhe kështu ndihmon në rastet e anemisë.

Presioni i gjakut: Ky frut unik tropikal është jashtëzakonisht i pasur me kalium me nivel të ulët kripe, gjë që e bën atë të përsosur për të mundur shtypjen e gjakut.

Energjia e trurit: 200 studentë në një shkollë Twickenham (Angli) u ndihmuan në provimet e tyre këtë vit duke ngrënë banane në mëngjes, gjatë pushimit dhe në drekë. Me këtë u synua rritja e fuqisë së trurit të tyre. Hulumtimet kanë treguar se frutat e mbushura me kalium mund të ndihmojnë të mësuarit duke i bërë nxënësit më vigjilent.

Kapsllëku: Për shkak se kanë shumë fibra, përfshirja e bananeve në dietë mund të ndihmojë në rikthimin e veprimeve normale të zorrëve, duke ndihmuar në kapërcimin e problemit pa përdorur laxative.

Pickimi i mushkonjave: Përpara se të përdorni krem kundër pickimit, provoni fërkimin e zonës së prekur me brendësi të një lëvoreje të bananes.



ADIDAS SJELL TOPIN INTELIGJENT

Marka e njohur e "Adidas-it" solli një risi në prag të nisjes së Kupës së Botërorit. Marka ka prezantuar një top inteligjent, i cili lidhet me aplikacionet e teknologjisë Apple.

Ai ngjan si topi tradicional, por sipërfaqja e tij përbëhet nga një sistem i vogël që komunikon me bluetooth-in nëpërmjet smartphone-it i cili është i pajisur me sistemin operativ iOS vetëm për Apple, dhe jo për sistemin Android. Kjo teknologji mat trajektoren ajrore, shpejtësinë dhe drejtimin e topit. Aplikacioni ka edhe video didaktike për t'u përmirësuar, mundësinë për të regjistruar golat më të arrirë dhe më pas për t'i shpërndarë në rrjete sociale.

Firma "Adidas" ka nisur të punojë për këtë projekt që në vitin 2009 dhe tashmë topi inteligjent vjen i për-



funduar, i cili do të shitet online dhe gjithashtu nëpërdyqane me pajisje digjitale. Vlera e këtij topi është 299 euro.

NASA ME DISK FLUTURUES



Agjencia amerikane e hapësirës, NASA, po përgatitet të lëshojë "diskun fluturues" në atmosferën e tokës për të testuar teknologjinë që mund të përdoret për të zbritur në planetin Mars.

Me dekada të tëra, NASA është varur nga e njëjta

parashutë e dizajnuar për të ngadalësuar anijen kozmike pasi ajo hyn në atmosferën e Marsit. Por tashmë, NASA ka nevojë për një parashutë më të madhe dhe më të fuqishme nëse dëshiron që të zbres objekte më të rënda dhe astronautët.

Një balonë që e mban mjetin në formë disku do të lëshohet nga Hawai. Më pas, mjeti do e ndez motorin raketor të saj dhe të ngjitet për 54 km. Disku do të fryjë më pas një tub për të ngadalësuar zbritjen poshtë nga shpejtësia supersonike dhe do të shpalojë një parashutë për ulje mbi ujin.

KËLLËFI INTELIGJENT I I-PHONE

Këllëfët e telefonave dikur përdoreshin për të mbrojtur telefonin nga gërvishtjet, ndërsa tani po krijohen këllëfe inteligjentë që mund të parashikojnë ardhjen e një mesazhi. Bëhet fjalë për këllëfin më të ri që do të dalë në treg, Lunecase, i cili merr energji kur telefoni lidhet me një rrjet dhe paralajmëron për ardhjen e thirrjeve në telefonin tuaj si dhe për mesazhet përpara se ata të arrijnë në telefon.

Këto njoftime shfaqen në anën e pasme të këllëfit, pa pasur nevojë për ndezjen e telefonit. Një version tjetër i këtij këllëfi, Lunecase Eclipse, përdor dritat në ikonën e Apple-it



për të njoftuar për telefonatat dhe mesazhet para se të shfaqen në ekranin e iPhone-it.

Këllëfi Lunecase funksionon vetëm kur telefoni është i lidhur me një rrjet mobil që mund të pranojë thirrje dhe mesazhe tekst, dhe aktualisht është i disponueshëm vetëm për iPhone 5, 5C dhe 5S. Pritet që versionet e tjera të këtij këllëfi të jenë të disponueshme edhe për telefona të tjerë inteligjentë. Ndërkohë, këllëfi Lunecase do të dalë në shitje në Kickstarter duke filluar nga muaji gusht dhe kushton 25 dollarë.

DIJETARI I NJOHUR OSMAN NURI TOPNASH VIZITON MEDRESENË "HAXHI SHEH SHAMIA" SHKODËR

Është kthyer tashmë në traditë vizita e dijetarit të njohur, Osman Nuri Topbash në qytetin e Shkodrës, e realizuar këtë herë të Martën e datës 03 Qershor 2014, në Medresenë "Haxhi Sheh Shamia". Një vizitë e tillë sjell çdo herë të tjera përjetime të forta emocionuese.

Ka nisur kjo vizitë në Medresenë "Haxhi Sheh Shamia" Dega e vajzave, me një pritje madhështore për nder të tij dhe delegacionit shoqërues dhe ka vijuar më pas në qendrës e Shoqatës "Istanbul", ku është pritur mjaft ngrohtësisht nga drejtuesit më të lartë të shoqatës si: z Rafet Bilaç, themeluesi dhe drejtuesi i përgjithshëm i shoqatës, z Ridvan Seferaj kryetar i shoqatës, z Arif Qerozi, ish-drejtor i shoqatës dhe të tjerë drejtues të njësive përkatëse.

Nxënëset medresiste, më pas e pritën dijetarin e njohur në ambientet e degës së vajzave, ku për nder të tij kishin organizuar një program mjaft të veçantë dhe mbreslënës. Më pas z Osman Nuri Topbash ka vijuar me një ligjeratë, nëpërmjet së cilës ka dhënë mesazhe jetike.

Vizita ka vijuar në ambientet e kopështit "Aromë Trëndafili", ku delegacioni është njohur më nga afër me punën e bërë në këtë folezë të rëndësishme të rritjes dhe edukimit të filizave të rinj të shoqërisë.

Pasdreka e kësaj dite ka vijuar me një organizim për mbarë besimtarët shkodranë dhe jo vetëm, në sallën e konferencave të Medresesë së djemve, takim ky që ka nisur me një fjalë përshëndetëse të myftiut të Shkodrës Imam Muhamed Sytari, i cili në vijim ka lexuar edhe disa pjesë Kuranore. Më pas dijetari i njohur Osman Nuri Topbash ka ligjëruar për qindra besimtarë të pranishëm në sallë. Në fund të programit Kryetari i shoqatës z Seferaj i ka lënë vendin ish – kryetarit z Arif Qerozit për t'i dhënë një dhuratë simbolike në kujtim të kësaj dite dijetarit të njohur Osman Nuri Topbash, i



cili ndër të tjera është shprehur se dhurata më e bukur është miqësia e ngushtë dhe vëllazëria që na bashkon të gjithëve.

E nesërmja ka nisur më pas me një vizitë në Medresenë "Haxhi Sheh Shamia" Dega e Djemve. Medresistët kishin rezervuar një pritje mjaft madhështore që në hyrje të shkollës, e më pas në sallën e konferencave, ku kishin përgatitur një program mirë se ardhjeje për nder të tij dhe delegacionit shoqërues. Edhe këtu nuk munguan mesazhet jetike të hoxhës së nderuar, që u drejtoheshin brezave të rinj, si e ardhmja e vendit dhe shoqërisë. Një dedikim kushtuar dijetarit të shquar do përbënte dhe mbylljen e këtij programi, gjurmët e së cilit do mbeten gjatë në kujtesën e të ftuarve të nderuar.

